



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosovo



Zyra Kombëtare e Auditimit
Nacionalna Kancelarija Revizije
National Audit Office

Raporti i Auditimit të Performancës

MENAXHIMI I FONDIT PËR BURIMET E RIPËRTËRISHME TË ENERGJISË

Prishtinë, gusht 2025

Auditori i Përgjithshëm i Republikës së Kosovës është institucioni më i lartë i kontrollit ekonomik e financiar, të cilit Kushtetuta dhe Ligji¹ i garantojnë pavarësi funksionale, financiare dhe operative.

Zyra Kombëtare e Auditimit është institucion i pavarur, i cili e ndihmon Auditorin Përgjithshëm në kryerjen e detyrave të tij/saj. Misioni ynë është që përmes auditimeve cilësore të kontribuojmë në mënyrë efektive në llogaridhënien e sektorit publik, duke promovuar transparencën publike dhe qeverisjen e mirë, dhe duke nxitur ekonominë, efektivitetin dhe efikasitetin e programeve qeveritare për të mirën e të gjithëve. Në këtë mënyrë, ne rrisim besimin në shpenzimin e fondeve publike dhe luajmë një rol aktiv në sigurimin e interesit të taksapaguesve dhe të palëve tjera të interesit në rritjen e përgjegjësisë publike. Auditori i Përgjithshëm i jep llogari Kuvendit për ushtrimin e detyrave dhe kompetencave të përcaktuara në Kushtetutë, në Ligj, në aktet nënligjore dhe në standardet ndërkombëtare të auditimit të sektorit publik.

Ky auditim është kryer në përputhje me Standardet Ndërkombëtare të Institucioneve Supreme të Auditimit (SNISA 3000²).

Auditimet e performancës të ndërmarra nga Zyra Kombëtare e Auditimit janë shqyrtime objektive dhe të besueshme që vlerësojnë nëse veprimet qeveritare, sistemet, operacionet, programet, aktivitetet ose organizatat veprojnë në përputhje me parimet e ekonomisë³, efikasitetit⁴ dhe efektivitetit⁵ dhe nëse ka vend për përmirësim.

Auditorja e Përgjithshme ka vendosur në lidhje me përmbajtjen e raportit të auditimit të performancës “Menaxhim i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë”, në konsultim me Ndihmës Auditoren e Përgjithshme, Myrvete Gashi Morina, e cila e ka mbikëqyrur auditimin.

Ekipi që realizoi këtë raport:

Arben Selimi, U.D. Drejtor i Departamentit të Auditimit të Performancës

Mimozë Selimi, Udhëheqëse e Ekipit

Labinot Sadiku, Anëtar i Ekipit

ZYRA KOMBËTARE E AUDITIMIT – Adresa:Rr. Ahmet Krasniqi nr. 210, Lagjja Arbëria, Prishtinë 10000, Kosovë
Tel: +383(0) 38 60 60 04/1011
<http://zka-rks.org>

¹ Ligji 05_L_055 për Auditorin e Përgjithshëm dhe Zyrën Kombëtare të Auditimit të Republikës së Kosovës

² Standardet dhe udhëzimet për auditimin e performancës bazuar në Standardet e Auditimit të ONISA-s dhe përvoja praktike.

³ Ekonomia - Parimi i ekonomisë nënkupton minimizimin e kostos së burimeve. Burimet e përdorura duhet të jenë në dispozicion në kohën e duhur, në sasinë dhe cilësinë e duhur dhe në çmimin më të mirë të mundshëm.

⁴ Efikasiteti - Parimi i efikasitetit nënkupton marrjen e maksimumit nga burimet në dispozicion. Ka të bëjë me lidhjen mes burimeve të përfshira dhe rezultatit të dhënë në aspektin e sasisë, cilësisë dhe kohës.

⁵ Efektiviteti - Parimi i efektivitetit nënkupton arritjen e objektivave të paracaktuara dhe arritjen e rezultateve të pritshme.

Tabela e Përmbajtjes

Përmbledhje e përgjithshme	3
Hyrje.....	5
Gjetjet e auditimit.....	8
3.1 KOSTT nuk ka arritur të menaxhojë në mënyrë efikase Fondin	11
3.1.1. Paguesa të pa sakta gjatë fazës testuese të prodhuesve dhe mangësi në administrimin e marrëveshjeve	11
3.1.2. KOSTT nuk kishte organizuar në mënyrë efikase procesin e shitblerjes së energjisë së burimeve të ripërtërishme.....	19
3.1.3. Mangësi financiare në menaxhimin e Fondit për burimet të ripërtërishme të energjisë	29
3.2 ZRRE nuk ka qenë efektive në monitorimin e Fondit.....	34
3.3 Ministria e Ekonomisë nuk ka mbikëqyrur zbatimin e politikave të BRE	40
Konkluzionet.....	44
Rekomandimet	46
Shtojca I: Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia auditimit.....	47
Problemi i auditimit	47
Kriteret e auditimit	48
Fushëveprimi i auditimit.....	50
Metodologjia e auditimit	51
Përshkrimi i sistemit.....	52
Shtojca II Prodhuesit që janë në operim komercial.....	55
Shtojca III Prodhuesit që janë mostër e auditimit	56
Shtojca IV Parashikimet e prodhuesve në MWh.....	57
Shtojca V “Jo-balancat 5% për vitin 2022”	58
Shtojca VI “Të hyra dhe Shpenzimet e Fondit për 2022-2024”	59
Shtojca VII Letër konfirmimet dhe komentet e entiteteve	60

Lista e shkurtesave

BRE	Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
EE	Energji Elektrike
FONDI	Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë
PRODHUESIT	Gjeneratorët e burimeve të ripërtërishme të energjisë
PARASHIKIME	Nominime të energjisë BRE
JO BALANCA	Devijime mes prodhimit dhe parashikimit
KONSUMATOR	Konsumatori Fundor
KOSTT	Operatori i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu SH.A.
KWh	Kilovat për Orë (njësi matëse e energjisë elektrike)
MBE	Marrëveshje për Blerje të Energjisë nga BRE
ME	Ministria e Ekonomisë
MWh	Megavat për Orë (njësi matëse e EE më e madhe se KWh)
OSSH	Operatori i Sistemit të Shpërndarjes
OST	Operatori i sistemit dhe transmisionit në KOSTT
OT	Operatori i Tregut në kuadër të KOSTT
RREGULLA	Rregulla për skemë mbështetëse për BRE
SKEMA	Skema mbështetëse për BRE
ZRRE	Zyra e Rregullatorit të Energjisë

Përmbledhje e përgjithshme

Siguria e furnizimit me energji, efikasiteti i operimit të sistemit të transmetimit dhe garantimi i një tregu të drejtë e transparent janë prioritate kyçe për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Forma se si menaxhohen resurset e energjisë në vend ka ndikim si ekonomik ashtu edhe social në shoqëri dhe vendin si tërësi.

Zyra Kombëtare e Auditimit ka kryer auditimin e performancës me temën “ Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë” (tutje, Fondi). Ky Fond është themeluar në vitin 2017, me qëllim të rritjes së investimeve në burimet e ripërtërishme të energjisë. Fondi është themeluar bazuar në rregullën për skemën mbështetëse të hartuar nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, po ashtu në vitin 2017. Ndërsa që nga themelimi Fondi është nën menaxhimin e Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT). Objektivi i këtij auditimi ishte të vlerësojmë efikasitetin e menaxhimit të Fondit nga Operatori i Sistemit, Transmisionit dhe Tregut SH.A., monitorimin e tij nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë, si dhe mbikëqyrjen nga Ministria e Ekonomisë në lidhje me zbatimin e masave të marra për burimet e ripërtërishme të energjisë. Fushëveprimi i këtij auditimi përfshinë: Ministrinë e Ekonomisë, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe Operatorin e Sistemit, Transmetimit dhe Tregut të Energjisë Elektrike dhe ka mbuluar periudhën 2017-2024.

Operatorit të Sistemit, Transmisionit dhe Tregut (KOSTT) nuk kishte arritur të menaxhojë Fondin në mënyrë efikase. Janë identifikuar mangësi gjatë fazës testuese të prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë, po ashtu edhe në procesin e organizimit të shitblerjes së energjisë së ripërtërishme si dhe në realizimin e të hyrave për Fondin. Me tutje, Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka kryer monitorimin efektiv të Fondit. Ministria e Ekonomisë nuk ka bërë monitorim të mjaftueshëm të zbatimit të politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe arritjen e caqeve të cilat i kishte vendosur para vitit 2020.

KOSTT kishte mangësi gjatë fazës testuese të prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

Faza e testimit dhe certifikimit të prodhuesve nuk është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara, si dhe në disa raste, prodhuesit janë lejuar të hyjnë në operim komercial pa u dokumentuar dhënia e energjisë në rrjet gjatë fazës testuese. Po ashtu, KOSTT nuk kishte siguruar garancitë financiare nga prodhuesit dhe furnizuesit, gjë që ka ndikuar negativisht në menaxhimin financiar të Fondit. Mungesa e këtyre garancive ka rezultuar me vonesa të theksuara, deri në 7 muaj për inkasimin e të hyrave në Fond nga palët e treta.

KOSTT nuk ka organizuar siç duhet procesin e shitblerjes së energjisë së ripërtërishme. KOSTT nuk ka qenë efikas në menaxhimin e procesit të shitblerjes së energjisë së ripërtërishme. Prodhuesit e kësaj energjie kanë paraqitur parashikime të pasakta të prodhimit, duke rezultuar në teprice prodhimi dhe krijimin e jo balancave të energjisë. KOSTT-i nuk ka arritur të minimizojë nivelin e jo-balancave, ndërsa në disa raste, parashikimet e prodhuesve kanë devijuar dukshëm nga prodhimi real i energjisë. Si pasojë e këtyre devijimeve, është krijuar një diferencë e konsiderueshme ndërmjet energjisë së parashikuar dhe asaj të prodhuar, kjo diferencë ka shkaktuar kosto e cila është mbuluar nga KOSTT-i përmes mjeteve të Fondit. Këto pa saktësi në parashikime kishin shkaktuar kosto shtesë për blerje të energjisë mbi 10 milion euro gjatë periudhës 2022-2024, të cilat janë mbuluar nga Fondi për energjinë e burimeve të ripërtërishme.

Mangësi në menaxhimin dhe procesin e pagesave të Fondit për burime të ripërtërishme të energjisë. KOSTT-i nuk ishte efikas në procesin e inkasimit të të hyrave. Furnizuesit kishin vonesa në pagesa ndaj Fondit që arrijnë deri në 7 muaj, ndërsa vlera totale e këtyre pagesave të vonuara ishte rreth 20 milion euro. Po ashtu, prodhuesit e burimeve të ripërtërishme kishin vonesa në përmbushjen e detyrimeve ndaj KOSTT deri në 9 muaj. Këto vonesa janë rezultat i mungesës së garancive financiare, të cilat do të duhej të ishin vendosur si mekanizëm sigurie për të parandaluar mos përmbushjen me kohë të detyrimeve nga ana e palëve të përfshira.

Mungesa e monitorimit efektiv të Fondit nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë. Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk e kishte monitoruar në vazhdimësi mënyrën se si KOSTT-i e menaxhon Fondin. Edhe pse ka pranuar në mënyrë periodike informacione nga KOSTT, këto të dhëna nuk janë analizuar në mënyrë adekuate për të ndërmarrë veprime korrigjuese në kohë. Tarifa për Fondin aprovohet çdo vit nga ZRRE dhe mbulohet nga konsumatorët fundorë. Në vitin 2023, kjo tarifë ka shënuar një rritje të ndjeshme, duke u katërfishuar në krahasim me vitin 2022 – nga 0.73 euro/MWh në 3.14 euro/MWh.

Gjithashtu, në vitin 2019, Zyra e Rregullatorit të Energjisë vendosi të ndryshojë përgjegjësinë financiare të prodhuesve për jo-balancat e shkaktuara në sistem. Në vend të mbulimit të 25% të kostos për jo-balancat, prodhuesve iu vendos një tavan prej 5% të të hyrave vjetore nga shitja e energjisë nga burimet e ripërtërishme. Si rezultat, përgjegjësia financiare për pasaktësitë në parashikimet e prodhimit u transferua tek KOSTT-i, duke e ekspozuar atë ndaj kostove shtesë. Vetëm gjatë periudhës 2022–2024, kostot për këto jo-balanca kanë arritur vlerën prej 4.6 milionë euro dhe janë mbuluar nga mjetet e Fondit.

Ministria e Ekonomisë nuk ka qenë mjaftueshëm aktive në monitorimin dhe përshtatjen e caqeve karshi zhvillimeve në sektorin e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për të hartuar politika në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe vendosjen e caqeve, megjithatë nuk kishte monitoruar në mënyrë të duhur përmbushjen e caqeve të përcaktuara. Fillimisht, para se të vendosë caqet nuk ishte bazuar në analizat e parafisibilitetit që kishin vlerësuar potencialin gjenerues të energjisë nga burimet e ripërtërishme të ujit. Edhe pse qëllimi i politikës energjetike ishte që deri në vitin 2020 të instalohen burime të ripërtërishme të energjisë në kapacitet prej 800 MW, deri në vitin 2024 ishin instaluar 310 MW që përfaqëson më pak se 40% të caqeve të përcaktuara.

Me qëllim të rritjes së efikasitetit në menaxhimin dhe funksionimin Fondit të burimeve të energjisë së ripërtërishme si dhe me qëllim të hartimit të politikave sa më efektive kemi dhënë nëntë rekomandime që cilat mund t'i gjeni në kapitullin rekomandimet.

Përgjigjja e entiteteve të përfshira në auditim Ministria e Ekonomisë dhe Operatori i Sistemit Transmisionit dhe Tregut (KOSTT), janë pajtuar pjesërisht me gjetjet, ndërsa janë zotuar se do t'i adresojnë rekomandimet e dhëna. Ndërsa Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk është pajtuar me gjetjet dhe konkluzionet e auditimit.

Inkurajojmë subjektet e përfshira në këtë auditim që ti bëjnë të gjitha përpjekjet për t'i adresuar rekomandimet e dhëna.

Hyrje

Siguria për sa i përket furnizimit me energji, efikasiteti i operimit të sistemit të transmetimit të energjisë dhe garantimi i një tregu të drejtë e transparent janë prioritete kyçe për të mbështetur zhvillimin ekonomik dhe shoqëror të vendit. Në menaxhimin dhe zhvillimin e sektorit të energjisë elektrike në Kosovë rol thelbësorë luajnë: Ministria e Ekonomisë (ME), Operatori i Sistemit, Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) dhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE).

Përpyekjet e përbashkëta të këtyre institucioneve synojnë jo vetëm përmbushjen e nevojave energjetike të Kosovës, por edhe integrimin e suksesshëm të saj në tregjet evropiane të energjisë. Kosova si nënshkruese e Traktatit për Komunitetin e Energjisë⁶ ka përcaktuar caqe për prodhimin e energjisë elektrike nga Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) sikurse janë: uji, era, dielli, biomasa⁷, etj. Ministria kishte hartuar udhëzimin administrativ “05/2017-caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme”. Si rrjedhojë e këtij udhëzimi administrativ, ishte hartuar edhe Skema Mbështetëse. Po ashtu ishin aprovuar çmimet e tarifave nxitëse, që janë çmime të garantuara për gjeneratorët që bëhen pjesë e skemës mbështetëse si dhe ishte themeluar Fondi që të mundësojë financimin e energjisë së blerë nga këta gjeneratorë. Qëllimi për rritjen e prodhimit të energjisë nga BRE është gjithashtu edhe pjesë e agjendës 2031 për zhvillimin e qëndrueshëm e quajtur ndryshe SDG⁸. Në kuadër të SDG 7 synohet të arrihet energji e pastër dhe e përballueshme duke siguruar kështu: qëndrueshmëri, stabilitet dhe energji moderne për të gjithë.

ME është përgjegjëse për hartimin e politikave strategjike sa i përket arritjes së këtyre caqeve, përfshirë zbatimin e masave për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe përmbushjen e detyrimeve ndërkombëtare, siç është dekarbonizimi deri në vitin 2050⁹. Ndërsa Kosova kishte vlerësuar se mund të arrihet të përmbushen caqet e vendosura për bruto konsumin prej 25% të energjisë nga BRE deri në 2020, apo të bëhet instalimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë me kapacitet prej afërsisht 793.18 MW deri në vitin 2020¹⁰. Përmes Strategjisë për BRE, Planit të Veprimit dhe udhëzimeve tjera, është vlerësuar se deri në vitin 2020, të ndërtohen kapacitetet për prodhimin e energjisë nga burimet kryesore të energjisë së ripërtërishme si në vijim:

- o Energjia e ujit 580MW,
- o Energjia e erës 150MW,
- o Energjia diellore/solare 30MW,
- o Biomasa dhe biogazi¹¹ 20MW.

⁶ <https://me.rks-gov.net/traktati-per-themelimin-e-komunitetit-te-energji-se/>

⁷ biomasë drusore nga pyjet (prerjet e drunjve, mbetje nga prerjet si: kurora, degë, lëvore, trung, degëzime) mbetjet nga zdrukthëtaria, produktet e industrisë së pulpës dhe letrës, dru i ricikluar pas konsumit, rendimenti nga arat, biomasa frutore, produktet dytësore nga peshkataria, pjesa e biodegradueshme e mbeturinave të ngurta etj.

⁸ <https://www.globalgoals.org/goals/7-affordable-and-clean-energy/>

⁹ Ligji Nr.08/L-258 Për Promovimin e Përdorimit Të Burimeve Të Ripërtërishme Të Energjisë, neni 3.

¹⁰ Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 për caqet e BRE

¹¹ lëndë djegëse e gaztë të prodhuara nga Biomasa;

Në vitin 2024, Kosova ka vendosur që të ndërpresë ngritjen e kapaciteteve të reja për prodhimin e energjisë së ripërtërishme nga uji për shkak të kapaciteteve të kufizuara të ujit dhe problemeve tjera të paraqitura.¹² Duke u mbështetur kështu në ngritjen e kapaciteteve të reja të energjisë së ripërtërishme nga burimet alternative sikurse janë: energjia e erës, solare, biomasa etj.

Grafiku në vijim paraqet se çka synohet të arrihet nëpërmjet objektivave strategjike të BRE.

Figura 1 Objektivat për caqet kryesore të Strategjisë së Energjisë së Kosovës (2022 – 2031).¹³



Për arritjen e caqeve për BRE të vendosura nga ME janë hartuar Skema mbështetëse dhe në vitin 2017 është themeluar edhe Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë me qëllim që të financojë blerjen e energjisë ripërtërishme që prodhohet nga ana e prodhuesve të BRE, ky Fond është nën menaxhimin e KOSTT¹⁴.

Përmes këtij auditimi, synohet të vlerësohen roli dhe performanca e institucioneve kyçe në zbatimin e detyrimeve dhe politikave, duke përfshirë integrimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë në sistem. Përmes identifikimit të sfidave, dhe rekomandimeve konkrete, auditimi synon të kontribuojë në përmirësimin e menaxhimit të resurseve energjetike nga burimet e ripërtërishme dhe menaxhimit të masave të ndërmarra për arritjen e caqeve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

¹² Strategjia-e-Energjise-e-Republikes-se-Kosoves-2022-2031.pdf, fq. 17.

¹³ Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2022-2031.

¹⁴ Prodhuesit e energjisë BRE që njëkohësisht janë investitorët që kanë ndërtuar dhe posedojnë gjeneratorët e prodhimit të energjisë së ripërtërishme.

Objektivi i auditimit dhe pyetjet e auditimit

Objektivi i këtij auditimi është të vlerësohet efikasiteti i menaxhimit të Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë nga Operatori i Sistemit, Transmisioni dhe Tregu SH.A. (KOSTT), monitorimi i tij nga Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE), si dhe mbikëqyrja nga Ministra e Ekonomisë në lidhje me zbatimin e masave të marra për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Pyetjet e auditimit

Për t'iu përgjigjur objektives së auditimit kemi parashtruar pyetjet dhe nën pyetjet e auditimit si në vijim:

1. A ka arritur KOSTT që në mënyrë efikase të menaxhojë Fondin për Burime të Ripërtërishme të Energjisë dhe marrëveshjet që janë pjesë e Skemës?
2. A ka monitoruar ZRRE në mënyrë efikase dhe të vazhdueshme menaxhimin e Fondit nga KOSTT?
3. A ka bërë ME mbikëqyrjen e zbatimit të politikave për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë?

Ky auditim është fokusuar te KOSTT me qëllim të vlerësimit të mënyrës së menaxhimit të Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (Fondi). Po ashtu, është shqyrtuar edhe roli i Zyrës së Rregullatorit për Energji (ZRRE) në monitorimin e KOSTT-it lidhur me menaxhimin e këtij Fondi. Njëkohësisht, është analizuar edhe kontributi i Ministrisë së Ekonomisë si institucion përgjegjës për hartimin e politikave dhe strategjive për këtë fushë. Auditimi ka mbuluar periudhën nga 2017-2024 dhe është ndarë në dy pjesë: për të vlerësuar funksionimin dhe menaxhimin e Fondit auditimi ka mbuluar periudhën 2022-2024, ndërsa për të analizuar vendimet për tarifatat nxitëse, rregullën për skemën mbështetëse dhe mënyrën e nënshkrimit të marrëveshjeve për shitblerje të energjisë nga burimet e ripërtërishme janë analizuar të dhënat që nga viti 2017.

Metodologjia e detajuar e aplikuar gjatë këtij auditimi, problemi i auditimit, kriteret e auditimit, fushëveprimi i auditimit, përshkrimi detaj i sistemit dhe përgjegjësitë e palëve relevante janë paraqitur në *shtojcën 1* të këtij raporti.

Gjetjet e auditimit

Bazuar në Direktivën e e vitit 2009 të Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë të Komisionit Evropian¹⁵, që kishte për qëllim rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme, Ministria e Ekonomisë përgjatë viteve 2013 dhe 2017 kishte hartuar udhëzime administrative ku kishte përcaktuar arritjen e caqeve burimeve të ripërtërishme të energjisë të parapara për vitin 2020 me kapacitet të instaluar prej 793 MWh.

Për arritjen e këtyre caqeve të përcaktuara në udhëzimeve administrative¹⁶, ishin dizajnuar disa skema mbështetëse që kishin për qëllim stimulimin e investimeve në fushën e energjisë së ripërtërishme në Kosovë.

ZRRE në vitin 2016 kishte aprovuar çmimet e tarifave nxitëse¹⁷ që janë çmime të garantuara me të cilat prodhuesit e energjisë së ripërtërishme (tutje prodhuesit) që bëhen pjesë e Skemës Mbështetëse e shesin energjinë e prodhuar tek KOSTT.

Ndërsa në vitin 2017, ZRRE kishte hartuar rregullën për skemë mbështetëse ku ishin definuar kriteret e pranimit të prodhuesve në skemat mbështetëse përkatëse dhe metodat e financimit të blerjes së energjisë së ripërtërishme nga prodhuesit e pranuar në këto skema. Sipas kësaj rregulle, KOSTT obligohet që të nënshkruajë marrëveshje për blerje të energjisë me prodhuesit që pranohen në njërin nga skemat si në vijim:

- Skema mbështetëse (tutje skema) me çmime të tarifave nxitëse të aprovuara në vitin 2016, ku janë të pranuar gjithsej 31 prodhues të burimeve të energjisë së ripërtërishme, 29 prej tyre janë në prodhim (operim komercial) ndërsa dy tjerë nuk janë ende në prodhim.
- Korniza e rregulluar me çmimin referent për energji të ripërtërishme, çmim ky i cili aprovohet çdo vit nga ZRRE dhe është shumë më i ulët se sa ai i tarifave nxitëse. Në këtë skemë janë të pranuar pesë prodhues, ndërsa vetëm dy prej tyre janë në prodhim.

Prandaj në total në prodhim janë 31 prodhues të burimeve të ripërtërishme të energjisë, nga të cilët 29 janë në kuadër të skemës mbështetëse dhe dy në kuadër të kornizës së rregulluar, të cilët në total kanë kapacitet të instaluar prej 229 MWh- *shih shtojca 2- Prodhuesit që janë në operim komercial (prodhim).*

Për të financuar blerjen e energjisë nga prodhuesit e pranuar në Skemë, në vitin 2017 është themeluar edhe Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (tutje Fondi). Ky Fond është nën menaxhimin e KOSTT¹⁸. Pjesë e Fondit janë bërë të gjithë prodhuesit e pranuar në Skemë dhe kornizë të

¹⁵ <https://me.rks-gov.net/en/res/>, Direktivës 2009/28/EC të adaptuara sipas Këshillit të Ministrave të Komunitetit të Energjisë D/2012/04/MC-EnC për zbatimin e Direktivës 2009/28/EC dhe ndryshimin e nenit 20 të Traktatit të Komunitetit të Energjisë

¹⁶ UA 01/2013 caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme⁸ UA "05/2017-caqet e energjisë nga burimet e ripërtërishme"

¹⁷ V_810_2016 – vendimi për tarifa nxitëse

¹⁸ Prodhuesit e energjisë BRE që njëkohësisht janë investitorët që kanë ndërtuar dhe posedojnë gjeneratorët e prodhimit të energjisë së ripërtërishme.

rregulluar dhe që kanë nënshkruar marrëveshje për blerje të energjisë nga viti 2017. Ndërsa me prodhuesit që ishin pranuar para vitit 2017, nënshkrimin e marrëveshjes për blerje të energjisë e ka bërë KEDS, ndërsa të njëjtit kanë kaluar gjithashtu në Skemën e re të vitit 2017. Prandaj, gjithë prodhuesit e energjisë BRE që janë pjesë e ndonjëres nga skemat e lartë përmendura e kanë të garantuar shitjen e energjisë të prodhuar tek KOSTT-i nëpërmjet Fondit.

Në vijim kemi paraqitur tarifat nxitëse të cilat janë aprovuar në vitin 2016 për prodhuesit e skemës.

Tabela 1 Çmimet e Tarifave nxitëse të aprovuara nga ZRRE për prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë që bëhen pjesë e Skemës Mbështetëse¹⁹.

Niveli i tarifave nxitëse të aplikueshme për Prodhuesit BRE që janë pjesë e Skemës Mbështetëse		
Burimi i Energjisë	Çmimi i tarifës nxitëse (€/MWh)	Caqet e përcaktuara për secilin nga Burimet e Energjisë në MWh (deri në 2020)
Energjia Fotovoltaike (Solare)	136.40 €	10
Era	85.00 €	150
Hidrocentralet e vogla	67.47 €	240
Biomasa	71.30 €	14
Gjithsej		414

Prodhuesit që janë të pranuar në Skemë, aktualisht e shesin energjinë tek KOSTT me çmime edhe më të larta se sa ato që ishin aprovuar sikurse janë paraqitur në tabelë. Kjo si rezultat i përshtatjes së inflacionit që përcaktohet në baza vjetore nga ZRRE dhe që bëhet duke u bazuar në indeksin e çmimeve të Eurostat²⁰. Çmimet e energjisë Solare në vitin 2024 kishin arritur deri në 164 €/MWh, Era deri në 96 €/MWh, si dhe Hidrocentralet deri në 79 €/MWh.

Skema me tarifa nxitëse ishte shfuqizuar nga ZRRE në dhjetor të vitit 2020²¹, kjo kishte ndodhur me arsyetimin se tashmë teknologjia për prodhimin e energjisë nga burimet e ripërtërishme është zhvilluar dhe si rezultat nuk është më e nevojshme që të aplikohen tarifa nxitëse për të stimuluar investimet në fushën e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Në vendim po ashtu thuhet se ZRRE ka vlerësuar që modeli përmes ankandeve është më konkurrues sepse bazohet në çmime tregu dhe u jep mundësi të barabartë gjithë investitorëve potencial të BRE. Prandaj është vendosur për shfuqizimin e tarifave nxitëse dhe ndalimin e pranimit në Skemë për prodhuesit e rinj pas vitit 2020. Ndërsa, modeli i ankandeve²² ka filluar të aplikohet nga viti 2024, pas aprovimit të ligjit për burimet e ripërtërishme.

¹⁹ Vendimi i ZRRE V_810_2016 për tarifat nxitëse dhe nivelin e caqeve

²⁰ [Industrial producer price index overview - Statistics Explained - Eurostat](#)

²¹ V_1321_2020 – shfuqizimi i tarifave nxitëse

²² Ankandet janë shtuar si model pas aprovimit të ligjit "08/L-258 për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë" dhe nuk janë pjesë e fushëveprimit të këtij auditimi pasi që ende nuk janë në operim komercial.

Ndërsa kontratat me tarifa nxitëse të nënshkruara mes KOSTT dhe prodhuesve të energjisë së ripërtërishme deri në vitin 2020, vlejnë deri në skadimin e afatit të tyre që është 10-12 vite nga fillimi i operimit komercial (fillimi prodhimit të energjisë) të këtyre prodhuesve.


Sa i përket pesë prodhuesve të energjisë së ripërtërishme që operojnë në kuadër të kornizës së rregulluar, marrëveshjet janë lidhur në bazë të çmimit referent të përcaktuar nga ZRRE. Megjithatë, edhe ky vendim është shfuqizuar në vitin 2023, duke e zëvendësuar me sistemin e ankandëve si formë e vetme për përcaktimin e tarifave për projektet e reja të investimit në energji të ripërtërishme.

Ndërsa në vitin 2024, kanë filluar të aplikohen ankandet si modeli i vetëm për investuesit e rinj të burimeve të ripërtërishme, kjo pasi që paraprakisht ishin shfuqizuar vendimet për tarifa nxitëse dhe asaj me kornizë të rregulluar. Prandaj për investitorët e rinj që duan që të nënshkruajnë kontrata për shitje të energjisë së ripërtërishme në KOSTT duhen të aplikojnë vetëm përmes modelit të ankandëve.

Aktualisht, me anë të modelit të ankandëve ekziston vetëm një prodhues me diell me të cilin është nënshkruar marrëveshje në vitin 2024 por i cili ende nuk ka hyrë në operim komercial, prandaj nuk ka qenë fushëveprim i auditimit.

Lidhur me aktivitetin e Fondit dhe të hyrat dhe shpenzimet e Fondit, në vijim është paraqitur grafiku me të hyrat dhe shpenzimet e Fondit përgjatë viteve 2022-2024

Grafiku 1 Fondi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë për 2022-2024



Sikurse shihet diferenca mes të hyrave dhe shpenzimeve ishte pozitive, me përjashtim të vitit 2023. Vendimi për shfrytëzimin e diferencës pozitive që mbetet nga viti paraprak merret nga ZRRE dhe është element përbërës i formulës për llogaritjen e të hyrave të lejuara. Diferenca kryesisht bartet në vitin vijues dhe i shtohet të hyrave të lejuara të Fondit.

Gjetjet e auditimit në vijim janë të ndara në tri pjesë sipas pyetjeve të auditimit.

Në pjesën e parë trajtohet mënyra se si KOSTT ka menaxhuar Fondin, ku janë paraqitur gjetjet që i takojnë procesit se si KOSTT ka bërë: procesin e fazës testuese me prodhuesit e energjisë së ripërtërishme dhe testimet e gjeneratorëve (prodhuesve) para fillimit të operimit komercial (hyrjes

në prodhim). Gjithashtu është vlerësuar edhe mënyra se si KOSTT ka organizuar shitblerjen e energjisë së ripërtërishme dhe si ka kryer pagesat për Fondin.

Në pjesën e dytë është trajtuar mënyra se si ZRRE ka monitoruar KOSTT-in për tu siguruar se Fondi është menaxhuar në mënyrën e duhur. Në këtë pjesë është trajtuar qasja e ZRRE ndaj monitorimit të hyrave të lejuara të Fondit dhe proceseve tjera që ndërlidhen me Fondin.

Në pjesën e tretë të këtij kapitulli janë trajtuar veprimet që ka ndërmarrë Ministria e Ekonomisë sa i përket monitorimit të zbatimit të politikave për arritjen e cageve të burimeve të ripërtërishme të energjisë.

3.1 KOSTT nuk ka arritur të menaxhojë në mënyrë efikase Fondin

Menaxhimi i Fondit të BRE duhet të bëhet në mënyrë efikase dhe në përputhshmëri të plotë me rregullën e të hyrave për OST/OT dhe legjislacionin tjetër në fuqi.

KOSTT nuk ka arritur të jetë efikas në menaxhimin e Fondit. Gjatë auditimit janë identifikuar mangësi në fazën testuese të prodhuesve, përdorimi i standardeve të dyfishta sa i përket qasjes ndaj këtyre prodhuesve etj.

Gjithashtu KOSTT nuk është efikas as në organizimin e shitblerjes së energjisë sepse nuk ka arritur të sigurojë mekanizma efektiv që të mbajë jo-balancat e prodhuesve në nivel sa më të ulët.

Mangësi janë vërejtur edhe në procesin e realizimit të pagesave të Fondit dhe menaxhimit financiar të këtij Fondit, ku janë identifikuar që kishte vonesa të theksuara në realizimin e pagesave etj.

3.1.1. Pagesa të pa sakta gjatë fazës testuese të prodhuesve dhe mangësi në administrimin e marrëveshjeve

Para lëshimit në operim komercial duhet të kryhet testimi i gjeneratorit BRE. Çmimi për energji testuese do të jetë i barabartë me 60% të çmimi të energjisë. Pavarësisht sa javë zgjasin testimet, energjia testuese llogaritet dhe paguhet maksimalisht për 30 ditë. KOSTT duhet të sigurojë që faturimi, alokimi i energjisë dhe menaxhimi i përgjegjësi të furnizuesve të kryhen në mënyrë efikase dhe transparente²³.

Mostra e përzgjedhur për auditim për sa i përket kushteve të nënshkrimit të marrëveshjes për blerje të energjisë së ripërtërishme përfshin tetë prodhues që janë pjesë e Fondit. Këta përfaqësojnë rreth 26% të prodhuesve që aktualisht janë në operim komercial-Shih Shtojca 3- prodhuesit që janë mostër e auditimit.

Ndërsa përgjatë fazës së testimit të prodhuesve janë analizuar pesë nga tetë prej tyre. Nga shqyrtimi i kësaj mostre janë identifikuar një sërë çështjesh që lidhen me fazën testuese dhe administrimin e marrëveshjeve për blerjen e energjisë, të cilat paraqiten më poshtë.

²³ Marrëveshja për shitblerje të energjisë BRE mes KOSTT dhe Gjeneratorëve

- Sasia e energjisë së matur dhe energjisë së faturuar në periudhën e testimit nuk përputhet. KOSTT kishte paguar më tepër për testimin e prodhuesve se sa do të paguheshin nëse do të realizoheshin testimet sipas rregullave dhe kërkesave në rregullore.
- Kishte raste kur prodhuesi i energjisë së ripërtërishme është lëshuar në operim komercial pa kaluar fare prodhimin në fazë testimi.

Bazuar në kushtet e përcaktuara në marrëveshje për blerje të energjisë së ripërtërishme kërkohet që prodhuesit të testohen para se të fillojnë operimin komercial (prodhim të energjisë) për t'u siguruar se nuk ka: defekt, gabim, pamjaftueshmëri në dizajn ose ndërtim si dhe nuk ka defekt ose gabim në operim. Në vijim në formë tabelore në kolonën e parë kemi paraqitur hapat që duhet të ndiqen gjatë fazës së komisionimit (testimit) ndërsa në kolonat tjera kemi listuar mangësitë e identifikuar për secilin nga prodhuesit.

Tabela paraqet shpjegim të detajuar që lidhet me diferencën mes matjeve të realizuara dhe atyre të paguara, mangësitë që kemi identifikuar në periudhën testuese, si dhe mangësitë në faturim dhe në pagesa për secilin nga këta prodhues të pranuar në Skemë.

Tabela 2 Testimi i prodhuesve para lëshimit në operim komercial (prodhim)

Prodhuesi	Lloji	Ku është kyçur	Kapaciteti (MW)	Pranimi në Skemë	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Lëshimi në Operim komercial /Prodhim	Ditët e energjisë Testuese	Mangësitë e identifikuar për secilin Prodhues
1	HC	KEDS	9.998	2015	13.12.2017	19.06.2019	0	Prodhuesi është lëshuar operim komercial në vitin 2019. Gjatë komisionimit nuk ka pas energji testuese për këtë Prodhues. Deklarata e disponueshmërisë që njofton Operatorin e Sistemit se Prodhuesi është gati të fillojë testimet është lëshuar më datë 28.05.2019.
2	ERA	KOSTT	34.47	2016	17.12.2019	14.12.2021	26	Në momentin e fillimit të energjisë testuese njëhësi i Prodhuesit nuk ka qenë funksional . Prandaj njëhësi i gjeneratorit nuk ka regjistruar matjet përgjatë 10 ditëve të para të testimit. Matjet janë regjistruar në pikën kyçëse (kufiri komercial)
3	ERA	KOSTT	32.4	2015	26.07.2018	11.10.2018	48	Testimi kishte zgjatur më shumë se 30 ditë, ndërsa për pagesë ishte zgjedhur periudha kur matjet kanë qenë në sasi më të lartë duke i kushtuar kështu më shumë KOSTT-it pagesa e energjisë testuese.
4	FV	KEDS	3	2015	25.09.2018	06.11.2018	18	Energjia testuese ka filluar më 18.10.2018 ndërsa ka përfunduar më 05.11.2018. Kurse pagesa ishte bërë nga data 11.10.2018, pra KOSTT ka paguar 7 ditë më shumë .
5	FV	KEDS	3	2015	01.11.2017	18.09.2019	6	Nuk kishte mangësi të identifikuar

Në vijim janë të shpjeguara në detaje çështjet që kemi identifikuar për secilin nga rastet e paraqitura në tabelë.

Prodhuksi 1: Ky prodhues kishte planifikuar fazën testuese dhe kishte dërguar në KOSTT dhe KEDS programin (deklaratën e disponueshmërisë²⁴ dhe planin kohor të testimeve) për të filluar testimin nga data 29 maj deri më 18 qershor 2019. Megjithatë kemi vërejtur se gjatë kësaj fazë testuese matësit nuk kishin regjistruar asnjë KW energji testuese në rrjet nga ky prodhues. Në regjistra matjet figurojnë zero për datat 29 maj 2019 deri më 18 qershor 2019, ndërsa rezultatet e testimit ishin dorëzuar me datë 30 maj 2019. Prodhuksi kishte filluar operimin komercial me datë 19 qershor 2019.

KOSTT e kishte mundësuar fillimin e operimit komercial pa realizuar prodhim/matje gjatë fazës testuese sikurse kishte ndodhur në praktikë gjatë testimit të prodhuesve të tjerë.

Si rrjedhojë KOSTT i ka mundësuar prodhuesit fillimin e operimit komercial pa u siguruar se ky prodhues plotëson kriteret e njëjta me prodhuesit tjerë. Në këtë rast shihet se nuk ishte respektuar praktika në krahasim me prodhuesit e tjerë për fazën e testimit.

Prodhuksi 2: Operatori i Sistemit (OS) në kuadër të KOSTT ka regjistruar matjet dhe sipas tij ky prodhues ka prodhuar 5,132 MWh gjatë testimit (22 tetor deri më 17 nëntor 2021). Ndërsa për të njëjtën periudhë, Operatori i Tregut (OT), gjithashtu në kuadër të KOSTT, këtij prodhuesi i kishte llogaritur 7,504 MWh. Kjo kishte ndodhur për shkak se njehsori i prodhuesit në fjalë nuk kanë qenë funksional përgjatë 10 ditëve të para të testimit dhe për pasojë nuk kanë regjistruar matje në njehsorë individual të prodhuesit por janë regjistruar matjet në pikën kyçëse të grupit të prodhuesve (të KOSTT). Prandaj OT ka përdorur matjet në pikën kyçëse (kufirin komercial) të grupit të prodhuesve dhe pastaj i ka ndarë matjet proporcionale për secilin prodhues të atij kufiri komercial.

Prodhuksi 3: Testimi i këtij prodhuesit kishte filluar më datë 23 gusht 2018 dhe kishte përfunduar më datë 11 tetor 2018, pra testimi ka zgjatur gjithsej 48 ditë. Ndërsa bazuar në marrëveshje për blerje të energjisë mes KOSTT dhe prodhuesve, KOSTT obligohet të paguajë maksimalisht 30 ditë të energjisë testuese pavarësisht se sa zgjatë testimit, megjithatë marrëveshja nuk e specifikon se cila periudhë nga faza testuese përzgjidhet për pagesë.

Prandaj, faturimi dhe pagesa ishte bërë për 30 ditët e fundit të testimit. Kjo ishte edhe periudha kur sasia e energjisë së prodhuar gjatë gjithë fazës së testimit ishte më e lartë. Në këtë rast energjia testuese ishte në sasi prej 6,238 MWh dhe KOSTT ka paguar shumën mbi 343 mijë euro për këtë energji. Pra, fatura për këto data është lëshuar nga prodhuesi dhe është pranuar dhe paguar nga KOSTT si e tillë.

Ndërsa, energjia e prodhuar në 30 ditët e para të testimit ishte shumë më e ulët, në sasi totale prej 2,320 MWh. Nëse KOSTT do të kishte bërë pagesën duke llogaritur 30 ditët e para kur ka filluar testimin nga data 23 gusht deri më 23 shtator 2018 pagesa totale që KOSTT do të paguante për energji testuese do të ishte 127 mijë euro, pra afërsisht 236 mijë euro më e ulët.

Sipas KOSTT përzgjedhja e ditëve të fundit të testimit për pagesë është përcaktuar në paragrafin e tretë në shtojcën 5 të marrëveshjes që është si në vijim "Palët janë pajtuar se Neto Energjia Elektrike e liferuar para datës së operimeve komerciale sipas Nenit 4 paragrafi 4.2 të kësaj Marrëveshje do të

²⁴ Neni 11.2 i marrëveshjes "Pas lëshimi të Deklaratës së Disponueshmërisë, por në çdo rast jo më vonë se Ditën në vijim, Prodhuksi duhet të kërkojë nga Operatori i Sistemit të jap energji dhe të mbaj me energji Stabilimentet Kyçëse për pranim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar".

trajtohet si energji testuese dhe çmimi për energjinë testuese do të jetë i barabartë me 60% të çmimit të energjisë sipas Tarifës Nxitëse dhe Energjia Testuese do të paguhet në vlerë maksimale prej (30) ditësh”.

Megjithatë sipas analizave tona, rezulton se marrëveshja ka mangësi në këtë pikë pasi që nuk i ka specifikuar të drejtat dhe obligimet e palëve të marrëveshjes. Ajo parashikon pagesë për 30 ditë gjatë fazës testuese, por nuk përcakton në mënyrë të qartë cilat ditë të fazës testuese duhet të përfshihen në faturim. Kjo mangësi në marrëveshje i ka dhënë prodhuesit mundësinë të veprorë në interes të vet financiar, ndërsa KOSTT nuk ka ndërmarrë asnjë veprim për ta kufizuar këtë praktikë dhe nuk ka vepruar në interes të kursimit të mjeteve të Fondit.

Prodhuesi 4: Testimi për këtë prodhues kishte ndodhur gjatë periudhës 18 tetor deri më 05 nëntor 2018 dhe sasia e energjisë së prodhuar gjatë kësaj periudhe ishte 162 MWh. Ndërsa totali i energjisë së faturuar dhe paguar nga KOSTT ishte 223 MWh, sasi kjo e cila nuk ishte e saktë. Prandaj KOSTT kishte paguar më shumë MWh se sa kishte qenë prodhimi gjatë fazës testuese.

Kjo kishte ndodhur për shkak se prodhuesi në fjalë kishte prodhuar 60 MWh tjerë gjashtë ditë para se të dorëzojë deklaratën e disponueshmërisë në KOSTT. Pra, prodhimi prej 60 MWh nuk i takon energjisë testuese sepse ishte bërë para se të fillonte formalisht testimi, përkatësisht para se të njoftojë KOSTT-in se është gati të fillojë testimin, ndërsa KOSTT-i e kishte pranuar si shpenzim.

Rrjedhimisht KOSTT kishte paguar më tepër se sa duhej të paguante në emër të energjisë testuese gjithsej 5,381 euro. Kjo përveç që është e ndaluar për shkak se rrezikon stabilitetin e rrjetit, gjithashtu kjo energji nuk ka qenë pjesë e fazës testuese dhe si e tillë nuk do të duhej të faturuhej nga prodhuesi dhe as të paguhej nga KOSTT.

Prodhuesi 5: Testimi për këtë prodhues kishte ndodhur gjatë periudhës 06 shtator 2019 deri më 05 shtator 2019. Sasia e energjisë së prodhuar gjatë kësaj periudhe ishte 62 MWh dhe përputhet me sasinë e faturuar dhe të paguar përkon me matjet dhe periudhën e matjes, pagesa ishte në rregull.

Këto mangësi kishin ndodhur sepse kriteret e përcaktuara në marrëveshjen për blerje nuk janë mjaftueshëm të definuara dhe lënë hapësirë për interpretim e për pasojë prodhuesit trajtohen në mënyrë të ndryshme. Gjithashtu, KOSTT nuk ishte siguruar që në çdo rast të ndjekë gjithë hapat e nevojshëm për testim ashtu që të shmang mangësitë që kemi identifikuar në mostrat e audituara.

Si përfundim, mos respektimi i kriterëve për fazën testuese, prodhimi i energjisë pa kaluar paraprakisht nëpër fazën e energjisë testuese, mospërputhja e matjeve me faturat e lëshuara ka ndikuar që të çojë në humbje financiare të Fondit.

Pagesat për fazën testuese janë bërë pa u bazuar saktësisht në datat e planifikuara të testimit, duke krijuar paqartësi dhe mundësi për keq llogaritje të periudhave të faturimit. Faturat nuk tregojnë qartë periudhat për të cilat janë bërë pagesat testuese, duke e bërë të vështirë verifikimin dhe ndarjen e saktë të energjisë së prodhuar gjatë fazës testuese dhe operimit komercial. Mundësia që disa prodhues të futen në prodhim pa përfunduar fazën e energjisë testuese ka krijuar standarde të ndryshme në trajtimin për gjeneratorët e ndryshëm dhe ka krijuar rrezik në stabilitetin e rrjetit të energjisë duke shkaktuar edhe ngarkesa të pa planifikuara në rrjet dhe jo balance të rrjetit.

Mungesa e Garancive Financiare për Prodhuesit dhe për Furnizuesit

Në Rregullën e Tregut²⁵, Operatori i Tregut (tutje OT) duhet të sigurojë garancinë financiare për Furnizuesit e BRE dhe për Gjeneratorët e BRE. Në rast të mos kryerjes së obligimeve nga ana e furnizuesit sikurse është pagesa e faturave, jo-balancave të energjisë, apo të ngjashme, atëherë OT mund të ekzekutojë garancinë e lënë në bankë nga furnizuesit që ka vlerën në 11.5% të pagesave vjetore²⁶.

Për të vlerësuar nëse janë zbatuar mekanizmat e sigurisë financiare që janë në fuqi ne kemi analizuar nëse KOSTT kishte siguruar garancionet financiare për gjithë furnizuesit me të cilët ka kontratë për shitjen e energjisë së ripërtërishme. Gjithashtu kemi analizuar nëse garancionet financiare janë siguruar edhe për prodhuesit me të cilët KOSTT ka marrëveshje për blerje të energjisë së ripërtërishme.

Deri në shtator të vitit 2024, KOSTT nuk kishte siguruar garancionet financiare me asnjërin nga furnizuesit me të cilët ka nënshkruar kontratë për shitjen e energjisë së ripërtërishme, edhe përkundër faktit se marrëveshjet për shitje të kësaj energjie ishin lidhur që nga viti 2017.

Në tabelën në vijim kemi paraqitur informacionet për gjashtë furnizuesit e licencuar në Kosovë me të cilët KOSTT aktualisht ka marrëveshje për shitblerje të energjisë së ripërtërishme.

Tabela 3 Garancionet financiare për furnizuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme

Emri i Furnizuesit	Data e nënshkrimit të marrëveshjes	Data e Garancionit	Afati i Garancionit
KESCO JSC SH.A.	07 Nëntor 2017	Nuk ka	
Future Energy Trading and Exchange Dynamics SH.P.K.	27 Prill 2021	03 Tetor 2024	30 Maj 2025
KEK SH.A.	18 Mars 2022	15 Tetor 2024	15 Tetor 2025
EDS International L.L.C.	12 Korrik 2024	10 Tetor 2024	17 Mars 2025
Elektrosever D.O.O	01 Korrik 2022	23 Shtator 2024	17 Mars 2025
ETMT ENERGY SHPK	30 Dhjetor 2024	24 Janar 2025	26 Janar 2026

Sikurse shihet nga tabela e paraqitur, KOSTT nuk kishte siguruar garanci financiare për asnjërin prej këtyre furnizueseve deri në çerekun e fundit të vitit 2024. Pra, për disa vite KOSTT ka shitur energjinë e ripërtërishme tek këta furnizues pa pasur të siguruar paraprakisht këtë instrument financiar që i siguron për inkasimin në kohë dhe të plotë të pagesave për shitjen e energjisë tek këta furnizues.) KOSTT kishte siguruar garancionet financiare për pesë furnizues të paraqitur në tabelë më lartë vetëm pas shtatorit 2024. Pra, KOSTT për shtatë vite (nga 2017 deri 2024) nuk ka zbatuar kriterin e garancionit financiar si një mekanizëm me rëndësi përmes të cilit do të siguronte që nëse furnizuesit nuk kryejnë pagesat ndaj KOSTT për energjinë që këta furnizues e blejnë nga KOSTT, atëherë ky i fundit mund të përdorë garancionin financiar si mekanizëm që të inkasojë fondet e veta.

Për më tepër ende nuk është siguruar garancioni financiar për furnizuesin më të madh KESCO, nëpërmjet të cilit KOSTT e shet mbi 90% të energjisë së ripërtërishme dhe me të cilin kishte lidhur marrëveshje që nga viti 2017. Procesin për sigurimin e garancionit financiar me këtë furnizues KOSTT e ka inicuar në shtator të vitit 2024, por KESCO nuk janë përgjigjur asnjëherë ndaj kësaj kërkesë të KOSTT. Prandaj në muajin Mars 2025, KOSTT kishte drejtuar kërkesën në ZRRE që të

²⁵ Rregulla e Tregut, viti 2018 neni 8

²⁶ Kontrata mes KOSTT dhe Furnizuesëve

ndërmarrin veprime pasi që nuk po arrijnë të sigurojnë garancionin financiar. Por ZRRE deri më tani nuk ka ndërmarrë asnjë veprim lidhur me këtë çështje pasi që sipas tyre të gjitha palët janë të detyruar të përmbushin përgjegjësitë e tyre në përputhje me Rregullat e Tregut. Megjithatë kjo për shkak se legjislacioni në fuqi nuk e parasheh cili është autoriteti që duhet të ndërmarrë masa dhe veprime në rastet kur furnizuesit dështojnë të dorëzojnë garancionin financiar as KOSTT dhe as ZRRE nuk kanë ndërmarrë veprim për zgjidhjen e kësaj çështje. Megjithëse, kërkesa për garanci financiare është e obliguar për furnizuesit bazuar në rregullat e tregut dhe bazuar në kontratën e shitblerjes që furnizuesit kanë me KOSTT, kjo kërkesë nuk është zbatuar.

Garancia financiare vlen edhe nëse furnizuesit nuk kryejnë obligimet financiare të jo balancave ndaj KOSTT, atëherë ky garacion financiar do të shfrytëzohej për përmbushje të obligimeve.

Arsyeja pse KOSTT nuk ka siguruar garancionet financiare për furnizuesit është sepse sipas KOSTT kjo krijon kosto shtesë për furnizuesit dhe paraqet mungesë likuiditeti financiar për ta dhe do të ndikonte direkt në rritje të çmimi të energjisë për konsumatorët. Si pasojë e mungesës së garancionit KOSTT nuk kishte arritur të inkasojë të hyrat me kohë, sidomos nga furnizuesi KESCO, që kishte vonesa deri në 211 ditë, duke cenuar likuiditetin financiar për Fondin, pasi që KOSTT nuk ka të drejtë të vonojë pagesën e obligimeve ndaj palëve tjera sikurse janë prodhuesit e energjisë së ripërtërishme ndaj të cilëve obligohet të paguajë brenda 30 ditësh.

Tabela 4 Vlerat financiare që ndërlidhen me vonesat e pagesës

Pagesat për vitin 2022		Pagesat për vitin 2023		Pagesat për vitin 2024	
Ditët në vonesë	Vlera Financiare	Ditët në vonesë	Vlera Financiare	Ditët në vonesë	Vlera Financiare
0-30	38,613.60 €	0-30	- €	0-30	27,843,666.71 €
31-90	138,075.01 €	31-90	12,026,248.53 €	31-90	21,024,392.59 €
91-120	2,403,313.97 €	91-120	10,881,036.89 €		
121-160	12,311,356.42 €	121-160	24,301,051.11 €		
161-200	17,955,672.21 €				
201-211	3,102,477.51 €				

Në mungesë të zbatimit të garancionit financiar, si një mekanizëm i paraparë me rregullore, kishte raste kur KOSTT ka iniciuar edhe kërkesë tek përmbartuesit që të obligojë furnizuesit për pagesën e borxhit të plotë dhe në kohë, megjithatë as në këtë rast nuk ka arritur të reduktojë vonesat. Edhe përkundër vonesave, KOSTT kishte vazhduar bashkëpunimin me KESCO për shkak se ishte Furnizues i licencuar i shërbimeve për shumicën e konsumatorëve.

KOSST nuk ka Garanci Financiare as nga Prodhuesit për Burime të ripërtërishme të energjisë

KOSTT nuk ka siguruar garancinë financiare nga asnjë prodhues të energjisë së ripërtërishme. Ky kriter ka për qëllim që të sigurojë KOSTT-in që nëse prodhuesit nuk arrijnë të realizojnë obligimet ndaj KOSTT-it në këto situata mund të shfrytëzohet garancia financiare për të inkasuar të hyrat që i takojnë.

Arsyeja pse KOSTT nuk ka siguruar garancionet financiare me këta prodhues është sepse, sipas tyre, KOSTT nuk i ekspozohet rrezikut financiar në raport me ta sepse detyrimet e detyrimet ndaj KOSTT janë vetëm për jo balancat dhe janë shumë më të ulëta se sa pagesat që KOSTT bën ndaj tyre për

blerje të energjisë. Prandaj edhe në raste kur këta prodhues kanë obligime financiare ndaj KOSTT, ky i fundit i zbret nga shuma e pagesës që bën ndaj prodhuesit për aq sa është vlera e borxhit të gjeneratorit ndaj KOSTT.

Mungesa e garancionit financiar për prodhuesit kishte ndikuar që këta gjeneratorë të vonojnë pagesat ndaj KOSTT mesatarisht 63 ditë duke rrezikuar likuiditetin e Fondit.

Prodhuesit e burimeve të energjisë së ripërtërishme nuk ishin pajisur me Certifikatat e Komisionimit

Njësi Gjenerues (prodhuesi) komisionohet pasi të deklarohet nga Prodhuesi dhe të certifikohet nga Operatori i Sistemit. Prodhuesi mund të përsërisë testet derisa të përmbushen kushtet për datën e operimeve komerciale²⁷.

Përkundër faktit që është kërkuar certifikatë e komisionimit²⁸ të prodhuesve të energjisë së ripërtërishme, vetëm dy prej gjashtë (sa i kemi testuar) të cilët ishin të kyçur në rrjet të KOSTT-it posedojnë një certifikatë të tillë. Ndërsa katër prodhuesit tjerë, që janë të kyçur në rrjetin e KEDS-it nuk posedojnë këtë certifikatë. Dy prodhuesit e lartpërmendur janë të kyçur në rrjetin e KOSTT-it për shkak të kapacitetit më të madh të instalimit, të cilët janë me kapacitet 32 MW, përkatësisht 34 MW.

Certifikata konfirmon komisionimin e suksesshëm të prodhuesit si dhe konfirmon që instalimet elektrike dhe mekanike janë në përputhje me rregulloret teknike si dhe se testimet operative janë kryer si duhet. Ndërsa bazuar në kronologjinë e hapave të procesit të komisionimit, certifikimi i prodhuesit bëhet vetëm pasi që i njëjti të ketë përfunduar testimet dhe të ketë dërguar tek operatori i sistemit deklaratën për kryerjen me sukses të testimeve. Vetëm atëherë operatori i sistemit verifikon testet e kryera dhe lëshon certifikatën e komisionimit që është dokumenti që certifikon prodhuesin.

Sipas KOSTT, certifikatat e komisionimit janë lëshuar vetëm për prodhuesit që janë të kyçur drejtpërdrejt në rrjetin e KOSTT-it, ndërsa për ata që operojnë në rrjetin e KEDS-it është ofruar vetëm raporti teknik i lëshuar nga KEDS, këtë dokument KOSTT e konsiderojnë ekuivalent me certifikatën e komisionimit.

Megjithatë dokumenti në fjalë nuk është i barasvlershëm/ngjashëm me certifikatën e komisionimit për nga përmbajtja dhe informacionet teknike që përmban si dhe nuk përmbush të njëjtat kërkesa, standarde teknike dhe procedurale. Për më tepër, në raport të pranimit teknik konstatohet se "plotësohen kushtet për energjizim të objektit", ndërsa në certifikatën e komisionimit kontraktohet se "Gjeneratori X i plotëson kushtet për operim". Pra konstatimi në secilin nga dy dokumentet është i ndryshëm.

Përveç kësaj, në gjitha rastet raporti teknik ishte lëshuar para se prodhuesi të fillonte testimet. Prandaj ky raport nuk vlen si një dëshmi që konfirmon se prodhuesi është certifikuar dhe nuk dëshmon se testimi i tij është kryer me sukses. Kjo praktikë krijon mospërputhje në qasjen për

²⁷ Marrëveshja për Blerje të Energjisë ndërmjet KOSTT dhe gjeneratorit.

²⁸ Neni 11.5 i marrëveshjes për shitblerje të energjisë

verifikimin e prodhuesve të kyçur në rrjet dhe sjell paqartësi nëse këta prodhues janë testuar dhe pranuar në përputhje me të njëjtat kritere të sigurisë dhe performancës operative.

Tabela në vijim paraqet informacionet e detajuara ku shihet se raporti teknik është lëshuar shumë kohë para fillimit të testimit të prodhuesve.

Tabela 5 Prodhuesit me certifikatë komisionimi dhe ata me raport teknik

Hapat se si bëhet procesi i energjisë testuese dhe pagesës sipas Marrëveshjes për blerje të energjisë (Faza: komisionimi i prodhuesëve)	Prod hues i	Raport Teknik	Deklarata e disponuesh mërisë (njoftimi nga Prodhuesi se është gati për testim)	Fillimi i testimeve të komisionim it	Sa ditë para testimit është lëshuar Raporti Teknik	Deklarata për përfundim të Suksesshëm të testimeve	Certifikata e Komisionim it	Lëshimi në operim komercial
1. Prodhuesi dhe operatori i sistemit dakordohen për programin e testimeve dhe Prodhuesi dërgon orarin e testimit tek operatori.	1	17.05.2019	28.05.2019	nuk ka	12	18.06.2019	Nuk ka	19.06.2019
	2		21.10.2021	22.10.2021		12.11.2021	17.11.2021	14.12.2021
2. Përmes deklaratës së disponueshmërisë Prodhuesi kërkon nga operatori i sistemit që të japë energji në rrjet. Kjo ndodhë më së largu 1 ditë pas deklaratës në fjalë.	3		01.08.2018	23-08-18		05.10.2018	10.10.2018	11.10.2018
3. Prodhuesi përmes një dokumenti Deklaron se janë kryer testet e komisionimit.	4	10.10.2018	17.10.2018	18.10.2018	8	05.11.2018	Nuk ka	06.11.2018
	5	05.09.2019	10.09.2019	06.09.2019	1	17.09.2019	Nuk ka	18.09.2019
4. Operatori i sistemit e certifikon me shkrim Prodhuesin (lëshohet certifikata e komisionimit) dhe kështu njësi gjenerues konsiderohet i komisionuar.	6	12.05.2023	26.06.2023	27.06.2023	46	17.07.2023	Nuk ka	18.07.2023
	7		Është lëshuar në operim komercial para vitit 2017, kontratë e trashëguar në skemë					12.04.2016
	8		Është lëshuar në operim komercial para vitit 2017, kontratë e trashëguar në skemë					01.04.2016

Si rezultat, për prodhuesit e energjisë së ripërtërishme të kyçur në rrjet të KEDS-it mungon certifikata e komisionimit që dëshmon se ata janë testuar dhe pranuar sipas të njëjtave standarde dhe procedura si prodhuesit e kyçur në rrjetin e KOSTT-it. Derisa nuk lëshohet një certifikatë komisionimi e standardizuar edhe për këta prodhues, mbetet një paqartësi në procesin e verifikimit dhe garancisë teknike të funksionimit të tyre në rrjet.

Shkaku pse prodhuesit e kyçur në rrjetin e KEDS nuk janë pajisur me certifikatë komisionimit është se KOSTT ka pranuar raportin teknik që lëshon KEDS si dokument të vlefshëm dhe ekuivalent me certifikatën e komisionimit që lëshon OST. Megjithatë, të gjithë gjeneratorët janë pjesë e Skemës, prandaj pavarësisht se në cilin rrjet kyçen, përgjegjësinë për blerjen e energjisë prej tyre e ka KOSTT, si dhe pagesën për këtë energji e bën KOSTT.

Për më tepër që edhe në marrëveshjen për shitblerje të energjisë në mes të KOSTT dhe prodhuesve janë hapat e njëjtë që duhet të përmbushen gjatë komisionimit në të dyja raste dhe bazuar në marrëveshje nuk ka ndonjë ndryshim të procesit pavarësisht se në rrjetin e cilit operator sistemi janë të kyçur këta prodhues.

Praktika të tilla të pa unifikuara dhe standardizuara paraqesin trajtim të pa barabartë të prodhuesve dhe standarde të ndryshme teknike.

3.1.2. KOSTT nuk kishte organizuar në mënyrë efikase procesin e shitblerjes së energjisë së burimeve të ripërtërishme

Në këtë pjesë janë trajtuar proceset kryesore që kanë të bëjnë me shitblerjen e energjisë së burimeve të ripërtërishme të organizuar nga KOSTT. Çështjet e adresuara këtu lidhen me: Jo balanca të larta nga prodhuesit e kësaj energjie dhe marrëveshja për 5% për jo balancat.

KOSTT-i nuk kishte menaxhuar jo balancat në mënyrë efikase

KOSTT duhet të bëjë shitblerjen e energjisë BRE dhe duhet të menaxhojë jo-balancat dhe barazimet e energjisë në përputhje me procedurat e Rregullave të Tregut²⁹. KOSTT në rolin e OT duhet të sigurojë që menaxhimi i të gjitha llogarive dhe menaxhimi i Fondit për BRE të ketë transparencë financiare dhe qëndrueshmëri duke ndjekur kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në: Rregullën e Tregut, Modelin e tregut të Energjisë Elektrike, dhe Skemën Mbështetëse.

Për të analizuar procesin e shitblerjes së energjisë së ripërtërishme, ne kemi analizuar të dhënat dhe listat për shitblerjen e kësaj energjie për vitet 2022-2024. Janë analizuar të dhënat si në vijim :

- o listat e nominimeve³⁰, (parashikimeve për prodhimin e energjisë së ripërtërishme për 24 orë, që ndodhin një ditë para prodhimit)
- o ri-nominimeve³¹ (përditësimi i parashikimeve të dhëna për një ditë para, kjo ndodhë në ditën kur ndodhë prodhimi dhe ka për qëllim rritjen e saktësisë së parashikimit),
- o matjet e energjisë³² (sasia e energjisë së ripërtërishme që është prodhuar brenda 24 orëve),
- o jo-balancat³³ (devijimet mes sasisë që është dërguar si parashikim dhe asaj që është prodhuar) nga prodhuesit e energjisë së ripërtërishme që janë pjesë e Skemës apo Kornizës së Rregulluar.

Në këto të dhëna përfshihen 31 prodhues të energjisë së ripërtërishme që janë në operim komercial (prodhim).

Në procesin e organizimit të shitblerjes së energjisë së ripërtërishme, KOSTT-i blen këtë energji nga prodhuesit dhe e shet tek furnizuesit të cilët pastaj e shesin tek konsumatorët. KOSTT-i synon që sasia e shitjes dhe blerjes të jenë të barabarta, pra të ketë balancë të plotë. Megjithatë, në rastin e energjisë së ripërtërishme një situatë e balancës totale është e pa mundur për shkak të vështirësive në parashikim të prodhimit. Sidoqoftë është shumë e rëndësishme që prodhuesit të japin

²⁹ Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1)

³⁰ Nominimi është parashikimi (ditor) që gjeneratorët e BRE apo furnizuesit (mujor) e japin mbi sasinë e energjisë që planifikon të blejë apo të dorëzojë në rrjetin elektrik për një ditë të caktuar zakonisht 1 ditë para (D-1)

³¹ Rinominimi ndodh kur pala e ndryshon parashikimin e hershëm (nominimin), zakonisht me qëllim që parashikimi i ri të jetë më i saktë se ai i kaluar. Kjo bëhet që të ruhet balanca mes prodhimit dhe konsumit.

³² Matja është ajo sasi e energjisë që realisht është prodhuar apo liferuar në sistemin energjetik

³³ Jo-balanca ndodh kur ajo që është parashikuar (nominuar) nuk përputhet me atë që realisht është konsumuar apo prodhuar.

parashikime të prodhimit sa më të sakta ashtu që diferenca mes këtyre parashikimeve dhe prodhimit të energjisë të jetë më e ulët, pra jo-balancat të mbahen në nivel sa më të ulët.

Në vijim kemi përshkruar se sa ishte KOSTT-i efikas në përdorimin e mekanizmave për menaxhim të jo-balancave. Kemi identifikuar se sasia e energjisë së parashikuar, pastaj parashikimi i përditësuar (ri-nominuar) ndryshon prej sasisë së energjisë që është prodhuar, prandaj janë shfaqur jo-balancat relativisht të larta nga ana e prodhuesve, ka raste kur në muaj të caktuar jo-balanca totale të gjithë prodhuesve ka arritur deri në 21% (*shih shtojcën 4- Parashikimet në MWh*).

Gjithashtu kemi përshkruar se si KOSTT ka organizuar procesin e shitblerjes së energjisë së ripërtëritshme, çmimet për blerje dhe për shitje të energjisë si dhe ndikimi që kishin jo balancat në Fond.

Rregulla për sasinë e lejuara të blerjes dhe shitjes

KOSTT blen gjithë sasinë e energjisë së prodhuar nga prodhuesit, pavarësisht sasisë së parashikuar nga ana e tyre. Në anën tjetër, në procesin e shitjes së kësaj energjie KOSTT e shet vetëm sasinë e energjisë së parashikuar, duke mos përfshirë sasinë shtesë që ka blerë realisht.

Tabela 6 Tabela 12 Jo balancat totale vjetore për prodhuesit

Përshkrim	2022	2023	2024
Sasia e Blere nga prodhuesit-Sipas matjeve MWh	502,270	570,326	501,434
Sasia e Shitur tek Furnizuesit- Sipas nominimeve MWh	466,517	538,273	456,458
Diferenca (Sa MWh janë blerë me shumë)	35,753	32,053	44,976

Kjo ndodhë sepse prodhuesit shesin gjithë energjinë e prodhuar tek KOSTT pavarësisht parashikimeve pasi që një gjë e tillë është përcaktuar në kontratën e shitblerjes së energjisë mes prodhuesve dhe KOSTT.

Sipas KOSTT, marrëveshja ishte bazuar në aktet ligjore dhe nën ligjore që kanë qenë në fuqi ku kërkohej që KOSTT të blejë gjithë sasinë e prodhuar, kjo me qëllim që të nxisë investimet në fushën e burimeve të energjisë së ripërtëritshme dhe arritjen e caqeve. Mirëpo ne kemi gjetur se një gjë e tillë ishte cekur vetëm në “strategjinë e energjisë 2017-2026”³⁴. Mirëpo aktet ligjore dhe nënligjore që ishin në fuqi në periudhën kur janë nënshkruar marrëveshjet i japin përparësi energjisë së burimeve të ripërtëritshme por nuk e specifikojnë qartë nëse KOSTT-i duhet të blejë tërë sasinë e prodhuar³⁵ pavarësisht nominimit (parashikimit). Ndërsa me ligjin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë i cili ka hyrë në fuqi nga muaji maj 2024 është e definuar qartë dhe e përcaktuar që KOSTT (operatori

³⁴ Strategjia e energjisë 2017-2017 fq. 26 paragrafi i parë

³⁵ Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e burimeve të ripërtëritshme të energjisë, 10/2017. Neni 11, pika 1.1.

përgjegjës) garanton blerjen e detyrueshme të energjisë elektrike të prodhuar nga prodhuesi i pranuar në skemë.

Megjithatë, deri në skadimin e këtyre marrëveshjeve me prodhuesit ekzistues vlejnë kushtet e përcaktuara në ato marrëveshje dhe shitblerja e energjisë nga KOSTT duhet të bëhet duke u bazuar në kushtet e marrëveshjes.

Në anën tjetër në kontratën e KOSTT-it me furnizuesit është përcaktuar që KOSTT të shesë vetëm energjinë e parashikuar dhe jo gjithë energjinë e prodhuar. Kjo për arsye se me legjislacion nuk mund të obligohen furnizuesit të blejnë gjithë sasinë e prodhuar por e blejnë vetëm sasinë e parashikuar.

Kjo gjendje është pasojë e politikës qeveritare për mbështetje të burimeve të ripërtërishme dhe trajtimin e veçantë që u jepet prodhuesve në kuadër të zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të energjisë së ripërtërishme. Një gjë e tillë edhe pse është bërë me qëllim të stimulimit të investimeve në energji të ripërtërishme shkakton kosto të larta të cilat barten nga konsumatorët fundor.

Blerja me çmim nxitës, shitja me çmim referent

KOSTT e blen energjinë e prodhuar nga prodhuesit me çmim më të lartë (çmimi nxitës), ndërsa e shet atë energji me çmimin më të ulët (çmimi referent), të dy çmimet të përcaktuara nga ZRRE.

Tabela në vijim paraqet çmimet minimale dhe maksimale të blerjes për MWh me të cilat KOSTT e blen energjinë nga prodhuesit të cilët kanë kontrata me tarifa nxitëse. Çmimet në tabelë janë të ndara sipas llojit të burimeve të energjisë së ripërtërishme.

Tabela 7 Vlera minimale dhe maksimale të çmimit të blerjes për secilin nga llojet e energjisë së ripërtërishme gjatë viteve 2022-2024 (çmimi është i paraqitur €/MWh)

Lloji i energjisë së ripërtërishme	Çmimi i Blerjes €/MWh		
	2022	2023	2024
Hidrocentrale	70.28 € -79.46 €	75.45 € -81.96 €	76.64 € -83.05€
Erë	85.0 € -96.93 €	91.25 € -100.83 €	93.26 € -102.17€
Solare/Diell	147.46 € -156.35 €	158.39 € -164.50 €	161.65 € -167.71 €

Nga tabela shihet se ka pasur një rritje të vazhdueshme të çmimit të blerjes nga viti 2022 deri në vitin 2024 që është si pasojë inflacionit, ku ZRRE në bazë të indeksit të inflacionit ka bërë përshtatjet vjetore të çmimeve të blerjes nga prodhuesit e energjisë së ripërtërishme. Ndërsa tabela në vijim paraqet çmimin me të cilin KOSTT e shet energjinë e ripërtërishme tek Furnizuesit.

Tabela 8 Çmimi i shitjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme

Viti	Çmimi i shitjes €/MWh		
	2022	2023	2024
Çmimi i shitjes së energjisë së ripërtërishme (Çmimi referent)	€ 65.18	€ 55.87	€ 72.85

Kjo paraqet qartë diferencën mes çmimit të blerjes dhe shitjes së energjisë e cila ka ndikim financiar në buxhetin e Fondit.

Sikurse shihet në tabelat më lartë, çmimi i shitjes është shumë më i ulët se sa çmimi i blerjes, për pasojë të hyrat e KOSTT-it nga shitja e energjisë së ripërtërishme në asnjë rast nuk mund të mbulojnë shpenzimet për blerjen e energjisë së ripërtërishme. Për të mbuluar këtë diferencë negative përdoret tarifa e Fondit e cila paguhet nga konsumatorët.

Për vitet 2022-2024 tarifa e Fondit për burimet e ripërtërishme të energjisë ishte si në vijim:

Tabela 9 Tarifa e Fondit BRE 2022-2024

Viti	2022	2023	2024
Tarifa e Fondit BRE (€/MWh)	€ 0.73	€ 3.14	€ 3.04
Të hyrat e realizuara nga Tarifa BRE	11,366,434 €	17,114,666 €	16,461,692 €

Pra sikurse shihet të hyrat nga tarifa e Fondit për burimet e ripërtërishme të energjisë ka pasur rritje të vazhdueshme prej 4 deri në 16 milion euro.

Në vijim janë paraqitur të hyrat totale vjetore për periudhën 2022-2024 që KOSTT ka pasur nga shitja e energjisë së ripërtërishme, shpenzimet që ka pas për blerjen e kësaj energjie dhe diferencën mes tyre e cila duhet të mbulohet nga tarifa e burimeve të ripërtërishme të energjisë nga konsumatorët. Sa më e madhe të jetë kjo diferencë që ka ndodhë si rezultat i jo-balancave pozitive aq më shumë rritet tarifa e burimeve të ripërtërishme në vitin vijues tarifar.

Tabela 10 Të hyra dhe shpenzimet për blerjen e energjisë BRE

Përshkrimi	2022	2023	2024
Të hyrat nga shitja	29,145,845€	31,426,989€	30,503,304 €
Shpenzimet për blerje	42,014,721€	51,049,638€	46,576,532€
Diferenca mes të hyrave dhe shpenzimeve (që duhet të mbulohen nga tarifa e BRE)	(12,868,876€)	(19,622,649€)	(16,073,228€)

Përveç të hyrave nga shitja dhe të hyrave nga tarifa sikurse janë paraqitur në tabelën më sipër, Fondi realizon edhe të hyra nga jo balancat e prodhuesve dhe të hyra nga llogaria balancuese të cilat e zbusin diferencën mes të hyrave total dhe shpenzimeve totale të Fondit (*shih shtojca 6*).

Si përfundim, rritja e shpenzimeve të blerjes së energjisë dhe ulja e të hyrave nga shitja ndikon që të rritet diferenca mes këtyre dyjave, dhe kjo ndikon në rritjen e tarifës burimeve të ripërtërishme e cila është e dizajnuar për të mbuluar këtë diferencë, e që duhet ta paguajnë konsumatorët fundorë. Si rezultat i jo balancave të larta në vitin 2022 po ashtu edhe rritjes së prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme ishte rritur edhe tarifa e Fondit BRE nga 0.73 €/MWh në 3.14€/MWh për vitin 2023. Kjo nënkupton se për një amvisëri që shpenzon energji elektrike mujore mesatarisht 1000

KWh (1MWh) është rritur çmimi i faturës së energjisë elektrike nga 0.73 € në 3.14€ për muaj vetëm në emër të tarifës së BRE.

Procesi i parashikimit të energjisë ndërmjet prodhuesve dhe furnizuesve ndryshon

Për prodhuesit, përveç parashikimit që këta e japin mbi sasinë e energjisë që planifikojnë ta prodhojnë një ditë më herët (D-1), është lejuar edhe ri-nominimi (përditësimi i parashikimit) në ditën kur ndodhë prodhimi (tregu brenda ditor D).

Ndërsa e njëjta nuk vlen edhe për furnizuesit, të cilët parashikojnë vetëm një ditë më herët dhe alokimi i energjisë bëhet duke u bazuar në parashikimin e një dite më herët. Në këtë mënyrë, prodhuesve u jepet mundësia që të përafrojnë më shumë saktësinë e parashikimeve sipas planifikimeve në ditën kur ndodhë prodhimi ashtu që të kenë jo-balanca më të ulëta. Ndërsa për furnizuesit bëhet shitja e energjisë sipas parashikimeve të një dite para se të ndodhë prodhimi(D-1).

Ky proces i vë në avantazh prodhuesit sepse ata kanë mundësi që të përafrojnë më mirë parashikimet në raport me prodhimin, deri në tri orë para se të mbyllet tregu, për të ulur jo balancat e tyre. Mirëpo, sasia e korigjuar e parashikimit të prodhuesve nuk reflektohet tek parashikimet në raport me furnizuesit sepse për ta vlen parashikimi që prodhuesit kanë bërë një ditë më herët. Rrjedhimisht, rritet edhe më shumë diferenca mes shpenzimeve që KOSTT ka për blerjen e energjisë së ripërtërishme dhe të hyrave që KOSTT pranon nga shitja e kësaj energjie.

Shkaku pse ky proces organizohet në këtë formë është sepse një gjë e tillë është përcaktuar në Rregullat e Tregut³⁶.

Për të shpjeguar se si ndikojnë këto dallime të procesit të parashikimit në të hyrat nga shitja dhe në shpenzimet e blerjes së energjisë nga Fondi kemi paraqitur të dhënat për blerjen dhe shitjen e energjisë së ripërtërishme për muajin Dhjetor 2024. Këtu kemi paraqitur sasinë e energjisë që KOSTT ka blerë nga prodhuesit, sasinë e energjisë që KOSTT ka shitur tek furnizuesit dhe parashikimet sa i përket dy palëve.

Tabela 11 Shitblerjet e energjisë për muajin Dhjetor 2024.

#	PËRSHKRIMI	SASIA DHE PAGESAT
A	Sasia e energjisë së parashikuar D-1 (MWh)-Për furnizuesin	41,689
B	Sasia e energjisë së korigjuar (rinominuar) D (MWh)-Prodhuesi	43,718
C	Sasia e energjisë së blerë nga prodhuesit (MWh)-sipas matjeve	47,305
=	Jo balanca e prodhuesve (C-B) MWh	3,587
	Energjia e shitur tek furnizuesit-Sipas parashikimeve në D-1 (MWh)	41,689
	Diferenca mes sasisë së blerë dhe asaj të shitur (MWh)	5,616
	Të hyrat nga shitja	3,037,115€
	Shpenzimet e blerjes	4,392,250€
	Diferenca mes të hyrave nga shitja dhe shpenzimeve të blerjes	(1,355,135 €)

Energjia që KOSTT ka blerë nga prodhuesit është për 5,616 MWh më e lartë se sa energjia që KOSTT ka shitur tek furnizuesit. Këtë sasi të energjisë së ripërtërishme që KOSTT nuk mund ta shesë tek

³⁶ <https://kostt.com/Content/ViewFiles/MarketOperatorOfKosovoEnergy/Rregullat%20e%20Tregut.pdf>

furnizuesit e kalon në llogarinë balancuese. Në këtë rast, KOSTT si Palë Përgjegjëse për Balancë nuk barazohet me furnizuesit, por me Llogarinë Balancuese – një sistem ku ruhen të gjitha të dhënat për energjinë e matur dhe të planifikuar. Edhe pse energjia e burimeve të ripërtërishme blihet dhe shitet veçmas, jo-balancat që ndodhin me furnizuesit nuk i llogariten vetëm kësaj energjie, por janë si pjesë e jo-balancës së të gjithë rrjetit elektrik (edhe prodhuesit jo BRE, p.sh. KEK). Në fund, me anë të barazimeve përfundimtare, KOSTT-i i llogarit fitimet ose humbjet nga këto jo-balanca në bazë të kalkulimeve ditore apo mujore.

Për këto jo-balanca, KOSTT-i siguron të hyra në llogari të Fondit që vijnë nga:

1. jo balancat e prodhuesve (një formë penalizmi për pasaktësinë në parashikime) dhe
2. mekanizmi balancues (Llogaria Balancuese/jo balancat e furnizuesve).

Për tri vitet e auditimit 2022-2024, jo balancat totale vjetore janë pozitive në secilin vit, që nënkupton se prodhuesit e burimeve të ripërtërishme kanë parashikuar çdo herë më pak dhe kanë prodhuar më shumë, duke detyruar kështu KOSTT të blejë energji që nuk mund ta shesë. Kjo i ka shkaktuar KOSTT-it shpenzime më të larta për blerje se sa do duhej.

Në vijim janë paraqitur jo-balancat totale vjetore të prodhuesve në periudhën 2022-2024. Të dhënat janë shprehur në MWh³⁷.

Tabela 12 Jo balancat totale vjetore për prodhuesit

Viti	Parashikimet e korrigjuara (D)	Matjet për Prodhues në MWh	Jo balanca në MWh
#	A	B	C=B-A
2022	459,819	502,270	42,451
2023	552,008	570,326	18,318
2024	470,322	501,434	31,112

Kur parashikimet (A) janë më të ulëta se sa matja (prodhimi) i energjisë (B), atëherë ka jo-balancë pozitive (C). Sikurse shihet jo balancat vjetore janë çdo herë pozitive.

Jo-balancat pozitive kanë vendosur KOSTT-in në pozitë të pafavorshme financiare, pasi që KOSTT është detyruar të blejë gjithë energjinë që këta prodhues kanë prodhuar, por nuk mund ta shesë gjithë sasinë që ka blerë, por shet vetëm sasinë këta prodhuesit kanë parashikuar një ditë më herët (në D-1). Prodhuesit kanë pas vazhdimisht jo-balanca pozitive dhe KOSTT vazhdimisht ka blerë më shumë energji të burimeve të ripërtërishme sa ka shitur.

Jo balancat e larta dhe çdo herë pozitive të prodhuesve kanë ndikuar që Fondi të ketë shpenzime shtesë mbi 10 milion për tri vite për blerjen e energjisë së ripërtërishme nga devijimet e parashikimit. Kjo sepse energjinë e blerë të jo balancës, KOSTT nuk e ka shitur tek furnizuesi me çmimin e shitjes (çmimi referent BRE) por e ka kaluar në llogarinë balancuese. Njëkohësisht si rezultat i këtyre jo balancave për tri vite KOSTT kishte realizuar të hyra nga prodhuesit në vlerë 5,6 milion euro dhe nga llogaria balancuese në blerë 10,6 milion euro.

³⁷ 1MWh është e barabartë me 1000KWh që është sasia mesatare mujore që amvisëritë konsumojnë në Kosovë.

Tabela 13- Të hyrat nga jo balancat 2022-2024

Përshkrimi	2022	2023	2024	Totali
Të hyrat nga mekanizmi balancues	6,880,828 €	1,690,786 €	2,098,456 €	10,670,070 €
Të hyrat nga jo balancat e prodhuesve	2,806,060 €	1,006,638 €	2,147,825 €	5,960,523 €

Në vitin 2022 të hyrat nga jo balancat janë të larta në raport me dy vitet tjera për arsye se çmimi i jo balancave ishte shumë i lartë, kjo si pasojë e faktorëve të jashtëm si kriza energjetike globale që kishte ndodhur gjatë vitit 2022. Ndërsa shihet që në vitet pasuese të hyrat janë reduktuar ndjeshëm për shkak të tejkalimit të krizës dhe uljes së çmimit të jo balancës.

Nëse jo balancat totale vjetore të paraqitura në (Tabela 12 Jo balancat totale vjetore për prodhuesit) i zbërthejmë në rrafshin e prodhuesve individual rezulton se janë tre prodhues nga 31 në total të cilët bashkërisht janë përgjegjës për mbi 80% të jo balancave totale vjetore. Këta prodhues po ashtu participojnë me rreth 52% të prodhimit total të energjisë së ripërtërishme në kuadër të skemave. Këta tre prodhues janë me energji të erës dhe secili prej tyre ka kapacitetin individual të instaluar prej 34.47 MWh. Megjithatë përveç tyre me energji të erës është edhe një prodhues i katërt i cili ka jo balanca dukshëm më të ulëta se sa këta tre, ky gjeneratorë ka kapacitetin e instaluar prej 32.4 MWh. Individualisht tre prodhues e parë kanë jo balanca që sillen prej 18% deri në 43% të prodhimit. Ndërsa prodhuesi i katërt, edhe pse operon me teknologjinë e njëjtë, pra me erë, si dhe ka kapacitetin e njëjte të instaluar me këta tre, ka jo balanca që sillen prej 15% deri 27%. Ky është tregues që pasaktësia e parashikimeve nuk është faktor që ndikon nga jashtë, sikurse janë kushtet atmosferike, por është faktor që varet direkt nga veprimet njerëzore.

Me anë të tabelës në vijim janë paraqitur jo-balancat vjetore që i takojnë vetëm këtyre tre prodhuesve. Gjithashtu, kemi paraqitur në vlerë monetare sa ka kushtuar energjia e blerë e jo-balancës për këta tre prodhues, si dhe sa kanë paguar prodhuesit në fjalë për jo balancat që kanë shkaktuar.

Tabela 14 Jo-balancat për tre prodhues me Erë që i takojnë të njëjtit investitorë

Viti	Jo balancat vjetore për 3 prodhues	Çmimi mesatar vjetor i blerjes së energjisë	Sa i ka kushtuar KOSTT-it blerja për këtë sasi (milion/€)	Pagesa e prodhuesve për këto jo balanca (milion/€)
2022	37,530	88 €	3.3 €	2.1 €
2023	15,203	93 €	1.4 €	1.8 €
2024	28,475	94 €	2.7 €	1.5 €
			7.4€	5.1€

Tabela 15 Jo balancat për prodhuesin e katërt të Erës

Viti	Jo balancat vjetore për një prodhues	Çmimi mesatar vjetor i blerjes së energjisë	Sa i ka kushtuar KOSTT-it blerja për këtë sasi (milion/€)	Pagesa e prodhuesve për këto jo balanca (milion/€)
2022	6,973	93 €	0.70 €	0.40 €
2023	4,869	99 €	0.50 €	0.50 €
2024	4,710	102 €	0.50 €	0.40 €
			1.70 €	1.30 €

Në tabelën 14 shihet se KOSTT ka paguar në total mbi 7,4 Milion Euro vetëm për sasinë e blerë të jo balancave pozitive për këta 3 prodhues, ndërsa ka pranuar të hyra në total 5.1 milion Euro nga këta prodhues në emër të jo balancave. Pra, KOSTT-it i ka kushtuar 2.3 milion euro jo balanca vetëm për këta tre prodhues. Këtë energji KOSTT edhe pse e ka blerë nga prodhuesit, nuk e ka shitur tek furnizuesit por e ka dërguar në llogarinë balancuese. Kjo energji pastaj bëhet pjesë e mekanizmi balancues ku KOSTT e menaxhon bashkë me gjithë energjinë tjetër që futet në rrjet sikurse është: energjia nga KEK, energjia e burimeve të ripërtërishme dhe energjia e importuar. Sasia e energjisë së jo balancës nga prodhuesit e energjisë së ripërtërishme është pjesë e rrjetit, por kjo energji nuk raportohet më si energji e burimeve të ripërtërishme por bëhet pjesë e gjithë sistemit energjetik në nivel vendi dhe barazohet me çmimet e jo balancës.

Ndërsa, mekanizmi i vetëm që është vendosur sa i përket arritjes së parashikimeve më të sakta nga prodhuesit e burimeve të ripërtërishme është pagesa që prodhuesit bëjnë për jo-balancat që këta shkaktajnë. Megjithatë, as ky nuk është mekanizëm efektiv sepse prodhuesit që janë pjesë e skemës mbështetëse nuk bartin përgjegjësinë për pagesën e jo-balancave për 100% sikurse kanë palët tjera. Bazuar në Skemë këta prodhues kanë përgjegjësi të paguajnë për jo-balanca vetëm 25% të kostove të jo-balancave që shkaktajnë, qoftë ato pozitive apo negative. Këtu përjashtohen prodhuesit që kanë kapacitetin instalues më të ulët se 0.5 MWh (katër nga 31 prodhues), këta prodhues nuk kanë fare kosto për jo balancat.

Ndërsa për prodhuesit që janë pjesë e kornizës së rregulluar nuk vlen rregulla e bartjes së kostos vetëm 25%. Ata bartin 100% të kostove të jo-balancave, mirëpo vetëm për rastin kur ka balanca negative. Kjo nënkupton nëse energjia e parashikuar është më e lartë se ajo e prodhuar.

Për më tepër edhe përgjegjësia për jo-balancat deri 25% ishte ndryshuar me një vendim të vitit 2019 të ZRRE. Sipas këtij vendimi pavarësisht jo balancave të shkaktuara, është limituar përgjegjësia e prodhuesve për jo balancat në 5% të total të hyrave të tyre. Prandaj, bazuar në këtë vendim, edhe pse jo balancat e prodhuesve llogariten me 25% sikurse kërkohet në rregullën për skemën mbështetëse, në fund të vitit kalendarik KOSTT bën një kalkulim për total të hyrat që prodhuesi ka pasur nga shitja e energjisë dhe i krahason me total pagesat që i njëjti i ka paguar KOSTT-it në emër të jo balancës. Nëse vlera e pagesës në emër të jo balancës nga prodhuesit tejkalon 5% e të hyrave të prodhuesit atëherë KOSTT obligohet që ti kthejë mbrapa tek prodhuesi mjetet financiare që janë mbi pragun 5% e të hyrave të prodhuesit.

Arsyeja pse jo-balancat janë në nivel të lartë është sepse nuk janë zhvilluar mekanizma efektiv që nxisin prodhuesit të bëjnë parashikime sa më të sakta. Gjithashtu mungesa e një qasje proaktive nga KOSTT të cilët nuk kanë analizuar dhe nuk kanë ndërmarrë ndonjë veprim ndaj grupit të prodhuesve që është përgjegjës për mbi 80% të jo-balancave totale ka ndikuar që jo balancat të vazhdojnë të mbesin në nivel të lartë.

Shkaku kryesor i kostove të jo balancave, është se korniza rregullative që ka qenë e vlefshme në momentin e nënshkrimit të marrëveshjeve të shitblerjes së energjisë së ripërtërishme nuk i penalizon mjaftueshëm prodhuesit për jo-balanca prandaj edhe nuk e kanë problem se në çfarë niveli do të jetë ajo. Përderisa barrën më të madhe të kostos e bartë KOSTT-i, ndërsa prodhuesit bartin vetëm me 5% të të hyrave totale vjetore, apo 25% të kostos së jo balancës nëse të hyrat nga shitja e energjisë së ripërtërishme janë më të ulëta se 5%.

Gjithashtu në këto marrëveshje nuk kishte as limit maksimal për nivelin e jo-balancave të lejuara, që nënkupton që një prodhues mund të arrijë në çfarëdo niveli të jo balancave, kjo sepse bazuar në aktet e brendshme rregullative që kanë në fuqi nuk parashihte një masë të tillë.

Në maj vitin 2024 ka hyrë në fuqi për herë të parë ligji për burimet e energjisë së ripërtërishme. Bazuar në këtë ligj, prodhuesit e energjisë solare nuk ngarkohen për jo balancat që arrijnë deri në 5%, prodhuesit e energjisë së erës nuk ngarkohen për jo balanca që arrijnë deri në 10%. Ndërsa nëse prodhuesit tejkalojnë këto limite atëherë aplikohen kushtet e jo balancave që vendosen nga ZRRE dhe rregulla e tregut. Këto rregulla vlejnë për prodhuesit e rinj që bëhen pjesë e skemës përmes ankandeve. Për më tepër bazuar në ligjin e ri të burimeve të energjisë së ripërtërishme për prodhuesit që do të bëhen pjesë e skemës së ankandeve do të vlejnë edhe rregulla tjera edhe për çmimin e blerjes. Na ketë rast do të vlejë çmimi tavan apo çmimi maksimal i fiksuar, pra nuk ofron mundësi të rritjes apo përshtatjes sipas inflacionit sikurse është aktualisht tek prodhuesit e skemave ekzistuese, rrjedhimisht edhe ne raste të inflacionit, sipas ligjit nuk lejon që kosto e energjisë së ripërtërishme të vazhdojë të rritet.

Megjithatë për prodhuesit ekzistues që janë pjesë e skemës mbështetëse vlejnë rregullat e marrëveshjes së shitblerjes në kohën e nënshkrimit dhe do të jenë në fuqi deri në skadim të marrëveshjes. Pra do të kemi raste kur prodhuesit do të shesin energjinë e tyre në KOSTT me çmime nxitëse dhe me kushtet e jo balancave të lartpërmendura deri në vitin 2032.

Prodhuesit e burimeve të energjisë së ripërtërishme nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë për sa i përket jo-balancave

Gjeneratorët e BRE që janë pjesë e Skemës mbështetëse duhet të jenë përgjegjës për 25% të kostove totale të jo-balancit, përveç Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 kWh. Ndërsa gjeneratorët e BRE që janë pjesë e kornizës së rregulluar duhet të jenë përgjegjës për të gjitha kostot e tyre të jo-balancit negativ, përveç Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 kWh³⁸; Vendimi i ZRRE i datës 5 qershor 2019 për vendosjen e pragut të jo balancave 5%.

³⁸ [Rregulla për Skemën Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjiavepdf](#)

Në një mbledhje të Bordit të ZRRE-së në vitin 2019 ishte vendosur që të ketë ndryshim sa i përket përgjegjësisë së prodhuesve të energjisë së ripërtërishme për jo balancat që janë pjesë e Skemës Mbështetëse. Bazuar në procesverbalin e mbledhjes ishte kërkuar që për këta prodhues të vendoset tavan për përgjegjësinë e tyre për jo balancat. Sipas kësaj ishte vendosur që përgjegjësia e prodhuesve për koston maksimale vjetore të jo balancave të jetë 5% dhe vlen për të gjithë prodhuesit. Ne kemi kërkuar amandamentimet e nënshkruara mes prodhuesve dhe KOSTT por kemi vërejtur se ato nuk ekzistojnë për të gjithë ata prodhues që janë pjesë e Skemës mbështetëse. Ekzistojnë vetëm për 13 prodhues që kanë marrëveshje të nënshkruar.

Ndërsa për 15 prodhuesit tjerë nuk është bërë amandamentimi i paraparë i marrëveshjes ku përfshihet "5%" e jo balancave, edhe pse kanë kaluar pesë vite nga data e vendimit. Sipas KOSTT arsyeja pse nuk është bërë amandamentimi për prodhuesit në fjalë është sepse kanë amandamentimin për konfirmim në ZRRE dhe nuk kanë pranuar konfirmimi final prej ZRRE ashtu që edhe këta prodhues të jenë pjesë e një amandamentimi të tillë. Ndërsa dëshmi për një situatë të tillë nga KOSTT kemi pranuar vetëm për dy prodhues nga këta 15.

Megjithatë, ZRRE i kanë dhënë instruksione KOSTT-it në fund të vitit 2019 për të bërë amandamentim të marrëveshjes për blerje të energjisë me të gjithë prodhuesit lidhur me aplikimin e 5%. Mirëpo, KOSTT nuk i ka bërë amandamentimet e kërkuara, prandaj çdo prodhues që ka tejkaluar 5% dhe nuk ka pas të amandamentuar marrëveshjen nuk është kompensuar për vlerën e jo balancave.

Për pasojë tetë prodhues për vitin 2022 kishin tejkaluar tavanin e jo balancave prej 5% të të hyrave nga shitja e energjisë, mirëpo nuk ishin kompensuar për diferencën. Shuma totale që duhet të kompensohet për vitin 2022 është 58 mijë euro, ndërsa për vitet 2023 dhe 2024 nuk ka prodhues pa marrëveshje për 5% që ka tejkaluar tavanin (*shih shtojca V "jo-balanca 5%" viti 2022*).

Kjo gjë ka shkaktuar trajtim jo të barabartë të prodhuesve që janë pjesë e Skemës për të cilët jo balancat llogariten me standard të dyfishtë. Një gjë e tillë i ka mundësuar që vetëm disa nga prodhuesit dhe të cilët kanë jo balancat më të larta të përfitojnë nga limitimi i përgjegjësisë për jo-balancat në 5% të hyrave vjetore nga shitja e energjisë.

3.1.3. Mangësi financiare në menaxhimin e Fondit për burimet të ripërtërishme të energjisë

Këtu kemi trajtuar çështjen e regjistrimit të pagesave për Fondin, çështjen e realizimit të pagesave dhe menaxhimin financiar të Fondit.

Borxhi ndaj llogarisë së Fondit

KOSTT, në rolin e OT-së, duhet të menaxhojë Fondin për Energjinë e Ripërtërishme (BRE) dhe të sigurojë që fondet të përdoren ekskluzivisht për mbështetjen e projekteve të energjisë së ripërtërishme³⁹ dhe duhet të dorëzojë raporte të rregullta dhe të standardizuara tek ZRRE për menaxhimin e Fondit për BRE⁴⁰.

Të gjitha transaksionet financiare që ndërlidhen me procesin e shitblerjes së energjisë së ripërtërishme regjistrohen si të veçanta në kuadër të Fondit dhe raportohen si të tilla. Ndërsa pagesat kryhen nga Departamenti i Financave. Fondi është si entitet i ndarë nga KOSTT dhe të hyrat dhe shpenzimet e Fondit llogariten të ndara dhe të pavarura nga të hyrat dhe shpenzimet e KOSTT-it dhe duhet të përdoren vetëm për qëllimet e Fondit.

Kemi analizuar regjistrat e të hyrave për Fondin për vitet 2022-2024 dhe kemi identifikuar që një pjesë e të hyrave nga Llogaria Balancuese për Fondin nuk kanë kaluar në kodin kontabël të llogarisë së Fondit. Përgjatë tri viteve të fushëveprimit të auditimit 2022-2024, KOSTT ka regjistruar si të hyra nga llogaria e mekanizmit balancues shumën prej 10.6 milion Euro, mirëpo 5.6 milion Euro prej tyre nuk ishin transferuar në llogarinë përkatëse të Fondit, megjithëse të hyrat ishin inkasuar.

Në tabelën në vijim kemi paraqitur shumën e këtyre të hyrave nga llogaria e mekanizmit balancues, e cila ende nuk ka kaluar në llogari të Fondit.

Tabela 16 Të hyrat nga Llogaria Balancuese në llogarinë e Fondit BRE

Viti	Borxhi i KOSTT ndaj Fondit BRE në milion
2022	1.5 €
2023	1.8 €
2024	2.3 €
Borxhi Total	5.6 €

Në një raport përfundimtar të ZRRE-së për të Hyrat e lejuara maksimale të energjisë elektrike për operatorët e rregulluar, (viti 2022), ishte cekur se mbi shtatë 7 milion euro ishin përdorur nga KOSTT me qëllim të “mbulimit të humbjeve nga katër komunat e veriut të Kosovës”.

Shkaku pse KOSTT nuk i kishte transferuar këto mjete në llogari të Fondit ishte sepse KOSTT i kishte dhënë përparësi pagesës së obligimeve tjera që kishte ndaj kreditorëve të tjerë, ndër tjera, për

³⁹ Rregulla për të hyrat e OT dhe OST

⁴⁰ Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.0) & Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1); Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e BRE, ZRRE/Nr.10/2017

mbulimin e kostove të energjisë në Veri, mirëpo ne nuk kemi gjetur dëshmi se pagesa është bërë nga mjetet e Fondit.

Fondi ka operuar me humbje në vitin 2023

Në vitin 2023 Fondi kishte bilanc negativ në vlerë prej 5 milion euro (shih shtojca 6 -Të hyrat dhe Shpenzimet të Fondit 2022-2024).

Nga KOSTT kemi pranuar shpjegimin si në vijim për operimin me humbje të Fondit në vitin 2023:

1. Prodhimi i burimeve të ripërtërishme të energjisë në vitin 2023 është rritur për afërsisht 10 % krahasuar me vitin 2022. Kjo ka sjellë edhe rritjen e shpenzimeve për pagesë të kësaj energjie.
2. Çmimet e jo-balanceve në vitin 2023 janë zvogëluar krahasuar me vitin paraprak duke sjellë zvogëlim të të hyrave nga Jo-balancet nga burimet e energjisë së ripërtërishme.
3. Çmimi referent në vitin 2023 është zvogëluar afërsisht 14% duke sjellë zvogëlim të të hyrave nga Furnizuesit (nga shitja e energjisë).

Ndërsa shpjegimi i dhënë në pikën 1 dhe 3 qëndron ka edhe faktorë tjerë që kanë bërë që Fondi të operojë me humbje në vitin 2023. Nga analizat tona është vërejtur se faktorët që kanë shkaktuar humbje në Fond në vitin 2023 janë:

- I. Të hyrat më të ulëta nga tarifa e Fondit, të hyrat e lejuara të Fondit nga ZRRE për vitin tarifar 2023 ishin 16.5 milion euro, ndërsa për vitin kalendarik 2023 ishin realizuar 12.7 milion euro lejuar .
- II. Shpenzimet shtesë nga inflacioni 563 mijë euro dhe jo balancat 356 mijë euro ishin shpenzime që kanë ndodhur vetëm gjatë vitit 2023- *shih shtojca 6*.

Ndërsa sa i përket çmimit të jo-balanceve nuk qëndron sepse trendi i çmimeve më të ulëta të jo balanceve ka vazhduar edhe në vitin 2024. Mesatarja e çmimit të jo-balanceve në vitin 2023 ka qenë 70 Euro/MWh, ndërsa në vitin 2024 ishte 74.5 Euro/ MWh, megjithatë në vitin 2024 Fondi kishte operuar me fitim.

Tabela 17 Çmimi Referent dhe Tarifa e Fondit

Viti	2022	2023	2024
Çmimi referent €/MWh	65.18 €	55.87 €	72.85 €
Tarifa për energjinë BRE (€/MWh)	0.73 €	3.14 €	3.04 €

Tabela 18 Të hyrat nga shitja dhe shpenzimet e blerjes

Përshkrimi	2022	2023	2024
Të hyrat e realizuara nga shitja (sipas nominimit/parashikimit)	29,145,845.00 €	31,426,989.00 €	30,503,304.00 €
Shpenzimet për Blerje	42,014,721.00 €	51,049,638.00 €	46,576,532.00 €
Diferenca	(12,868,876.00 €)	(19,622,649.00 €)	(16,073,228.00 €)

Sikurse shihet nga tabela diferenca mes të hyrave nga shitja dhe shpenzimeve të blerjes në vitin 2023 ka qenë e lartë, kjo ndodhë për disa arsye:

- çmimi i blerjes është më i lartë se sa çmimi i shitjes, gjë që shkakton KOSTT-it kosto shumë më të lartë për blerje, ndërsa inkason të hyra më të ulëta nga shitja
- sasia e energjisë së ripërtërishme që KOSTT blen është çdo herë më e lartë se sa sasia e energjisë që shet, kjo ndodhë për shkak të jo-balancave pozitive të prodhuesve.

Si përfundim, sa më e lartë që është kjo diferencë ndikon direkt që të rritet më shumë tarifa për energjinë të cilën e paguajnë konsumatorët. Kjo shihet edhe nga Tabela 17 ku tarifa në vitin 2023 ka qenë më e larta pasi që edhe diferenca mes të hyrave dhe shpenzimeve për vitin 2023 ishte më e theksuar.

KOSTT nuk ishte efikas në inkasimin e të hyrave në Fond

Furnizuesit dhe gjeneratorët e BRE duhet të përmbushin të gjitha detyrimet financiare, përfshirë pagesat për energjinë e alokuar dhe jo-balancat⁴¹. Në rast të mos kryerjes së obligimeve nga ana e furnizuesit sikurse është pagesa e faturave, jo balancave të energjisë, apo të ngjashme, atëherë OT mund të ekzekutojë garancinë e lënë në bankë nga furnizuesit që ka vlerën në 11.5% të pagesave vjetore⁴². Për vonesat në pagesa mbi 30 ditë nga pranimiti i faturës, OT llogarit interesin prej 8% për vonesat në pagesa.

Nga analizimi i regjistrimit për gjitha të hyrat dhe shpenzimet për Fondin kemi gjetur se kishte vonesa të gjata në inkasimin e të hyrave nga furnizuesit dhe gjeneratorët .

KESCO në rolin e furnizuesit më të madh të energjisë nga burimet e ripërtërishme, nëpërmjet të cilit realizohen 92% e të hyrave nga shitja dhe tarifa e kësaj energjisë, nuk kishte respektuar asnjëherë afatin prej 30 ditëve për kryerjen e obligimeve ndaj Fondit, sikurse e ka të përcaktuar në kontratën që ka me KOSTT. Ky furnizues kishte vonuar pagesat deri në 211 ditë, ndërsa vonesat mesatare të këtij furnizuesi ishin 143 ditë. KESCO nuk kishte paguar faturat për energjinë e ripërtërishme ndaj KOSTT që nga muaji tetor i vitit 2024. Këto fatura kapin vlerën prej 6.8 Milion Euro, përkundër që kishin kaluar mbi 4 muaj nga faturimi dhe ato ende ishin të pa paguara.

Përveç KESCO edhe prodhuesit të cilat kanë obligime ndaj Fondit për jo balancat e shkaktuara kishin vonesa në realizimin e pagesave ndaj KOSTT. Kishte rast kur vonesat maksimale nga prodhuesit e energjisë së ripërtërishme arrijnë deri në 292 ditë.

Në vijim janë paraqitur vonesat mesatare që KESCO, si furnizuesi kryesor, dhe prodhuesit e burimeve të ripërtërishme kishin ndaj KOSTT.

⁴¹ Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës PO-MO-002 ver.3; Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1)

⁴² Kontrata mes KOSTT dhe Furnizuesëve

Tabela 19 Vonesat e pagesave për Fondin

Vonesat mesatare të shprehura në ditë		
Viti	Vonesat e KESCO ndaj Fondit	Vonesat e Prodhuesëve ndaj Fondit
2022	143 ditë	63 ditë
2023	116 ditë	39 ditë
2024	44 ditë	36 ditë

Sikurse shihet në tabelë, KOSTT kishte hasur në vështirësi për inkasimin e të hyrave nga palët e treta veçanërisht në vitin 2022. Një faktorë që kishte ndikuar në këtë situatë ishte edhe kriza energjetike⁴³ në nivel ndërkombëtar që kishte ndodhur gjatë vitit 2022. Ngritja e çmimit të energjisë në bursa gjatë kësaj periudhe kishte krijuar vështirësi për likuiditetin e palëve. Përkundër kësaj vonesat kaq të larta janë të pa justifikueshme duke vënë KOSTT-in në vështirësi financiare.

Në anën tjetër, KOSTT edhe gjatë kësaj kohe kishte qenë shumë i saktë me pagesat e obligimeve në emër të Fondit ndaj palëve të tjera, duke mbajtur në nivel minimal vonesat për pagesën e obligimeve ndaj gjeneratorëve BRE për blerje të energjisë. Vonesat mesatare në vitin 2022 që KOSTT kishte ndaj prodhuesve ishin 39 ditë ndërsa për vitet tjera nuk kishte vonesa.

KOSTT kishte aplikuar kamatë ndëshkimit për vonesat në pagesa (8%) ndaj KESCO, por as këto nuk kishte arritur ti inkasojë. Prandaj ishte detyruar të mbledhë të hyrat përmes përmbaruesit.

Kjo sepse KOSTT nuk kishte siguruar Garancionin Financiar për furnizuesit që është një mekanizëm i cili ekzekutohet në situata të tilla si dhe mekanizëm për realizimin e të drejtave financiare në kohë. Vonesa të tilla kaq të gjata mund të ndikojnë në likuiditetin e Fondit, si dhe mund të krijojnë vështirësi në mbajtjen e stabilitet financiar jo vetëm për Fondin por edhe për KOSTT-in.

Vështirësi në gjurmimin e të hyrave të Fondit

KOSTT duhet të sigurojë që faturimi, alokimi i energjisë dhe menaxhimi i përgjegjësi të furnizuesve të kryhen në mënyrë efikase dhe transparente. KOSTT në rolin e OT duhet të sigurojë që menaxhimi i të gjitha llogarive dhe menaxhimi i Fondit për BRE të ketë transparencë financiare dhe qëndrueshmëri duke ndjekur kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në: Rregullën e Tregut, Modelin e tregut të Energjisë Elektrike, Skemën Mbështetëse.

KOSTT e ka dizajnuar procesin e pagesave në një formë që vështirëson identifikimin e pagesave që i janë të dedikuara për Fondin që iu ka mundësuar furnizuesve që të gjitha obligimet që i kanë të bëjnë si pagesa për KOSTT-in. Pastaj KOSTT ndan një shumë të caktuar nga këto mjete të inkasuara dhe e regjistron në llogarinë kontabël të Fondit.

⁴³ Në pjesën e dytë të vitit 2021 (pas covid 19) çmimet e energjisë elektrike në bursa ishin shumëfishuar kjo ka ndikuar që të shkaktohet krizë në nivel global sa i përket energjisë elektrike, kjo krizë ka prek edhe Kosovën e cila është varur nga importi i energjisë. Më 21 dhjetor 2021 çmimi në bursa ka mbërritur deri në 515 euro, këto çmime të larta kanë vazhduar edhe gjatë vitit 2022.

https://indep.info/wp-content/uploads/2022/07/INDEP_Ngritja-e-cmimeve-te-energji-se-E2%80%93masat-per-zbutjen-e-krizes_ALB-1.pdf
<https://buletinekonomik.com/2022/02/kriza-boterore-e-energji-se-elektrike-cfare-po-ndodh-ne-kosove/>

Kjo metodë e bën të vështirë të gjurmohen shumat që vijnë nga furnizuesit , gjegjësisht vështirëson identifikimin e hyrave që i takojnë Fondit.

Kjo pasi që për analizimin e transaksioneve të Fondit në aspektin financiar KOSTT nuk ka një llogari të bankës të dedikuar vetëm për Fondin e cila u mundëson palëve të treta si: ZRRE, auditorë etj, të bëjnë një krahasim të transaksioneve të regjistruara në emër të Fondit dhe atyre të inkasuara në llogarinë e Fondit.

3.2 ZRRE nuk ka qenë efektive në monitorimin e Fondit

Në këtë pjesë trajtohet qasja që ZRRE ka pasur sa i përket monitorimit të Fondit si dhe mekanizmat që ZRRE ka përdorur ashtu që të sigurohet në një menaxhim sa më efikas për Fondin nga ana e KOSTT.

ZRRE nuk ka monitoruar si duhet menaxhimin e Fondit të burimeve të ripërtërishme të energjisë

ZRRE duhet të kontrollojë dhe të monitorojë rregullisht menaxhimin e Fondit për BRE dhe funksionimin e përgjithshëm të KOSTT⁴⁴. ZRRE duhet të aprovojë të hyrat maksimale të lejuara dhe duhet të kontrollojë zbatimin e tyre⁴⁵.

ZRRE nuk ka bërë monitorim efektiv për Fondin, edhe pse OT kishte raportuar tek ZRRE për operimin e Fondit në baza tre mujore duke u bazuar në Rregullën për skemë mbështetëse të hartuar nga ZRRE. Mirëpo, ZRRE nuk ka bërë asnjë analizë apo krahasim të këtyre raporteve me aplikacionet për tarifa që ka pranuar çdo vit nga KOSTT.

Tarifa e Fondit është aprovuar në të njëjtën vlerë që është propozuar nga KOSTT pa u verifikuar saktësia e të dhënave në aplikacione, prandaj tarifa ishte aprovuar sikurse ishte propozuar, pa asnjë ndryshim. E njëjta vlen edhe për çmimin referent.

Tabela 20 Çmimi referent dhe tarifa nxitëse

Viti	2022	2023	2024
Çmimi referent i BRE- çmimi i shitjes (€/MWh)	€ 65.18	€ 55.87	€ 72.85
Tarifa për energjinë BRE	€ 0.73	€ 3.14	€ 3.04

Në mungesë të monitorimit nga ana e ZRRE, kemi identifikuar një rast kur janë raportuar të dhëna të gabuara nga KOSTT, por kjo nuk ishte identifikuar nga ZRRE. Kjo kishte ndodhur gjatë shqyrtimit tarifar për vitin 2023, ku KOSTT në aplikacionin për shqyrtimin e të hyrave kishte paraqitur se teprica në Fondin për vitin 2022 kishte qenë 4.3 Milion Euro. ZRRE ka bërë aprovimin e tarifave duke u bazuar në këto të dhëna. Pastaj një vit më vonë, pra në aplikacionin për shqyrtimin tarifar të vitit 2024, KOSTT kanë kërkuar edhe korrigjim edhe për të hyrat e lejuara të vitit 2023 pasi që ishin deklaruar se është llogaritur gabimisht mbetja 4.3 milion Euro në Fond dhe se mbetja reale ishte 1.2 milion Euro dhe sikurse edhe ishte reflektuar në raportet periodike të KOSTT lidhur me Fondin. Edhe kërkesa e tillë është aprovuar nga ZRRE pa bërë shqyrtim të shkaqeve që kanë çuar në këtë gabim.

⁴⁴ Rregulla për Skemë Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, neni 13 (<https://www.eroks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Legjislacioni/Rregullat/Rregulla%20per%20Skemen%20Mbeshtetese%20per%20Gjeneratoret%20e%20Burimeve%20e%20Ripertertishme%20e%20Energjise%20....pdf>)

⁴⁵ Rregulla për të hyrat e OST/OT (http://ero-ks.org/2017/Rregullat/Rregulla%20per%20te%20Hytrat%20e%20OST_OT.pdf)

Pra, për vitin 2023, ZRRE kishin aprovuar të hyrat e lejuara dhe tarifën për Fondin BRE duke u bazuar në të dhënat që kishin pranuar nga KOSTT për mbetjen në vitin 2022, ani pse të njëjtat kishin qenë të pa sakta. Kjo kishte shkaktuar që për vitin 2023 në Fond të llogariten të hyra nga tarifa për 3 milion Euro më pak.

Gabime të tilla ndikojnë direkt në vlerën e tarifës për Fondin, rrjedhimisht ndikojnë në pagesat e konsumatorëve - qytetarëve. Sepse efekti i një lëshimi të tillë është përcjellë pastaj edhe në vitin 2024 kur edhe ka ndodhur korrigjimi. Pra, gabimi i vitit 2022 është korrigjuar vetëm në vitin 2024 dhe kjo për shkak se ZRRE nuk ka bërë shqyrtim kritik të aplikacionit për shqyrtimin e tarifave vjetore.

Në raportin e shqyrtimit të tarifave dhe në vendimin e aprovimit nga ZRRE nuk ishin shpalosur shpjegime se cilët ishin shkaktarët për rritjen e tarifës së BRE nga 0.73 Euro/MWh sa ishte në vitin 2022 në 3.14 euro/MWh në vitin 2023. Si rrjedhojë, gjatë vitit 2023 kjo rritje ka bërë që për çdo MWh të shpenzuar konsumatorët⁴⁶ të paguajnë 2.41 euro në muaj më shumë vetëm për tarifën e Fondit krahasuar me vitin 2022.

Për më tepër të hyrat e lejuara në vitin 2023 nuk janë realizuar sipas planifikimit, duke rezultuar që Fondi të operojë me humbje prej 5 milion euro për të cilën po ashtu nuk janë ofruar shpjegime se çfarë e ka shkaktuar. ZRRE nuk kishte monitoruar as të hyrat maksimale të lejuara për Fondin BRE, pra të hyrat nga Tarifa BRE të cilat aprovohen çdo vit gjatë shqyrtimit tarifor.

Të hyrat maksimale të lejuara trajtohen veçmas për tarifën e Fondit e cila përdoret për të mbuluar diferencën mes të hyrave nga shitja e energjisë BRE dhe shpenzimeve të blerjes së energjisë BRE. *Tarifa BRE shërben për të mbuluar kostot e Fondit sikurse janë:*

- Dallimi mes çmimit referent dhe tarifës nxitëse
- Kostot e jo balancës
- Kostot për menaxhimin e Fondit.

Tarifa për BRE faturohet tek të gjithë konsumatorët fundorë, pra kjo tarifë inkasohet nga konsumi total i energjisë në vend dhe jo vetëm për konsumin e energjisë BRE⁴⁷.

KOSTT ka planifikuar që të hyrat nga tarifa për vitin 2023 të realizohen në shumë prej 16.7 milion euro, pa përfshirë përshtatjet e vitit paraprak 4,4 milion euro (mjetet e mbetura nga viti paraprak), por në fakt këto të hyra nuk janë realizuar. Në vitin kalendarik 2023 të hyrat totale nga tarifa ishin 12,6 milion euro që do të thotë se realizimi krahasim me planin ishte 75%. ZRRE nuk kishte paraqitur asnjë shpjegim se pse nuk janë realizuar të hyrat nga tarifa sikurse ishin aprovuar. Për më tepër, në fund të vitit 2023 Fondi BRE ka operuar me humbje në shumën 5.1 Milion euro. Pra, kishte devijim mes planifikimit dhe realizimit të hyrave në Fond dhe ZRRE nuk kishte kërkuar asnjë shpjegim nga KOSTT për këtë çështje. Mungesa e monitorimit dhe kontrollit efektiv nga ZRRE ka ndodhur për arsye që ZRRE kishte konsideruar se mjafton shqyrtimi i informacioneve vjetore gjatë përshtatjeve për të hyrat maksimale vjetore të lejuara për KOSTT-in.

⁴⁶ 1MWh është e barabartë me 1000 KWh prandaj një amvisëri cila gjatë një muaji shpenzon mesatarisht 1000 KWh energji pagan 3.14 Euro në vitin 2023, ndërsa kishte paguar 0.73 euro në vitin 2022.

⁴⁸ Rregulla për Skemë Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtëritshme të Energjisë, neni 13

Për pasojë ZRRE nuk kishte arritur të identifikojë rastin kur KOSTT kishte paraqitur informacione të gabuara. Prandaj ZRRE nuk ka arritur të vlerësojë se si ka performuar Fondi apo të identifikojë mangësitë e këtij procesi dhe mangësitë në menaxhimin e Fondit nga ana e KOSTT.

Inflacioni lidhur me prodhuesit nuk ishte korrigjuar si duhet

ZRRE duhet të përcaktojë dhe të miratojë tarifat nxitëse dhe ato duhet të jenë të përshtatura me inflacionin dhe çmimet e tregut⁴⁸. ZRRE duhet të përditësojë tarifat nxitëse dhe politikat e Skemës Mbështetëse në përputhje me kornizën ligjore dhe Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit referent për BRE.

ZRRE nuk kishte bërë si duhet përshtatjet vjetore të tarifave nxitëse për inflacion për prodhuesit e që janë pjesë e Skemës. Kjo është identifikuar kur një prodhues i BRE në vitin 2022 ka iniciuar kërkesë në ZRRE dhe KOSTT duke kërkuar që të korrigjohet metoda e kalkulimit të përshtatjes së inflacionit sepse sipas tyre kalkulimet e ZRRE duke u bazuar në metodën kumulative, ku për bazë kishte marrë vitin 2015 me indeks 100 (2015=100)⁴⁹ janë të gabuara. Bazuar në këtë kërkesë ZRRE kishin zhvilluar edhe disa biseda me palë si: prodhuesit e energjisë së ripërtërishme, Komiteti për Energji, ishin konsultuar edhe me Eurostat dhe kishin marrë vendim që të fillojnë me kalkulimin e inflacionit duke u bazuar në metodën e propozuar që ishte norma e ndryshimit të indeksit të inflacionit për 12 muaj.

Përveç ndryshimit të metodës së kalkulimit të inflacionit, ZRRE kanë kërkuar nga KOSTT që të kullohet dhe të bëhen korrigjime të inflacionit retroaktivisht për prodhuesit që nga viti 2017 kur ka filluar të funksionojë Fondi e deri në fund të vitit 2022 kur është rishikuar metoda e kalkulimit. Për këtë gjë nuk kishte pasur ndonjë vendim të veçantë të nxjerrë nga ZRRE, por nëpërmjet takimeve dhe pastaj nëpërmjet një kërkesë të bërë me e-mail, kishin kërkuar nga KOSTT që të bëhen korrigjimet e inflacionit.

Duke kërkuar që të realizohen pagesat për këto korrigjime të inflacionit. Si pasojë e kësaj KOSTT kishte pas shpenzime shtesë nga Fondi për korrigjim të inflacionit në vlerë prej 520 mijë euro. Këto mjete ishin kthyer mbrapa tek gjeneratorët në emër të korrigjimit të inflacionit.

Në vijim po paraqesim tarifat nxitëse për prodhuesit e BRE të aprovuara në vitin 2016 dhe çmimin e këtyre tarifave sipas inflacionit në vitin 2024.

⁴⁸ Rregulla për Skemë Mbështetëse për Gjeneratorët e Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë, neni 13 (<https://www.eroks.org/zrre/sites/default/files/Publikimet/Legjislacioni/Rregullat/Rregulla%20per%20Skemen%20Mbeshetese%20per%20Gjeneroret%20e%20Burimeve%20te%20Ripertitshme%20te%20Energjise%20....pdf>)

⁴⁹ Indeks që ZRRE e ka marrë nga Eurostat

Tabela 21 Çmimet e aprovuara të tarifave nxitëse dhe përshtatjet e inflacionit

Niveli i tarifave nxitëse të aplikueshme në BRE dhe përshtatja aktuale e inflacionit		
Burimi i Energjisë	Çmimi i tarifës nxitëse (€/MWh) aprovuar në 2016	Çmimi maksimal sipas inflacionit 2024 (€/MWh) ⁵⁰
Energjia Fotovoltaike (Solare)	136.40 €	164.23 €
Era	85.00 €	96.86 €
Hidrocentralet e vogla	67.47 €	79.34 €

Në tabelë janë paraqitur çmimi i tarifës nxitëse sikurse ka qenë i aprovuar në vitin 2016 për secilin nga llojet e energjisë BRE: Solare, Erë dhe Hidrocentrale krahasuar me çmimin për llojet e njëjta të BRE gjatë vitit 2024. Sikurse shihet krahasuar me vitin 2016 kur janë vendosur tarifatat nxitëse në vitin 2024 ka pasur rritje të çmimeve për shkak të përshtatjeve të inflacionit që ka ndodhur vit pas viti.

Përshtatja e inflacionit, rrjedhimisht edhe rritja e çmimeve ka ndodhur për arsye se në vendimin e tarifave nxitëse të vitit 2016 dhe në Rregullën për Skemë mbështetëse kërkohet që të bëhen përshtatjet e inflacionit duke përdorur indekset e harmonizuara të çmimeve të konsumit për të gjitha njësitë në Eurozonë, të publikuar nga Eurostat por nuk ishte specifikuar metoda për llogaritjen e inflacionit (viti bazë).

Ndërsa sipas ZRRE shkakut pse kanë ndryshuar formën e kalkulimit të indeksit të inflacionit është se një gjë e tillë është konfirmuar me Eurostat. Mirëpo nga komunikimi që ZRRE kanë zhvilluar me Eurostat lidhur me këtë çështje kemi vërejtur se ka vetëm një shpjegim se si funksionojnë indekset e inflacionit, por Eurostat nuk ishte dhënë rekomandim që të përdoret kjo metodologji e kalkulimit të indeksit të inflacionit për çmimet e tarifave nxitëse.

Si pasojë e ndryshimit të kalkulimit të indeksit të inflacionit, Fondi ka pas shpenzime shtesë për korrigjimin e inflacionit retroaktivisht për prodhuesit në shumë prej 520 mijë Euro. Kjo ka ndikuar që të ketë edhe rritje të tarifës dhe shpenzimeve Fondit për vitin 2023.

Kufiri prej 5% i përgjegjësisë së jo balancave për prodhuesit ka pas efekt të negativ në Fond

Gjeneratorët e BRE që janë pjesë e Skemës mbështetëse duhet të jenë përgjegjës për 25% të kostove totale të jo-balancit, përveç Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 KWh. Ndërsa gjeneratorët e BRE që janë pjesë e kornizës së rregulluar duhet të jenë përgjegjës për të gjitha kostot e tyre të jo balancit negativ përveç Gjeneratorëve të BRE me kapacitet të instaluar nën 500 KWh;

Pas një kërkesë nga Banka Botërore për Zhvillim dhe njërit nga prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë, ku kishin kërkuar ndryshimin e përgjegjësisë së tyre ndaj jo balancave, ZRRE në një mbledhje të Bordit më datë 5 qershor 2019 kishte vendosur që të bëjë ndryshim sa i

⁵⁰ Në çmimet e vitit 2024 të paraqitur në tabelë janë marrë çmimet për secilin nga gjeneratorët individualisht dhe pastaj janë grupuar sipas llojit që i takon gjeneratori përkatës ku është nxjerrë sa është çmimi i gjeneratorëve me energji: solare, erë apo hidro.

përket përgjegjësisë së jo balancave të prodhuesve që janë pjesë e Skemës Mbështetëse. Bazuar në procesverbalin e mbledhjes dhe draft marrëveshjen për blerje të energjisë, të amandamentuar nga ZRRE ishte kërkuar që për këta prodhues të ketë një prag maksimal të përgjegjësisë, deri në 5% e të hyrave vjetore nga shitja e energjisë së ripërtërishme, që ata e mbajnë për jo balanca. Kështu që pavarësisht sa të larta janë jo balancat që shkakton një prodhues, sipas këtij amandamenti, obligohet të paguajë vetëm 5% të të hyrave vjetore të shitjes.

Arsyetimi sipas ZRRE-së, në procesverbalin për amandamentim apo ndryshim nga 25% e pagesës së jo balancave në 5% të hyrave vjetore për prodhuesit, është se 25% nuk është sqaruar dhe definuar në mënyrën e duhur në rregullën për skemë mbështetëse. Me anë të këtij amandamenti të marrëveshjes specifikohet se edhe pse jo balancat për prodhuesit kalkuloohen me 25% të kostos së jo balancës, në fund të vitit nëse prodhuesit kanë paguar për jo balanca kosto që tejkalojnë 5% e të hyrave të tyre nga shitja e energjisë në KOSTT, atëherë ky i fundit i kthen mbrapa pagesat aq sa është vlere që është tejkaluar.

Prandaj ky vendim i ZRRE-së ka pasur ndikim negativ në Fondin sepse ka favorizuar prodhuesit duke ulur përgjegjësinë e tyre në raport me jo balancat, ndërsa ka ngarkuar Fondin me shpenzime shtesë. Në vazhdim janë paraqitur shpenzimet shtesë që i janë shkaktuar Fondit si rezultat i këtij vendimi.

Tabela 22 Shpenzimet shtesë për Fondin nga ulja e përgjegjësisë së jo balancave të prodhuesve

Viti	2022	2023	2024	Shpenzime totale të Fondit nga 5%
Shpenzimet e jo-balancave për 5% në Fondin BRE	2,810,65 €	1,651,658 €	152,132 €	4,614,445 €

Në tabelën 22 shohim se për vitet 2022-2024 KOSTT ka pasur shpenzime shtesë të Fondit për jo balancat në vlerë totale prej 4.6 milion Euro, që ishin mbuluar me anë të tarifës së Fondit.

Nuk janë lëshuar certifikatat e origjinës për Prodhuesit

ZRRE duhet të lëshojë certifikatën e origjinës për të gjithë prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë dhe të mbajë regjistër publik për to. Gjeneratorët e pranuar në Skemën Mbështetëse duhet të përmbushin kushtet për pagesën e garancisë dhe të fillojnë operimin brenda afateve të përcaktuara.

Certifikata e Origjinës ka për qëllim që të dëshmojë për konsumatorin se një pjesë e caktuar e energjisë është prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë. Kjo certifikatë është paraparë të lëshohet në formë elektronike nga ZRRE, aplikimi i kësaj certifikatë është përmendur në vazhdimësi në kornizat e ndryshme ligjore të cilat i referohen energjisë së prodhuar nga burimet e ripërtërishme⁵¹. Po ashtu edhe në Rregullën për Skemë Mbështetëse⁵² që përcakton çështjen e shitblerjes së energjisë së BRE thuhet se: OST i jep përparësi dispeçimit të energjisë elektrike të

⁵¹ Ligji për energjinë elektrike nr 05-L/085, Neni 8; Rregulla për të hyrat e OST/OT; Plani Kombëtar i veprimtimit për burimet e ripërtërishme të energjisë (pkvbre) 2011 - 2020.

⁵² Neni 16, pika 1

prodhuar nga burimet e ripërtërishme të energjisë, për të cilat do të lëshohen Certifikatat e Origjinës dhe rrjedhimisht energjisë elektrike të prodhuar nga njësitë gjeneruese të pranuar në Skemën Mbështetëse.

ZRRE nuk ka lëshuar certifikatat e origjinës, pasi që lëshimi i këtyre certifikatave është konsideruar i panevojshëm nga ana e ZRRE. Sipas tyre edhe po të lëshoheshin, nuk do të kishin asnjë benefit, pasi që Kosova nuk është pjesë e AIB (Association of Issuing Bodies)⁵³ që është organizata evropiane për bordet që lëshojnë certifikata në Bruksel. Megjithatë, AIB synon në mbështetjen e shteteve duke koordinuar zhvillimin e sistemeve të gjurmimit dhe lëshimit të certifikatave që vërtetojnë origjinën e energjisë, ashtu që energjia e BRE të tregtohet mes shteteve të ndryshme dhe konsumatori të ketë dëshminë se energjia që konsumon ka burimin nga energjia e pastër. Mirëpo, AIB nuk është organizatë që lëshon certifikatat e origjinës për prodhuesit e energjisë BRE në Kosovë. AIB ka rol ndërkombëtarë dhe anëtarësimi i Kosovës në këtë organizatë u mundëson prodhuesve të BRE në Kosovë që të shesin energjinë jashtë tregut vendorë. Por meqenëse këta prodhues aktualisht e shesin energjinë në tregun e Kosovës si pjesë e skemave mbështetëse, lëshimi i kësaj certifikate për gjeneratorët që janë në skemë, nuk lidhet aspak me anëtarësimin e Kosovës në këtë organizatë.

Prandaj, mos anëtarësimi i Kosovës në AIB nuk është justifikim për mos lëshimin e Certifikatave të Origjinës për prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme në Kosovë. Pasi që këta prodhues e shesin energjinë që prodhojnë në tregun e Kosovës dhe atë me tarifa nxitëse që janë shumë më të larta se sa çmimi referent i BRE. Në veçanti kjo certifikatë do duhej të lëshohet për prodhuesit e BRE që janë pjesë e Skemës, pasi që për këta prodhues institucionet përgjegjëse në vend KOSTT dhe Furnizuesit janë të obliguar të blejnë komplet sasinë e prodhuar të energjisë BRE. Për këtë energji ngarkohen konsumatorët fundorë të cilët përveç që paguajnë Tarifën mujore për BRE, gjithashtu paguajnë edhe për konsumin e energjisë së BRE, ku aplikohet çmimi referent i BRE që është dyfish më i lartë se sa çmimi i energjisë nga thëngjilli. Kjo ka ndikuar që qytetarët edhe pse paguajnë me çmime më të larta për pjesën e energjisë BRE, kjo energji nuk është certifikuar ashtu që konsumatorëve të ju që ju garantohet se kjo energji prodhohet nga burimet e ripërtërishme prandaj edhe ka çmim më të lartë.

⁵³ [Home | AIB](#)

3.3 Ministria e Ekonomisë nuk ka mbikëqyrur zbatimin e politikave të BRE

Ministria e Ekonomisë (ME) duhet të hartojë politika dhe strategji për arritjen e qaveve të energjisë së ripërtërishme dhe të monitorojë zbatimin e atyre politikave⁵⁴.

ME kishte hartuar strategjinë e energjisë 2017-2026 e publikuar në mars të vitit 2017. Në kuadër të saj Ministria kishte bërë projeksionet/caqet për secilin lloj të energjisë nga burimet e ripërtërishme duke filluar nga viti 2017 deri në vitin 2026.

Tabela 23- Caqet sipas strategjisë së energjisë 2017-2026⁵⁵

BRE	2017	2018	2019	2020	2021	2022	2023	2024	2025	2026
Solare (MW)	2	6	8	10	11	12.5	15	18	22	26.5
Biomasa (MW)	2	4	4	5	7	7	9	9	11	11
Energjia e erës(MW)	1.5	35	62	70	110	110	120	120	130	130
HC ekzisutese të vogla (MW)	74	74	74	74	74	74	74	74	74	74
HC e reja (MW)	20	91	100	107	110	110	120	120	140	160
Total	99.5	210	248	266	312	313.5	338	341	377	401.5

Në tabelë shihet që totali i kapacitetit të planifikuar deri në vitin 2020 ishte 266 MW. Ndërsa tre muaj më vonë, ishte miratuar udhëzimi administrativ 05/2017 sipas të cilit ishin planifikuar të instalohen gjithsej 793 MW nga burimet e ripërtërishme për të njëjtën periudhë. Deri në vitin 2020 të gjithë prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë të pranuar në Skemën mbështetëse kishin kapacitet total instaluar prej 310 MW apo vetëm 39% e qaveve të synuara nga Ministria.

Tabela 24 Kapacitetet e instaluar të burimeve të ripërtërishme të energjisë deri në fund të vitit 2024⁵⁶

Lloji i energjisë	Total kapacitete të instaluar MW
Hidrocentrale	90
Solare	13
Erë	207
Total kapacitete të instaluar	310

ME kishte realizuar studime të parafisibilitetit për burimet e energjisë nga uji gjatë viteve 2006, 2009 dhe 2010, ku kishte identifikuar 77 lokacione për hidrocentrale të vogla me kapacitet total prej 128 MW. Pavarësisht kësaj, caku i vendosur për energjinë e hidrocentraleve të vogla ishte 288 MW, nga të cilat 48 MW ishin ekzistuese dhe 240 MW ishin të planifikuara për tu ndërtuar si kapacitete të reja deri në vitin 2020. Pra, caqet e vendosura ishin dy herë më të larta se sa kishte rezultuar në studimet e potencialit në vend për këtë lloj të energjisë.

⁵⁴ <https://me.rks-gov.net/bre/> & Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 dhe nr 05/2023;ligji Nr. 08_L_258 për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë.

⁵⁵ Strategjia e Energjisë e Republikës së Kosovës 2017-2026, shtojca 7 fq. 61, tabela 26.

⁵⁶ Nuk është përfshirë vet-konsumi

Ndërsa në vitin 2022 ishte hartuar strategjia e re "Strategjia e Energjisë 2022" ku parashihet që deri në vitin 2031 kapacitetet e instaluara të burimeve të energjisë së ripërtërishme të arrijnë 1600 MW. Aty gjithashtu thuhet se kapacitetet ekzistuese të instaluara të burimeve të ripërtërishme të energjisë deri në vitin 2022 ishin 279 MW. Pra, Ministria ka konstatuar se në vitin 2022 kapacitet ekzistuese të instaluara nuk ishin arritur sipas projeksionit në strategjinë e energjisë 2017-2026. Kjo sepse në vitin 2022 nuk ishte arritur caku i paraparë prej 313.5 MW.

Në vitin 2023 është hartuar udhëzimi i ri administrativ⁵⁷ në të cilin janë paraqitur kapacitetet ekzistuese të instaluara (në operim komercial) deri në vitin 2023. Përveç kësaj janë bërë projeksionet edhe për vitet në vijim deri në 2030 sikurse janë paraqitur në tabelën më poshtë.

Tabela 25 – Caket sipas udhëzimit administrativ 2023⁵⁸

Kapaciteti i Energjisë Elektrike nga BRE (MW)										
BRE-EE (MW)	2021	2022	2023	2024	2025	2026	2027	2028	2029	2030
Solar fotovoltaike	10	10	10	10	210	210	375	430	490	550
Vetë-konsumator i burimeve të ripërtërishme	2	8	15	20	30	40	60	70	80	90
Biomasa solide	1	1	1	1	5	5	12	12	15	20
Era	137	137	137	137	137	237	437	557	617	677
Hidrocentrale *	132.0	132.0	132.0	132.0	135.75	135.75	135.75	135.75	135.75	135.75
Totali i Kapacitetit	282	288	295	300	518	628	1020	1205	1338	1473

Nga ajo që u përshkrua më sipër, sa i përket veprimeve të Ministrisë të ndërmarra nga viti 2017 deri në vitin 2023, shihet se ka pasur zhvillime pozitive në lidhje me monitorimin e zbatimit të politikave dhe cazeve të përcaktuara për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Në kuadër të strategjisë 2017-2026 ishte paraparë që deri në vitin 2020 të arrihet caku prej 25% i pjesëmarrjes së energjisë nga burimet e ripërtërishme në bruto konsumin final të energjisë. Për të analizuar nëse ky cak ishte arritur kemi paraqitur tabelën në vijim. Tabela 3 paraqet kapacitetin e instaluar të termocentraleve Kosova A dhe Kosova B.

Tabela 26- Kapaciteti i instaluar i termocentraleve Kosova A dhe Kosova B⁵⁹

Gjeneratorët	Startimi	Fuqia e instaluar		Minimumi teknik i fuqisë së instaluar		Fuqia e mundshme-Realizimi		Minimumi teknik i fuqisë së mundshme aktualisht	
		Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag	Në Gjenerator	Në Prag
	viti	MW	MW	MW	MW	MW	MW	MW	MW
A1	1962	65	58	40	36	0	0	0	0
A2	1964	125	112	78	70	0	0	0	0
A3	1970	200	138	138	122	144	125	135	120
A4	1971	200	138	138	122	144	125	135	120
A5	1975	210	138	138	122	144	125	135	120
Kosovë A		800	584	532	472	432	375	405	360
B1	1983	339	305	182	164	305	260	220	200
B2	1984	339	305	182	164	305	260	220	200
Kosovë B		678	610	364	328	610	520	440	400
SH.A.Kosova Thengjilli	1970	25				0	0	0	0
	1970	16				0	0	0	0
Kosovë A +Kosovë B		1519	1194	896	800	1042	895	845	760

⁵⁷ UA 02/2023 për cakun e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë

⁵⁸ Udhëzim Administrativ (me) nr. 02 /2023 për cakun e energjisë elektrike nga burimet e ripërtërishme të energjisë, Shtojca 1, fq. 6

⁵⁹ Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike për vitin 2021, Fq. 7, tabela 1.1

Sikurse shihet në tabelë, kapacitetet e instaluara të termocentraleve ishin 1519 MW, ndërsa kapaciteti i instaluar i burimeve të ripërtërishme në vitin 2021 ishte 279 MW⁶⁰. Nga kjo rezulton se pjesëmarrja e energjisë së burimeve të ripërtërishme në bruto konsumin final ishte 18.4%, që nënkupton 6.6% më pak se sa ishte caku i synuar për vitin 2020.

Këto të dhëna paraqesin vetëm caqet e parapara për sektorin e energjisë elektrike, pa përfshirë sektorët tjerë të energjisë si: transporti dhe ngrohja/ftohja që po ashtu bëjnë pjesë në bruto konsumin final të energjisë në nivel vendi. Ndërsa, për total bruto konsumin final të energjisë ishte raportuar⁶¹ se janë përmbushur caqet e përcaktuara nga Ministria për vitin 2020.

Kapaciteti total i instaluar i prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë deri në fund të vitit 2024 ishte 310 MW, që krahasuar me cakun e vendosur për vitin 2024 (shih Tabela 25 – Caqet sipas udhëzimit administrativ 2023) është tejkaluar me 10 MW.

Në strategjinë e vitit 2022-2031 është paraparë edhe hartimi i ligjit për burimet e ripërtërishme të energjisë i cili nuk kishte ekzistuar më herë në Kosovë. Në mungesë të ligjit çështja e burimeve të ripërtërishme të energjisë ishte rregulluar me anë të ligjit për energjinë elektrike, ligji për energjinë, ligjit për rregullatorin e energjisë, udhëzimeve administrative, si dhe me akte tjera nën ligjore. Në mungesë të ligjit, Ministria kishte mundësi të vendosë caqe dhe të monitorojë arritjen e tyre, por jo edhe të ndërmarre veprime konkrete për përmbushjen e tyre.


Ligji për burimet e ripërtërishme të energjisë ka hyrë në fuqi në muajin maj të vitit 2024 dhe i jep Ministrisë më shumë kompetenca për ndërmarrjen e masave dhe veprimeve konkrete lidhur me arritjen e objektivave strategjike. Ligji po ashtu i jep Ministrisë kompetencë që të zhvillojë ankande për instalimin e kapaciteteve reja të energjisë së burimeve të ripërtërishme. Ankandi i parë në Kosovë është zhvilluar nga Ministria në vitin 2024, ku është nënshkruar marrëveshja për 100 MW për energji solare. Përparësia e kësaj metode të re është se zhvillon konkurrencë mes investuesve potencial. Fituesi i ankandit ofertoj me çmim 48.88 €/MWh që në krahasim me tarifën nxitëse të Skemës mbështetëse është 164.23 euro për MWh ose, mbi 110 euro më e lirë për MWh.

Pra në mungesë të ligjit Ministria vetëm ka vendosur caqe por nuk ka qenë mjaftueshëm aktive në monitorimin dhe përshtatjen e tyre karshi zhvillimeve në sektorin e burimeve të ripërtërishme të energjisë. ME nuk ka bërë analiza që të vlerësojë efektin –në ekonomi, sektor të energjisë, në ambient - që kanë prodhuar politikat e ndërmarra nga vet Ministria për sa i përket arritjes së caqeve. Për të pasqyruar më saktësisht pjesëmarrjen e prodhimit të energjisë së ripërtërishme në krahasim me total prodhimin e energjisë në Kosovë kemi paraqitur të dhënat mbi sasinë e prodhimit total të energjisë në Kosovë në periudhën 2022 dhe 2023 dhe participimin e prodhimit të energjisë prodhuesve të energjisë së burimeve të ripërtërishme në totalin e prodhimit energjisë vendore.

⁶⁰ Bilanci vjetor i energjisë elektrike dhe termike për vitin 2021, Fq 7-9, tabelat 1.2 deri 1.4

⁶¹ Raporti i progresit "5th renewable energy progress report of the Republic of Kosovo 2020-2021"

Grafiku 2 Pjesëmarrja e burimeve të energjisë në prodhimin vendor



Sikurse shihet në grafikun më sipër, prodhuesit e burimeve të energjisë së ripërtërishme (BRE) aktualisht participojnë në total prodhimin e energjisë në vend me 9% respektivisht me 10% për vitet 2022 dhe 2023. Ndërsa pjesa tjetër e prodhimit të energjisë në vend mbulohet nga thëngjilli, përkatësisht termocentralet Kosova A dhe Kosova B, të cilat kishin pjesëmarrje në total të prodhimit vendor të energjisë prej 90% për vitin 2022 dhe 87% për vitin 2023.

Në kërkesën tonë ndaj ME lidhur me monitorimin që kanë kryer për për sa i përket funksionimit apo vlerësimin e skemave të dizajnuara nga ZRRE dhe KOSTT e të cilat kishin për qëllim arritjen e caqeve për të burimeve të ripërtërishme të energjisë duke u bazuar në Udhëzimet Administrative të ME, kjo e fundit është përgjigjur se Ministria nuk mund të kryejë monitorimin apo vlerësimin e çfarëdo skeme të dizajnuar nga ZRRE apo KOSTT dhe se bazuar në ligjin për energjinë elektrike dhe bazuar në ligjin për rregullatorin e energjisë këta dy akterë janë të pavarur në detyrat e tyre.

Megjithatë, skemat edhe pse ishin dizajnuar nga ZRRE dhe zbatuar nga KOSTT ato ishin bërë me qëllim të arritjes së caqeve të vendosura nga ME me strategjitë për energjinë dhe me udhëzimet administrative të vitit 2013 dhe 2017. Prandaj, Ministria do duhej të monitoronte nëse caqet e vendosura janë arritur me anë të këtyre skemave dhe nëse dizajnimi i skemave ishte bërë sipas objektivave të ministrisë për arritjen e caqeve për burimet e ripërtërishme të energjisë. Si pasojë e kësaj shtate, zbatimi i politikave të vendosura nga Ministria nuk ka arritur efektin e planifikuar në promovimin efikas të burimeve të ripërtërishme të energjisë. Ministria nuk ka arritur të bëjë monitorimin e zbatimit të këtyre politikave, sidomos në raport me përmbushjen e objektivave të vendosura për rritjen e prodhimit të energjisë nga burimet e ripërtërishme për të cilat është themeluar edhe Fondi.

Konkluzionet

KOSTT-i nuk kishte arritur të menaxhojë në mënyrë efikase Fondin pasi nuk ka ndërmarrë masa që të minimizojë nivelin e jo-balancave ndërmjet energjisë së parashikuar dhe asaj realisht të prodhuar. Në disa raste, parashikimet e prodhuesve nuk ishin as afërsisht të sakta në raport me prodhimin aktual, duke shkaktuar diferencë të madhe (jo-balanca), të cilat janë mbuluar financiarisht nga KOSTT-i përmes Fondit. Prodhimi real ishte pothuajse gjithmonë më i lartë se parashikimi i deklaruar nga prodhuesit. KOSTT-i ka blerë këtë tepërcë të prodhuar me çmim nxitës, kjo praktikë ka shkaktuar shpenzime shtesë mbi 10 milion euro për tri vite për blerjen e energjisë mbi sasinë e parashikuar. Kjo sepse energjinë e blerë të jo balancës nuk e ka shitur tek furnizuesi me çmimin e shitjes (çmimi referent) por e ka kaluar në llogarinë balancuese, ku është paguar në emër të jo-balancës të cilat ndryshojnë orë për orë varësisht nga lëvizjet në bursa. Kjo gjë ka ndikuar negativisht në qëndrueshmërinë financiare të Fondit për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Zyra e Rregullatorit të Energjisë nuk ka ushtruar monitorim efektiv mbi mënyrën se si KOSTT-i ka menaxhuar Fondin. Edhe pse KOSTT-i i ka dërguar informacionin periodik, ZRRE nuk i kishte analizuar këto të dhëna për të ndërmarrë veprime korrigjuese që do të siguronin një menaxhim të efikas të Fondit. Për më tepër, tarifa për burimet e ripërtërishme të energjisë e cila i ngarkohet drejtpërdrejt qytetarëve, kishte ndryshuar duke u rritur ndjeshëm – duke u katërfishuar në vitin 2023, nga 0.73 euro për MWh në vitin 2022, në 3.14 euro për MWh.

Ministria e Ekonomisë, si përgjegjëse për të hartuar politika për zhvillimin e sektorit të energjisë, nuk kishte bërë monitorim të mjaftueshëm mbi zbatimin e këtyre politikave. Fillimisht, para se të vendosë caqet nuk ishte bazuar në analizat e parafisibilitetit që kishin vlerësuar potencialin gjenerues të energjisë nga burimet e ripërtërishme të ujit. Edhe pse qëllimi i politikës energjetike ishte që deri në vitin 2020 të instalohen burime të ripërtërishme të energjisë në kapacitet prej 800 MW, deri në vitin 2024 ishin instaluar 310 MW që përfaqëson më pak se 40% të caqeve të përcaktuara.

KOSTT nuk i ka trajtuar në mënyrë të njëjtë të gjithë prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme gjatë fazës së testimit. Dy prej tyre janë paguar më shumë sesa duhet, duke shkaktuar shpenzime të panevojshme për Fondin. Kjo ka ndodhur për shkak të paqartësive në marrëveshjet për blerje, të cilat lejojnë interpretime të ndryshme dhe sjellin trajtim të pabarabartë. Kjo situatë mund të krijojë pakënaqësi mes investitorëve dhe të ndikojë negativisht në nxitjen e investimeve të reja në këtë sektor.

Gjithashtu, KOSTT nuk ka amandamentuar kontratat me të gjithë prodhuesit, duke mos zbatuar kriteret në mënyrë të njëtrajtshme për të gjithë. Përveç kësaj, KOSTT nuk ka zbatuar kriterin për sigurimin e garancioneve financiare as me prodhuesit e burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe as me furnizuesit. Kjo ka rritur rrezikun financiar për Fondin, pasi në mungesë të garancioneve, KOSTT nuk ka pasur mundësi të mbrohet kur ka pasur vonesa në inkasim të të hyrave. Moszbatimi i këtij mekanizmi ka ndikuar në dobësimin e sigurisë financiare dhe ka rritur mundësinë për mungesë likuiditeti në Fond.

KOSTT e bazon shitjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme vetëm në sasinë që prodhuesit e parashikojnë paraprakisht, jo në sasinë reale që prodhojnë. Kjo ka bërë që KOSTT të blejë më shumë energji nga prodhuesit sesa mund të shesë, pasi prodhuesit zakonisht prodhojnë më shumë sesa nominojnë (jo-balanca pozitive). Kjo tepërcë energjie futet në llogarinë balancuese, por të hyrat që dalin nga kjo llogari janë dukshëm më të ulëta se ato që do të realizoheshin nëse parashikimet do të ishin më të sakta. Për pasojë, sa më i lartë të jetë niveli i jo-balancave, aq më shumë rriten shpenzimet e KOSTT-it për blerjen e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë.

ZRRE nuk e ka monitoruar siç duhet menaxhimin e Fondit për energjinë e ripërtërishme, mungesa e komunikimit me KOSTT-in ka bërë që disa marrëveshje për blerje të energjisë të mos ndryshohen, duke krijuar trajtim të pabarabartë për prodhuesit dhe rrezik për shpenzime shtesë në të ardhmen. Po ashtu, ZRRE nuk ka vepruar për të siguruar dorëzimin e garancioneve financiare nga furnizuesit, edhe pse KOSTT kishte ngritur shqetësime për këtë.

Për më tepër, ZRRE ka ulur përgjegjësinë financiare të prodhuesve për jo-balancat nga 25% në vetëm 5%, gjë që ka rritur koston për KOSTT-in. Kjo ka ulur motivimin e prodhuesëve për të parashikuar saktë prodhimin, sepse ndëshkimi financiar për devijimet është më i ulët. ZRRE gjithashtu nuk kishte llogaritur si duhet inflacionin për tarifat nxitëse, duke i shkaktuar Fondit shpenzime shtesë në shumë prej 520 mijë euro për pagesa retroaktive ndaj prodhuesve që nga viti 2017 deri në vitin 2022.

Rekomandimet

Për të siguruar rritje të efikasitet të Fondit rekomandojmë që KOSTT:

1. Të definojë qartë dhe saktë kushtet dhe kriteret e fazës testuese për secilin prodhues që bëhet pjesë e çfarëdo skeme në kuadër të Fondit ashtu që mos të lejojë hapësirë për interpretime të ndryshme në mënyrë që të sigurojë konsistencë dhe trajtim të njëjtë të prodhues.
2. Të zhvillojë mekanizma kontrolli dhe të realizojë inspektime me qëllim të përmirësimit të zbatimit të rregullave të matjes (leximi i matjeve nga gjeneratori individual) dhe faturimit në fazën testuese në mënyrë që të sigurohet se matjet që pranon nga operatorët e shpërndarjes e po ashtu edhe nga prodhuesit të jenë të sakta.
3. Të ndërmarrë të gjitha veprimet ligjore për të realizuar kërkesën për garancione financiare nga të gjithë furnizuesit dhe prodhuesit. Të përdorë çdo mekanizëm që ka në dispozicion për të inkasuar plotësisht dhe në kohë të hyrat nga palët e treta.
4. Të dizajnojnë procesin e menaxhimit të mjeteve financiare të Fondit në atë mënyrë që transaksionet financiare të dedikuara për Fondin të jenë lehtë të identifikueshme në mënyrë të sigurojë transparencë dhe llogaridhënie financiare në çdo kohë.
5. Të ketë qasje proaktive dhe të zhvillojë komunikimin të vazhdueshëm me prodhuesit lidhur me saktësinë e nominimeve të tyre, të kërkojë në vazhdimësi saktësi në nominime nga prodhuesit që janë përgjegjës për jo-balanca në nivele më të larta.
6. Të zhvillojë qasje sistematike për të siguruar trajtim të drejtë dhe të barabartë për të gjithë prodhuesit dhe në rast të zbatimit të një kriteri të caktuar për një prodhues që është pjesë e skemës, i njëjti të vlejë për të gjithë, në veçanti sa i përket testimit dhe jo balancave.

Rekomandojmë ZRRE-në që:

7. Të monitoroj Fondin dhe të dokumentojë rezultatet e nxjerra nga monitorimi, në mënyrë që vendimet që i merr të jenë vendime të bazuara në informata (të dhëna të sakta).

Rekomandojmë Ministrinë e Ekonomisë:

8. Politikat që do t'i hartojë në të ardhmen për burimet e ripërtërishme të energjisë të jenë në harmoni me potencialin dhe resurset e vendit bazuar në analizat paraprake për burimet e ripërtërishme të energjisë në Kosovë.
9. Të bëjë analiza rreth ndikimit të politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë në sektorin e energjisë dhe të hartojë raporte mbi zbatimin dhe efektin e politikave dhe cazeve të vendosura për burimet e ripërtërishme të energjisë.

Shtojca I: Kriteret, fushëveprimi dhe metodologjia auditimit

Problemi i auditimit

Kosova ka ndërmarrë disa hapa për të shtuar prodhimin e energjisë elektrike nëpërmjet burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe për të ulur varësinë aktuale energjisë në burime të linjitit. Megjithatë, institucionet kryesore si: ME, ZRRE dhe KOSTT hasin probleme e sfida të ndryshme lidhur me funksionimin dhe zhvillimin e kapaciteteve të reja të BRE si dhe mirëmbajtjen dhe menaxhimin e atyre ekzistuese. Gjithashtu, ekzistojnë edhe sfida dhe probleme të ndryshme sa i përket skemave nxitëse të financimit të energjisë nga BRE.

Këto sfida dhe vështirësi janë identifikuar nga raporte të ndryshme apo edhe në media⁶².

Në lidhje me financimin e energjisë së BRE më konkretisht Fondit për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë ka pasur shqetësime të ngritura edhe nga Kuvendi i Kosovës, të cilat ndërlidhen me menaxhimin e Fondit për BRE, tejkalimin e këtij fondi (nga vlera e aprovuar/lejuar), marrëveshjet e KOSTT me furnizuesit dhe gjeneratorët e BRE, çështje rreth përdorimit jo të drejt të mjeteve nga Fondi i BRE etj.

Në anën tjetër, në një raport të ZRRE-së thuhet se në mungesë të fondeve tjera për mbulimin e humbjeve në katër komunat e veriut, KOSTT ka shpenzuar një pjesë të mjeteve të Fondit të BRE për këtë qëllim⁶³. Po ashtu në raportin e KOSTT për të Hyrat Maksimale të Lejuara 2022 thuhet se janë shfrytëzuar 7.02 milion€ nga Fondi për mbulimin e humbjeve të energjisë elektrike në Veri⁶⁴.

Një problematikë tjetër lidhur me Fondin është operimi me humbje në vitin 2023. Fondi ka operuar me një humbje prej 5.1 milion⁶⁵ € në vitin 2023, kjo tregon për probleme me menaxhimin e fondeve të dedikuara për BRE.

Mangësitë me: jo balancat e energjisë së BRE, nominimet/devijimet, vonesat në pagesa, mangësitë në faturime për sa i përket diferencës mes energjisë së nominuar dhe energjisë që është liferuar, mangësitë në barazime me furnizues dhe gjeneratorët e BRE, janë disa nga problematikat që ka ndikim në menaxhimin e të hyrave dhe shpenzimeve të Fondit të BRE.

Gjithashtu edhe mangësitë në raportime, monitorime, në arritje të planifikimeve dhe parashikimeve, apo mos arritjen e caqeve të vendosura nga Qeveria për prodhimin e energjisë nga

⁶² <https://www.radiokosovaelire.com/kostt-nga-mosbalanca-ne-konsumin-e-energji-se-ne-vend-jane-shkaktuar-devijime-ne-sistemin-interkonektiv/> ; <https://buletiniekonomik.com/2021/12/kostt-nga-viti-2017-bleu-energji-elektrike-ne-vlere-te-mbi-65-milione-eurove-nga-bre-te/> ; E dekarbonizuar deri më 2050. Ku qëndron Kosova sot?

⁶³ Raport i monitorimit në lidhje me blerjet e energjisë elektrike pagesat dhe nominimet për operatorin e sistemit të transmetimit (KOSTT) 2022

⁶⁴ Raport përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale të Energjisë Elektrike për Operatorët e Rregulluar Përgjigje ndaj Komenteve (Viti relevant tarifar 2022).

⁶⁵ Pasqyrat Financiare të KOSTT për vitin 2023

burimet e ripërtërishme janë disa nga sfidat dhe vështirësitë sa i përket prodhimit të energjisë nga BRE.

Kriteret e auditimit⁶⁶

Për të vlerësuar procesin e Fondit për BRE dhe arritjen e caqeve të BRE ne kemi përcaktuar kriteret si më poshtë:

KOSTT duhet të nënshkruajë dhe menaxhojë Marrëveshjet për Blerje të Energjisë (MBE) me gjeneratorët e BRE-ve sipas dispozitave ligjore dhe rregulloreve të tregut dhe të sigurojë drejtësi dhe transparencë në alokimin e energjisë dhe pagesave ndaj gjeneratorëve të BRE-ve⁶⁷.

KOSTT, në rolin e OT-së, duhet të menaxhojë Fondin për Energjinë e Ripërtërishme (BRE) dhe të sigurojë që fondet të përdoren ekskluzivisht për mbështetjen e projekteve të energjisë së ripërtërishme dhe duhet të dorëzojë raporte të rregullta dhe të standardizuara tek ZRRE për menaxhimin e Fondit për BRE⁶⁸.

KOSTT duhet të menaxhojë jobalancat dhe barazimet e energjisë në përputhje me procedurat e Rregullave të Tregut⁶⁹. KOSTT gjithashtu duhet të sigurojë se faturat dhe kalkulimet për alokimet e energjisë të jenë të sakta dhe transparente⁷⁰.

KOSTT duhet të sigurojë që faturimi, alokimi i energjisë dhe menaxhimi i përgjegjësive të furnizuesve të kryhen në mënyrë efikase dhe transparente. Furnizuesit/gjeneretarorët e BRE duhet të përmbushin të gjitha detyrimet financiare, përfshirë pagesat për energjinë e alokuar dhe jobalancat⁷¹.

KOSTT duhet të dorëzojë raporte të plota, të sakta dhe në kohë mbi menaxhimin e Fondit për BRE dhe operimin e tij. Raportimi dhe proceset e menaxhimit duhet të jenë të qarta dhe të qasshme për të gjitha palët e interesit.

KOSTT në rolin e OT duhet të sigurojë që menaxhimi i të gjitha llogarive dhe menaxhimi i Fondit për BRE të ketë transparencë financiare dhe qëndrueshmëri duke ndjekur kërkesat dhe kushtet e përcaktuara në: Rregullën e Tregut, Modelin e tregut të Energjisë Elektrike, Skemën Mbështetëse.

KOSTT duhet të zbatojë kushtet e përcaktuara në lidhje me menaxhimin e Fondit dhe administrimin e marrëveshjeve për blerje të energjisë (MBE) sipas kërkesave në Licencën për OT, Rregullën e

⁶⁶ Për më shumë informata konsultoni ISSAI 300, Criteria, p.7

⁶⁷ Dizajni i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës (DTEEK) DT-KSHE-005, ver. 1.0 & Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës PO-MO-002 ver.3; Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e BRE, ZRRE/Nr.10/2017;

⁶⁸ Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.0) & Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1); Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e BRE, ZRRE/Nr.10/2017

⁶⁹ Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1)

⁷⁰ Të drejtat dhe obligimet e përcaktuara në kontratën mes KOSTT dhe Furnizuesëve & MBE mes KOSTT dhe Gjeneratorëve të BRE

⁷¹ Modeli i Tregut të Energjisë Elektrike të Kosovës PO-MO-002 ver.3; Rregulla e Tregut PO-MO-001 (ver. 3.1)

Tregut, në Skemën Mbështetëse, Rregullën për të hyrat e OST dhe OT, kushtet e përcaktuara në marrëveshjet e MBE si dhe kornizat ligjore relevante⁷².

Në rast të mos kryerjes së obligimeve nga ana e furnizuesit sikurse është pagesa e faturave, jo balancave të energjisë, apo të ngjashme, atëherë OT mund të ekzekutojë garancinë e lënë në bankë nga furnizuesit që ka vlerën në 11.5% të pagesave vjetore⁷³.

ZRRE duhet të lëshojë certifikatën e origjinës për të gjithë prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtëritshme të energjisë dhe të mbajë regjistër publik për to⁷⁴.

ZRRE duhet të përcaktojë dhe të miratojë tarifat nxitëse dhe ato duhet të jenë të përshtatura me inflacionin dhe çmimet e tregut. Gjeneratorët e pranuar në Skemën Mbështetëse duhet të përmbushin kushtet për pagesën e garancisë dhe të fillojnë operimin brenda afateve të përcaktuara⁷⁵.

ZRRE duhet të kontrollojë dhe të monitoroj rregullisht menaxhimin e Fondit për BRE dhe funksionimin e përgjithshëm të KOSTT.

ZRRE duhet të përditësoj tarifat nxitëse dhe politikat e Skemës Mbështetëse në përputhje me kornizën ligjore dhe Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit referent për BRE⁷⁶.

ZRRE duhet të aprovojë të hyrat maksimale të lejuara dhe duhet të kontrollojë zbatimin e tyre.⁷⁷

Ministria e Ekonomisë (ME) duhet të hartojë politika dhe strategji për arritjen e caqeve të energjisë së ripërtëritshme dhe të monitorojë zbatimin e atyre politikave⁷⁸.

⁷² Licenca e KOSTT me nr licencne ZRRE/Li_16/17; Rregulla e tregut PO_MO-001- ver. 3.0 & PO_MO-001- ver. 3.1; Rregulla për skemën mbështetëse për gjeneratorët e BRE, ZRRE/Nr.10/2017; Rregulla për vendosjen e të hyrave maksimale për KOSTT, ZRRE/Nr. 03/2017

⁷³ Kontrata mes KOSTT dhe Furnizuesëve

⁷⁴ Rregulla për krijimin e sistemit të certifikatave të origjinës për energjinë elektrike të prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, mbeturinat si dhe nga bashkëprodhimi i kombinuar me nxehtësinë, në një njësi të vetme gjeneruese-ZRRE

⁷⁵ Metodologjia për llogaritjen e çmimit referent për energjinë e BRE- Metodologjia ZRRE/NR. 01 /2020;

⁷⁶ Metodologjia për llogaritjen e çmimit referent për energjinë e BRE- Metodologjia ZRRE/NR. 01 /2020; Rregulla për skemën e BRE, ZRRE/Nr.10/2017

⁷⁷ Rregulla për vendosjen e të hyrave maksimale për KOSTT, ZRRE/Nr. 03/2017

⁷⁸ <https://me.rks-gov.net/bre/> & Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 dhe nr 05/2023;ligji Nr. 08_L_258 për promovimin e burimeve të ripërtëritshme të energjisë.

Fushëveprimi i auditimit

Fushëveprimi i këtij auditimi do të përfshijë: Ministrinë e Ekonomisë, Zyrën e Rregullatorit të Energjisë dhe Operatorin e Sistemit, Transmetimit dhe Tregut Sh.A:

Fushëveprimi i auditimit do të jetë i ndarë në dy aspekte si në vijim:

- Auditimi do të mbulojë periudhën 2017-2024, me qëllim që të marrim për bazë tarifat nxitëse dhe marrëveshjet që janë pjesë e skemës mbështetëse si dhe veprimet e ministrisë lidhur me masat e burimeve të ripërtërishme të energjisë. Këtu vlerësohen proceset si: nënshkrimi i marrëveshjeve, vendimi i tarifave nxitëse, themelimi i Fondit, caqet e burimeve të ripërtërishme të energjisë etj. Këto janë procese që kanë ndodhur vetëm një herë por nga të cilat varet forma si funksionin Fondi.
- Ndërsa për të vlerësuar funksionimin e Fondit dhe proceset ditore të Fondit sikurse janë organizimi i shitblerjes së energjisë, parashikimet, jo balancat, pagesat nga Fondi do të merret periudha 2022-2024.

Në kuadër të KOSTT do të fokusohemi në Departamentet përkatëse si:

Departamenti i Planifikimit të Sistemit, Operimit dhe Divizioni për Investime të cilët janë përgjegjëse për integrimin e kapaciteteve të reja dhe menaxhimin e rrjedhës së energjisë së BRE-ve në rrjet.⁷⁹ Operatori i Tregut që është përgjegjës për administrimin e marrëveshjeve për blerje të energjisë nga BRE si dhe për menaxhimin e Fondit të BRE. Departamentin për Çështje rregullative dhe tarifave si dhe në departamentin e Financave.

Fokusi kryesor do të jetë në ekzaminimin e marrëveshjeve që janë në fuqi për blerje të energjisë së BRE mes KOSTT dhe gjeneratorëve të BRE, si dhe menaxhimi i Fondit të BRE për periudhën 2022-2024, me fokus të veçantë në: pagesat, të hyrat, nominimet e energjisë së gjeneratorëve të BRE, shitjet dhe liferimi i energjisë, jo balancat e gjeneratorëve të BRE dhe OT, taksën e furnizueseve për BRE, llogaritë tjera të cilat do të mbulohen nga Fondi për BRE-të. Po ashtu në KOSTT do të fokusohemi edhe në menaxhimin e kontratave me gjeneratorët e BRE që janë bërë pjesë e Skemës mbështetëse para vitit 2020.

Në kuadër të ZRRE do të fokusohemi në:

Departamentin e Rregullimit të Tregut si dhe Departamentin e tarifave që janë përgjegjës për menaxhimin e tarifave dhe licencave për prodhuesit e BRE. Do të analizohen feed-in tarifat (tarifave nxitëse) për gjithë gjeneratorët e aprovuar në kuadër të Skemës deri në vitin 2020 kur edhe është shfuqizuar tarifa nxitëse⁸⁰. Këtu përfshihen edhe ata gjeneratorë të cilët kanë filluar punën efektisht pas vitit 2020 mirëpo kanë qenë të pranuar në Skemë para shfuqizimit të Tarifës nxitëse. Divizionin e Monitorimit dhe Zbatimit për mbikëqyrjen e rregulloreve dhe kontratave për BRE si dhe monitorimin e Fondit të BRE dhe të Hyrave të Lejuara.⁸¹

⁷⁹ Ligji Nr. 05/L-085 për Energjinë Elektrike, neni 7, neni 8 dhe neni 15.

⁸⁰ Tarifa nxitëse (Feed-in Tariff) është një tarifë që garanton prodhuesve të energjisë së renovueshme një çmim mbi nivelin e tregu. (burimi: <https://www.investopedia.com/terms/f/feed-in-tariff.asp>)

⁸¹ Ligjin për Rregullatorin e Energjisë, neni 15 dhe neni 16. Ligji për Energjinë Elektrike, neni 14 dhe neni 16.

Në kuadër të Ministrisë të Ekonomisë fokusi do të jetë në departamentin për Energji dhe miniera përkatësisht tek divizioni për BRE ku do të analizojmë mbikëqyrjen dhe raportimin e rregullt të zbatimit të politikave për BRE dhe vlerësimin e masave të ndërmarra për arritjen e caceve.

Me qëllim të gjithëpërfshirjes së gjeneratorëve nga BRE si: uji, era, dielli, etj që kanë qenë pjesë e Skemës, do të merren për analizë marrëveshjet për blerje të energjisë së BRE që janë pjesë e Skemës mbështetëse dhe ato me kornizë të rregulluar. Këto marrëveshje kanë kohëzgjatje 10-12 vjeçare. Ndërsa për vlerësimin e menaxhimit të Fondit të BRE do të analizohen të dhënat dhe informacionet për të hyrat dhe pagesat përgjatë 3 (tri) viteve të fundit (2022-2024).

Auditimi do të mbulojë periudhën nga viti 2022 deri në vitin 2024, ndërsa për analizim të tarifave nxitëse merret për bazë viti 2020 sepse pas kësaj periudhe janë shfuqizuar tarifat nxitëse⁸².

Metodologjia e auditimit

Për të mbledhur dëshmi gjithëpërfshirëse dhe për të vlerësuar performancën e menaxhimit të burimeve të ripërtërishtme të energjisë, metodologjia e auditimit do të përfshijë ekzaminimin e hapave të mëposhtëm:

- Dokumentet, udhëzimet, rregulloret, politikat, procedurat, kontratat, raportet dhe të dhënat përkatëse;
- Analizimi i planeve dhe raporteve vjetore, monitorimeve të rregullta nga Ministria e Ekonomisë (ME), ZRRE dhe KOSTT dhe krahasimi i të dhënave të raportuar për BRE-të.
- Verifikimi i kontratave aktive mes KOSTT dhe gjeneratorëve të BRE.
- Verifikimi i kontratave mes KOSTT dhe furnizuesëve dhe transmetuesëve të BRE;
- Analizimi i të dhënave historike, duke përfshirë, feed-in tarifat, nominimet, raportimet, barazimet, mbulimet e humbjeve nga fondi, pagesat, garancionet bankare të realizuara nga KOSTT;
- Analiza e feed-in tarifave dhe pagesave për prodhuesit e BRE.
- Vlerësimi i detyrimeve ndërkombëtare (arritja e caceve) të Kosovës në kuadër të dekarbonizimit deri në periudhën 2020;
- Menaxhimi i Fondit të BRE për periudhën 2022-2024, duke bërë analizimin dhe evidentimi i faturimit të rregullt, pagesave dhe barazimit të KOSTT me secilin nga furnizuesit e energjisë që janë të licencuar në Kosovë. Po ashtu për të llogaritur nëse janë paguar dhe evidentuar kostot për jo balancat e energjisë (diferenca mes energjisë ditore/mujore të nominuar dhe asaj të liferuar), duhet të kontrollohen raportimet dhe të dhënat e rregullta mujore që KOSTT ka regjistruar për të gjithë gjeneratorët e BRE.
- Analizohen të hyrat dhe pagesat për secilin gjeneratorë për periudhën 2022-2024.
- Analizimi i llogarive jo balancuese, llogarive të balancave si dhe llogarive PPB. Verifikimi i përputhjes me rregulloret, standardet e mirëmbajtjes dhe kërkesat e qasjes.

Për të vlerësuar nëse janë përmbushur në kohë dhe në mënyrë të duhur kushtet përcaktuara në MBE që KOSTT ka nënshkruar me gjeneratorët e BRE ne kemi analizuar tetë mostra, apo 26% të gjeneratorëve që janë në operim komercial të cilët kanë në total kapacitet të instaluar 99.93MËËh.

⁸² Kjo nuk vlen për gjeneratorët që kanë qenë pjesë e Skemës deri në vitin 2020, ata vazhdojnë të jenë me tarifa nxitëse

Këto mostra përbëjnë 44% të total kapacitet të instaluar, nga të cilët shtatë i përkasin skemës mbështetëse dhe një gjeneratorë është në kuadër të kornizës së rregulluar. Mostrat përfaqësojnë kombinim të llojeve të ndryshme të burimeve të energjisë si: tri mostra janë hidrocentrale, dy mostra janë gjeneratorë me Erë, dhe tri mostra janë gjeneratorë me Solare.

- Për të vlerësuar fazën testuese të gjeneratorëve BRE para lëshimit të tyre në operim komercial si dhe për të vlerësuar nëse janë bërë pagesat e energjisë testuese si duhet ne e kemi analizuar për pesë gjeneratorë nga tetë mostrat e auditimit. Kjo pasi që gjeneratorët tjerë ishin lëshuar në operim komercial para vitit 2017 dhe procedurat për lëshim në operim komercial për ta ishin kryer nga KEDS.
- Për të vlerësuar formën procesin se si KOSTT ka menaxhuar pagesat në lidhje me Fondin BRE, kemi analizuar regjistrimin e gjitha të hyrave dhe shpenzimeve për Fondin BRE nga OT, listën e pagesave të kryera nga departamenti i financave si dhe afatet kohore në të cilat janë realizuar pagesat e të hyrave dhe shpenzimeve për periudhën 2022 deri 2024. Gjithashtu, kemi analizuar dhe borbhet eventuale të furnizueseve dhe gjeneratorëve për Fondin BRE.

Përshkrimi i sistemit

Sistemi për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (BRE) në Kosovë është një mekanizëm i integruar për prodhimin, transmetimin dhe shpërndarjen e energjisë së pastër, i mbështetur nga Ministria e Ekonomisë, Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRRE) dhe Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT). Përmes aktiviteteve të ndryshme sistemi synon promovimin e energjisë së pastër, përmbushjen e objektivave kombëtare dhe krijimin e një mjedisi të qëndrueshëm dhe të besueshëm për të gjitha palët me interes.

Ministria e Ekonomisë (ME) – bën hartimin e politikave zhvillimore për BRE, harton planet e veprimit për BRE, mbikëqyr zbatimin e politikave dhe bënë përcaktimin e caceve sikurse është caku obligativ prej 25% të prodhimit të energjisë deri në vitin 2020 dhe ai prej 32% e bruto konsumit të energjisë deri në vitin 2030.⁸³

Zyra e Rregullatorit të Energjisë (ZRRE) – kryesisht zbaton kornizën ligjore rregullative duke përcaktuar feed-in tarifat⁸⁴. Aprovon tarifat vjetore të energjisë, aprovon çmimin referent për BRE⁸⁵, aprovon të hyrat e lejuara maksimale për KOSTT përfshirë edhe të hyrat e lejuara për Fondin e BRE si dhe monitoron Fondin e BRE. Njëkohësisht bën lëshimin e certifikatës së origjinës dhe asaj të përdorimit të gjeneratorit.

Përgatitë metodologjinë tarifore dhe harton procedura të autorizimit për ndërtimin e kapaciteteve të reja prodhuese të energjisë.⁸⁶ Bën lëshimin, modifikimin, pezullimin apo tërheqjen e licencave/autorizimit të gjeneratorëve të BRE-ve.⁸⁷

⁸³ Udhëzimi administrative (MZHE) Nr.05/2017 Caket e Energjisë nga Burimet e Ripërtërishme.

⁸⁴ Vendimi V810_2016 për caktimin e tarfiave nga BORDI ZRRE.

⁸⁵ Çmimi referent i BRE caktohet çdo vit nga ZRRE, ky çmim është më i ulët se sa çmimi i tarifave nxitëse në marrëveshjet e KOSTT me gjeneratorët e BRE. Çmimi referent i BRE⁵²UROHET në faturat e energjisë elektrike të konsumatorëve fundorë ndërsa diferenca mes çmimit referent dhe tarifës nxitëse paguhet nga Fondi i BRE ndërsa kjo pagesë faturuhet si taksë tek Furnizuesit të cilët këtë taksë e inkasojnë nga konsumatorët fundorë.

⁸⁶ Po aty, neni 15.

⁸⁷ Ligji Nr. 05/L-084 për Rregullatorin e Energjisë, 8, 16 dhe 23.


Operatori i Sistemit të Transmetimit dhe Tregut (KOSTT) - është përgjegjës dhe garanton lidhjen në rrjet për prodhuesit e rinj të energjisë elektrike nga BRE-të. OT harton marrëveshjet për blerje të energjisë elektrike të prodhuar nga BRE-të⁸⁸ dhe administron ato, gjithashtu menaxhon Fondin për BRE me gjitha llogaritë që ka ky Fond. OT bën grumbullimin e pagesave për mbështetjen e prodhimit të energjisë elektrike nga energjia e burimeve të ripërtërishme dhe bashkëprodhimi, nga të gjithë furnizuesit, duke përfshirë edhe furnizuesit me obligim të shërbimit publik;⁸⁹

KOSTT njëkohësisht është edhe përgjegjëse për menaxhimin e llogarive të jo balancave duke siguruar që jo balancat të mbulohen nga BRE-të dhe nga KOSTT.

Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) përmes garancisë bankare të mbledhur nga BRE-të siguron mbledhjeje e mjeteve si parakusht nga Gjeneratori i BRE-ve. KOSTT në baza vjetore i raporton dhe mbikëqyret rregullisht nga ZRRE. Për çështje të performancës vjetore i raporton Kuvendit.

Për të ilustruar formën se si është i organizuar sistemi i prodhimit dhe shpërndarjes së energjisë së prodhuar nga BRE si dhe akterëve që janë të përfshirë në këtë proces kemi paraqitur figurën si më poshtë.

Figura 2. Organizimi dhe shpërndarja e energjisë së prodhuar nga BRE



Hapat e procesit të Skemës Mbështetëse dhe Fondit për BRE

Lidhur me masat e marra për arritjen e caceve, ZRRE në vitin 2017 ka hartuar Skemën Mbështetëse për Burimet e Ripërtërishme të Energjisë (Skema për BRE). Skema ka qëllim nxitjen e investimeve për të stimuluar prodhimin e energjisë nga BRE. Skema garanton prioritet në blerjen e energjisë nga prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme (gjeneratorët e BRE) me çmime nxitëse. Në kuadër të skemës janë dy lloje të marrëveshjeve për sa i përket energjisë së gjeneruar nga BRE:

⁸⁸ Rregulla për Skemën Mbështetëse, neni 17

⁸⁹ Rregulla për Skemën Mbështetëse, neni 4, 5 dhe 6.

- Marrëveshja për blerje të energjisë nga burimet e ripërtërishme (MBE), e cila funksionon në bazë të tarifave nxitëse (feed-in tarifa dhe Premium feed-in) të energjisë nga BRE. Kjo garanton blerjen e energjisë me çmime nxitëse të cilat janë të përcaktuara në marrëveshjet gjeneratorët e BRE. Marrëveshja lidhet mes Prodhuesit për BRE dhe KOSTT/OT.
- Marrëveshja me Kornizë të Rregulluar e cila nuk i ka të përcaktuara çmimet në kontratë por iu garanton gjeneratorëve të BRE blerjen e energjisë me çmime tregu.

Sipas të dhënave nga KOSTT në kuadër të Skemës janë nënshkruar 32 MBE dhe 5 marrëveshje me kornizë të rregulluar.


Fondi për burimet e ripërtërishme të energjisë (Fondi për BRE) është themeluar me qëllim që të mbulojë kostot e prodhimit për energjinë nga BRE për gjeneratorët që janë pjesë e Skemës. Fondi për BRE është themeluar dhe menaxhohet nga Operatori i Tregut.

Ky Fond shfrytëzohet për të financuar:

- Dallimin ndërmjet çmimit referent dhe tarifës nxitëse (çmimi referent për BRE, llogaritet sipas metodologjisë tarifore për llogaritjen e çmimit referent. Ky është njëkohësisht edhe çmimi i tregut për energjinë BRE ndërsa tarifa nxitëse është çmimi që janë zotuar KOSTT të paguajnë për gjeneratorët e BRE sipas marrëveshjes. Çmimi referent është shumë më i ulët se sa çmimi i tarifës nxitëse, prandaj KOSTT paguan diferencën);
- Kompensimin për kostot e imbalancit për të reflektuar përgjegjësinë për 25% të kostove totale të imbalancit për Gjeneratorët e BRE-ve të pranuar në Skemën Mbështetëse;⁹⁰

Kostot e shkaktuara nga OT për menaxhimin dhe operimin e fondit si dhe çdo kosto tjetër e nevojshme për implementimin e kësaj Rregulle, nëse ashtu vendoset nga Rregullatori.⁹¹ Me anë të figurës në vijim janë paraqitur llojet e të hyrave dhe shpenzimeve në kuadër të Fondit të BRE.

Figura 3. Të hyrat dhe shpenzimet nga Fondi për BRE



⁹⁰ Ligji NR.05/L-085 për Energjinë Elektrike, neni 16 dhe 17 dhe neni 14 dhe 18.

⁹¹ Rregulla për Skemën Mbështetëse,

Shtojca II Prodhuesit që janë në operim komercial

I. Burimi energjisë		Hidrocentrale		
Prodhuesi	Kapaciteti i instaluar	Njësia	Pranimi në Skemë	Data e Operimit Komercial
Prodhuesi 1	8.06	MWh	7/16/2015	4/1/2016
Prodhuesi 2	9.80	MWh	7/16/2015	4/1/2016
Prodhuesi 3	4.80	MWh	2/20/2015	12/18/2015
Prodhuesi 4	2.28	MWh	2/20/2015	12/1/2016
Prodhuesi 5	4.27	MWh	2/20/2015	4/12/2016
Prodhuesi 6	2.10	MWh	2/20/2015	4/19/2017
Prodhuesi 7	4.70	MWh	1/28/2016	5/8/2019
Prodhuesi 8	4.00	MWh	2/23/2016	6/4/2019
Prodhuesi 9	10.00	MWh	2/20/2015	6/19/2019
Prodhuesi 10	6.20	MWh	7/16/2015	1/1/2020
Prodhuesi 11	0.31	MWh	3/31/2015	2/3/2020
Prodhuesi 12	3.35	MWh	2/20/2015	2/6/2020
Prodhuesi 13	1.00	MWh	2/20/2015	2/25/2020
Prodhuesi 14	2.48	MWh	1/28/2016	2/22/2021
Prodhuesi 15	2.35	MWh	1/28/2016	2/22/2021
Prodhuesi 16	1.12	MWh	2/20/2015	3/4/2021
Prodhuesi 17	4.60	MWh	2/20/2015	4/28/2021
Prodhuesi 18	3.40	MWh	2/23/2016	6/8/2021
Prodhuesi 19	4.90	MWh	2/20/2015	10/26/2021
Total kapaciteti	79.71	MWh		

II. Burimi energjisë		Diell (Solare)		
Prodhuesi	Kapaciteti i instaluar	Njësia	Pranimi në Skemë	Data e Operimit Komercial
Prodhuesi 20	0.10	MWh	4/10/2015	7/30/2015
Prodhuesi 21	0.50	MWh	2/20/2015	7/1/2016
Prodhuesi 22	3.00	MWh	2/20/2015	6/11/2018
Prodhuesi 23	3.00	MWh	2/20/2015	11/6/2018
Prodhuesi 24	0.40	MWh	7/16/2015	3/27/2019
Prodhuesi 25	3.00	MWh	2/20/2015	9/18/2019
Total kapaciteti	10.00	MWh		

MWh

III. Burimi energjisë		Ere		
Prodhuesi	Kapaciteti i instaluar	Njësia	Pranimi në Skemë	Data e Operimit Komercial
Prodhuesi 26	32.40	MWh	2/20/2015	10/11/2018
Prodhuesi 27	34.47	MWh	11/25/2015	10/20/2021
Prodhuesi 28	34.47	MWh	11/25/2016	12/14/2021
Prodhuesi 29	34.47	MWh	11/25/2016	2/26/2022
Total kapaciteti	135.81	MWh		

Kornizë rregulluar		Solare (Diell)		
Prodhuesi	Kapaciteti i instaluar	Njësia	Pranimi Kornizë	Data e Operimit Komercial
Prodhuesi 30	3	MWh	12/29//2022	07/18//2023
Prodhuesi 31	1	MWh	8/18/2023	2024

Totali në Operim (I+II+III+IV)	MWh	229.53
---------------------------------------	-----	---------------

Shtojca III Prodhuesit që janë mostër e auditimit

Gjeneratori	Lloji i BRE	Në cilin operator është kyçur	Kapaciteti i Instaluar (MWh)	Pranimi në Skemë	Data e nënshkrimit të MBE	Marrëveshja për kyçje në rrjet/Pëlqimi Elektroenergjetik (KEDS)	Deklarata e disponueshmërisë (njoftimi i gjeneratorit se është gati për testim)	Data e Fillimit të testimeve të komisionimit	Deklarata për përfundim të Suksesshëm të testimeve	Raport Teknik	Çertifikatës për përfundim të suksesshëm të komisionimit	Ditët e energjisë Testuese	Data efektive për operim Komercial (Konfirmimi i ZRRE)	Lëshimi në operim komercial
Gjeneratori 1	HC	KEDS	9.998	2015	13.12.2017	18.01.2019	28.05.2021	nuk ka	18.06.2019	17.05.2019	N/A	0	18.06.2019	19.06.2019
Gjeneratori 2	ERA	KOSTT	34.47	2016	17.12.2019	10.10.2021	21.10.2021	22.10.2021	12.11.2021	N/A	17.11.2021	26	13.12.2021	14.12.2021
Gjeneratori 3	ERA	KOSTT	32.4	2015	26.07.2018	13.01.2011	01.08.2018	8/23/2018	05.10.2018	N/A	10.10.2018	48	10.10.2018	11.10.2018
Gjeneratori 4	FV	KEDS	3	2015	25.09.2018	10.02.2016	17.10.2018	18.10.2018	05.11.2018	10.10.2018	Nuk ka	18	05.11.2018	06.11.2018
Gjeneratori 5	FV	KEDS	3	2015	01.11.2017	07.06.2019	10.09.2019	06.09.2019	17.09.2019	05.09.2019	Nuk ka	6	17.09.2019	18.09.2019
Gjeneratori 6	FV	KEDS	3	2022	13.03.2023	20.12.2022	26.06.2023	27.06.2023	17.07.2023	12.05.2023	Nuk ka	21	18.07.2023	18.07.2023
Gjeneratori 7	HC	KEDS	4.267	2015	para vitit 2017	03.06.2015	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	N/A	N/A	12.04.2016
Gjeneratori 8	HC	KOSTT	9.8	2015	para vitit 2017	2013	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	para vitit 2017	N/A	N/A	01.04.2016

Shtojca IV Parashikimet e prodhuesve në MWh

Muaj	Nominimet për Furnizuesit MWh	Rinominimet	Matjet për Gjeneratorë në MV	Jo balanca gjenerator	Gjenerator jo balanca në %
Janar 2022	40,608	37,296	39,148	1,852	-5%
Shkurt 2022	38,921	36,451	39,156	2,705	-7%
Mars 2022	37,937	35,815	43,018	7,203	-20%
Prill 2022	55,823	55,065	60,399	5,334	-10%
Maj 2022	44,162	42,319	43,778	1,459	-3%
Qershor 2022	35,789	35,256	36,024	768	-2%
Korrik 2022	27,626	27,551	32,163	4,612	-17%
Gusht 2022	19,278	20,669	25,006	4,336	-21%
Shtator 2022	33,848	34,567	40,411	5,844	-17%
Tetor 2022	28,151	28,386	29,634	1,248	-4%
Nëntor 2022	43,487	45,476	50,270	4,794	-11%
Dhjetor 2022	60,888	60,968	63,263	2,295	-4%
Janar 2023	47,277	50,294	47,844	2,450	5%
Shkurt 2023	45,296	49,085	49,610	525	-1%
Mars 2023	52,815	54,270	52,149	2,121	4%
Prill 2023	52,271	52,582	54,021	1,439	-3%
Maj 2023	62,578	62,799	62,493	306	0%
Qershor 2023	39,347	38,088	39,390	1,302	-3%
Korrik 2023	31,278	31,180	35,671	4,491	-14%
Gusht 2023	26,545	26,363	30,443	4,081	-15%
Shtator 2023	30,758	32,733	35,729	2,996	-9%
Tetor 2023	32,014	31,905	34,309	2,403	-8%
Nëntor 2023	61,533	66,198	68,034	1,836	-3%
Dhjetor 2023	56,562	56,511	60,632	4,121	-7%
Janar 2024	58,824	61,849	64,845	2,995	-5%
Shkurt 2024	50,640	52,557	54,565	2,008	-4%
Mars 2024	52,475	55,297	57,032	1,735	-3%
Prill 2024	54,147	54,771	57,206	2,435	-4%
Maj 2024	49,397	52,278	56,261	3,983	-8%
Qershor 2024	27,926	28,414	30,992	2,578	-9%
Korrik 2024	22,154	21,212	23,583	2,371	-11%
Gusht 2024	18,762	18,974	21,993	3,020	-16%
Shtator 2024	27,565	26,927	30,348	3,421	-13%
Tetor 2024	27,710	28,060	29,472	1,412	-5%
Nëntor 2024	25,169	26,265	27,856	1,591	-6%
Dhjetor 2024	41,690	43,718	47,282	3,563	-8%

Shtojca V “Jo-balancat 5% për vitin 2022”

Viti 2022					
Gjeneratorët	Pagesa vjetore e gjeneratorëve për jo balance	Total i pageses KOSTT për blerje të energjisë ndaj gjeneratorëve	% e të hyrave të gjeneratorit në raport me jo balancat e paguara	Shuma që duhet gjeneratorët të paguajnë sipas rregullës 5%	Shuma që KOSTT nuk ju ka paguar gjeneratorëve
	A	B	C	D	E
			C=A/B	D=B*5%	E=D-A
Gjeneratori 1	19,061.20	€ 408,449.97	5%		
Gjeneratori 2	17,937.59	€ 297,848.31	6%	14,892.42	3,045.17
Gjeneratori 3	6,646.35	€ 94,192.46	7%	4,709.62	1,936.73
Gjeneratori 4	15,005.42	€ 316,110.96	5%		
Gjeneratori 5	37,465.12	€ 781,930.82	5%		
Gjeneratori 6	1,084,965.52	€ 7,751,223.42	14%	387,561.17	
Gjeneratori 7	43,889.54	€ 581,449.94	8%	29,072.50	14,817.04
Gjeneratori 8	42,875.44	€ 581,871.60	7%	29,093.58	13,781.86
Gjeneratori 9	31,447.04	€ 717,183.60	4%		
Gjeneratori 10	35,020.60	€ 954,342.52	4%		
Gjeneratori 11	14,660.07	€ 373,864.10	4%		
Gjeneratori 12	31,907.55	€ 850,414.13	4%		
Gjeneratori 13	79,511.11	€ 2,041,532.36	4%		
Gjeneratori 14	45,312.55	€ 557,096.13	8%	27,854.81	17,457.74
Gjeneratori 15	-				
Gjeneratori 16	6,074.58	€ 92,366.00	7%	4,618.30	1,456.28
Gjeneratori 17	17,378.51	€ 299,324.52	6%	14,966.23	2,412.29
Gjeneratori 18	9,512.43	€ 173,994.60	5%		
Gjeneratori 19	20,286.23	€ 532,542.43	4%		
Gjeneratori 20	25,068.50	€ 435,822.16	6%	21,791.11	3,277.39
Gjeneratori 21	39,413.86	€ 726,348.07	5%		
Gjeneratori 22	9,770.81	€ 200,891.82	5%		
Gjeneratori 23	1,312,880.12	€ 7,706,242.31	17%	385,312.12	
Gjeneratori 24	1,380,468.37	€ 8,322,310.99	17%	416,115.55	
Gjeneratori 25	22,026.64	€ 562,811.41	4%		
Gjeneratori 26	1,268,129.92	€ 6,449,503.33	20%	322,475.17	
Gjeneratori 27	-				
Gjeneratori 28	5,616,715.09	€ 41,809,667.96		€ 1,658,462.56	€ 58,184.51
	Gjeneratorë që kanë nënshkruar 5%				
	Gjeneratorë që nuk kanë nënshkruar 5%				

Shtojca VI “Të hyra dhe Shpenzimet e Fondit për 2022-2024”

Lloji i të hyrave	2022	2023	2024
Shitja e Energjisë BRE	29,145,845 €	31,426,989 €	30,503,304 €
Tarifa BRE	4,606,434 €	12,650,666 €	16,461,692 €
Jo balanca e Gjeneratorëve BRE	5,616,715 €	2,658,296 €	2,299,957 €
Llogaria Balancuese	6,880,828 €	1,690,876 €	2,098,456 €
Korrigjimi i inflacionit dhe të hyrat nga 5%		105,148 €	128,384 €
Të hyrat totale në Fondin BRE	46,249,822 €	48,531,975 €	51,491,793 €
Të hyrat nga Furnizuesit në %	73%	91%	91%

Lloji i shpenzimeve	2022	2023	2024
Shpenzimet për Blerje	42,014,721 €	51,049,638 €	46,576,532 €
Shpenzimet nga Jobalancat 5%	2,810,655 €	1,651,658 €	152,132 €
Shpenzimet e jo balancave (MOF)		356,251 €	
Shpenzimet e jo balancave (KRR)		1,274 €	
Korrigjimi i inflacionit		563,606 €	
Total Shpenzime në Fondin BRE	44,825,376 €	53,622,427 €	46,728,664 €
Totali Teprica/Mungesa (të hyrat-shpenzimet)	1,424,446 €	(5,090,452) €	4,763,129 €

Shtojca VII Letër konfirmimit dhe komentet e entiteteve

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU KOSTT sh.a.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR KOSTT J.S.C.
OPERATOR SISTEMA PRENOŠA I TRŽIŠTA KOSTT d.d.

Nr. 2137 Dt. 27 08 2025
PRISHTINË-A

OPERATOR SISTEMI TRANSMISIONI DHE TREGU SH.A.
TRANSMISSION SYSTEM AND MARKET OPERATOR J.S.C.
OPERATOR SISTEMA PRENOŠA I TRŽIŠTA A.D.



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **“Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë”**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë, 27 gusht 2025

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **“Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë”** (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- nuk pajtohem me gjetjet, me përjashtim të gjetjes 3.1, paragrafi 3.1.1 respektivisht nën paragrafi ‘Mungesa e Garancive Financiare për Prodhuësit dhe Furnizuesit’ me të cilën pajtohem pjesërisht. Komentet janë të prezantuara në shtojcën e komenteve për përmbajtjen e Raportit; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Dr. Gëzim Tosuni
Kryesues i Bordit të Drejtorëve “KOSTT” sh.a.



Dokumenti: Komentet nga Operatori i Sistemit, Transmisionit, dhe Tregut Sh.A. në draft raportin e auditimit

Gjetjet	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar në raste të mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
KOSTT kishte mangësi gjatë fazës testuese të prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë	Jo	Gjetja se “KOSTT kishte mangësi gjatë fazës testuese të prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë” është e pabazuar dhe nuk qëndron. KOSTT ka administruar fazën testuese të prodhuesve të burimeve të ripërtërishme të energjisë në përputhje të plotë me Rregullën për Skemën Mbështetëse për gjeneratorët BRE NR.10-2017 të ZRrE-së, dhe Marrëveshjeve për Blerje të Energjisë me gjeneratorët BRE (MBE) të miratuar nga ZRrE. Ky fakt është i vërtetuar edhe nga Raporti i Auditimit i vitit 2021 i Zyrës Kombëtare të Auditimit “Marrëveshjet për Blerje të Energjisë së Prodhuar në mes Të NP KOSTT Sh.A. dhe kompanive që operojnë me Burime të Ripërtërishme, Lidhur Me Pagesat/Tarifat Nxitëse”, ku janë testuar të gjitha marrëveshjet dhe nuk është identifikuar asnjë gjetje dhe as rekomandim lidhur me këtë çështje. Faza e testimit dhe komisionimi i gjeneratorëve BRE është kryer në përputhje me kërkesat e përcaktuara në MBE dhe në asnjë rast dhe asnjë nga gjeneratorët BRE nuk janë lejuar të fillojnë operimin komercial pa ndjekur procedurat dhe pa realizuar (përfunduar) fazën testuese në përputhje me dispozitat e MBE-së. Prandaj, konkluzioni i paraqitur në këtë gjetje është i pasaktë dhe i pabazuar. Provat përkatëse që e mbështesin këtë koment i gjeni të bashkëngjitura sipas gjetjeve respektive si më poshtë.	Mangësitë që për të cilat flet titulli i gjetjes së auditimit janë të shpjeguara në raportin e auditimit për secilin nga prodhuesit që ishin mostër e auditimit.
3.1 KOSTT nuk ka arritur të menaxhojë në mënyrë Efikase Fondin	Jo	Nuk pajtohem me këtë konstatim. Më poshtë mund të gjeni komentet tona për secilën pikë të paraqitur në Raport.	Konstatimi se KOSTT nuk ka menaxhuar Fondin në mënyrë efikase lidhet me gjetjet e identifikuar dhe të paraqitura në raportin e auditimit.
3.1.1. Pagesa të pasakta gjatë fazës testuese të prodhuesve dhe mangësi në	Jo	Pagesat janë kryer duke u bazuar në dispozitat e Marrëveshjes për Blerje të Energjisë përkatësisht Shtojcës 5 të Marrëveshjes MBE që formalisht e përcakton përfundimin e fazës testuese si dhe nga matjet e dorëzuara në Operatorët e Sistemit (KOSTT ose KEDS). Faza Testuese për të gjithë Gjeneratorët BRE, pa asnjë përjashtim, të cilët kanë filluar operimin komercial pas transferimit të MBE-së në KOSTT është kryer në përputhje të plotë me kërkesat	Auditimi ka identifikuar se përgjatë fazës testuese për këtë prodhues nuk ishte regjistruar asnjë KW energji testuese në rrjet, pra në bazë të matjeve që kemi pranuar nga KOSTT rezulton zero KW energji

administrimin e marrëveshjeve	e përcaktuara në MBE, respektivisht nenet 10 dhe 11. Pra, për secilin gjenerator janë respektuar procedurat e parapara e dëshmuar përmes pranimit të dokumenteve si në vijim: - Regjistrimi i Sistemit Matës, - Programi për Testime, - Deklarata e Disponueshmërisë, - Rezultatet e Testeve të Komisionimit, - Deklarata për përfundim të suksesshëm të Komisionimit të Gjeneratorit dhe - Certifikata për përfundim të suksesshëm të Komisionimit të gjeneratorit të kyçur në rrjetin e transmetimit e lëshuar nga Operatori i Sistemit të Transmetimit /Raporti mbi Pranimin Teknik për gjeneratorët të kyçur në rrjetin e shpërndarjes i lëshuar nga Operatori i Sistemit të Shpërndarjes dhe - Shtojca 5 e MBE-së (që formalisht përcakton përfundimin e fazës testuese dhe fillimin e operimit komercial të gjeneratorit BRE) është nënshkruar pas konfirmimit nga ZRrE. Pra, procedurat sipas MBE-së janë ndjekur për secilin gjenerator BRE dhe asnjë prej tyre nuk ka filluar operimin komercial pa i ndjekur këto procedura dhe pa e përfunduar (pa e kaluar) fazën testuese ashtu siç kërkohet në MBE. Lidhur me këtë KOSTT i posedon dëshmitë të cilat i janë ofruar ekipit të auditimit sipas kërkesës së tyre dhe mund t'i ofrohen secilës palë relevante. Provat për Prodhuesin 1 Gjetja në raport që Prodhuesit 1 i është mundësuar fillimi i operimit komercial pa realizuar prodhim gjatë fazës testuese nuk është e bazuar dhe nuk qëndron. Faza testuese për këtë gjenerator ka zgjatur gjithsej 21 ditë dhe jo '0' siç gabimisht konstatohet në raport. Kjo është e dokumentuar me Deklaratën e Disponueshmërisë të datës 28.05.2019 (një ditë para fillimit të fazës testuese - siç kërkohet në MBE) dhe dhe Programin për Testime për kohëzgjatjen e fazës testuese nga datë 29.05.2019 deri 18.06.2019, Deklaratën për përfundim të suksesshëm të Komisionimit të gjeneratorit, datë 18.06.2019, Rezultatet e Testeve të Komisionimit të Gjeneratorit, dhe Shtojca 5 e MBE-së, datë 19.06.2019. Për më tepër Realizimi i testeve të komisionimit që dëshmon vlerat e rrymës, tensionit, fuqisë, frekuencës etj., dokumentohet me: Rezultatet e Testeve të Komisionimit të gjeneratorit të dorëzuara në kopje fizike dhe me CD ku kjo dëshmohet në detaje në: 2. General Checks, faqe 4 të Rezultateve e Testeve të Komisionimit të gjeneratorit	që ky gjenerator ka prodhuar gjatë fazës së testimit. KOSTT nuk ka ofruar matjet e prodhimit për këtë gjeneratorë si dëshmi për të vërtetuar se ka pasur matje të energjisë për këtë prodhues gjatë fazës testuese. Listën e testeve dhe dokumentacionit që KOSTT e ka listuar nuk lidhet me regjistrimin e matjeve të energjisë në rrjet për të cilën flitet në raportin e Auditimit. Rezultatet e testeve të Komisionimit të cilave KOSTT i referohet në këtë dokument si dëshmi për dhënien e energjisë në rrjet dhe kryerjes me sukses të testeve për këtë prodhues mbajnë datën 30.05.2019 që është vetëm dy ditë pasi që është dorëzuar Deklarata e disponueshmërisë (pra dy ditë pasi që kanë filluar formalisht testimet). Për më tepër, KOSTT në fund të këtij komenti thekson se Operatori i Tregut është bazuar në nga vlerat e OSSH ku nuk ka mundur të raportojë energji testuese dhe nuk ka mundur të pranojë faturë gjë që konstaton të njëjtën gjë me atë
-------------------------------------	--	--

	3. DC Power Supply (+BUB01, +BTM01), faqe 5 të Rezultatet e Testeve të Komisionimit të Gjeneratorit. 4. AC Power Supply (+BFA01), faqe 6 të Rezultatet e Testeve. 5. Control and Protection Panel (+0CJA01), faqe 7 të Rezultatet e Testeve. 6. MV Panels (=AHA04, =AHA05, =AHA06), faqe 9 të Rezultatet e Testeve. 7. Conclusion, faqe 10 të Rezultatet e Testeve. Rezultatet me vlerat e rrymës, tensionit, fuqisë, frekuencës etj., në faqe 3/6, deri në 6/6, gjithashtu dhe në faqe 2/4 deri 4/4, të Rezultatet e Testeve të Komisionimit. Ju lutem shihni provat (dokumentet) që dëshmojnë se Prodhuesit 1 ka kryer fazën testuese sipas kërkesave të MBE-së, të listuara në kuadër të: Prova 1: - Procesverbali i zyrtarizmit të Grupit Matës nga OSSH datë 22.05.2019. - Forma e Regjistrimit të Sistemit Matës nga OT datë 27.05.2019. - Programit për Testime datë, 21.05.2019, 30.05.2019, 07.06.2019, 17.06.2019 për kohëzgjatjen e fazës testuese nga datë 29.05.2019 deri 18.06.2019. - Deklaratës së Disponueshmërisë, datë 28.05.2019. - Rezultateve të Testeve të Komisionimit. - Deklaratës për përfundim të suksesshëm të Komisionimit të gjeneratorit, datë 18.06.2019. - Raporti mbi pranimin Teknik e lëshuar nga OSSH dhe - Shtojca 5 e MBE-së, datë 19.06.2019 Nga këto prova dëshmohet qartë se Prodhuesi 1 e ka kryer fazën testuese në përputhje me të gjitha kriteret e përcaktuara në MBE, dhe në praktikë është vepruar njëjtë sikurse ka ndodhur gjatë testimit të prodhuesve të tjerë dhe janë respektuar praktika të njëjta në krahasim me prodhuesit e tjerë për fazën e testimit ashtu si kërkohen në MBE. Të gjitha dëshmitë përkatëse ndodhen tek KOSTT (Operatori i Tregut), të cilat aq sa janë kërkuar u janë vënë në dispozicion Ekipit të Auditorëve. Sqarime shtesë mbi matjet: Sistemi matës i Operatorit të Sistemit të Shpërndarjes (OSSH) në pikën e kycjes është instaluar me datë 22.05.2025 (dokument nga Prodhuesi dhe e dokumentuar përmes procesverbalit nr. 0031706 dt. 22.05.2019 nga OSSH), dhe shpjegimet për kronologjinë e ngjarjeve për këtë sistem matës OSSH i ka dërguar përmes email-it, ku ndër të tjera sqaron se Njehsori elektrik 38551961 është instaluar, si njehsor kryesor me C=14000 sipas Procesverbalit nr. 0031705 dt.	që thuhet në Raportin e auditimit lidhur me këtë prodhues. Konstatimi i paraqitur në këtë dokument për Prodhuesin 2 nuk
--	--	--

	22.05.2019 duke shpjeguar për kyçjen dhe shkycjen e parë nën tension (Power Up) dhe (Power Down). Gjithashtu Regjistrimi i Sistemit Matës nga Operatori i Tregut (OT) me datë 27.05.2019 (FO-MO-006) dëshmon se para fillimit të fazës testuese të Prodhuesit 1 sistemi matës në pikën e kyçjes, është instaluar, është bërë pranimi teknik dhe është vënë në operim. Pra, fakti se pse OSSH ka dërguar vlera zero (0) për atë periudhë nuk vërteton që nuk ka pasur injektim të energjisë në rrjetin e distribucionit, pasi matja në pikën e kyçjes bëhet në mënyrë indirekte. Rezultatet e Testeve të Komisionimit për këtë Prodhues dëshmojnë për vlerat e rrymës, tensionit, fuqisë, frekuencës etj., (shih Rezultatet e Testeve të Komisionimit më lartë). Mirëpo, Operatori i Tregut është bazuar në vlerat nga OSSH, ku nuk ka mund të raportoj energji testuese, dhe nuk ka mund të pranojë vërtetimet ndonjë faturë nga Prodhuesi 1 për energjinë testuese, të prodhuar nga Prodhuesi. Rrjedhimisht Fondi BRE nuk është ngarkuar me kosto për pagesat e energjisë dhe as konsumatorët nuk janë afektuar financiarisht. Provat për Prodhuesin 2 Gjetja në raport për Prodhuesin 2 që <i>“në momentin e fillimit të energjisë testuese njëhori i Prodhuesit nuk ka qenë funksional sepse operatori i sistemit nuk ishte njoftuar se do të fillojë testimi. Prandaj nuk ka regjistruar matjet përgjatë 10 ditëve të para të testimit”</i> është e pasaktë dhe e pabazuar. Argumentimi: Sasia e energjisë elektrike e prodhuar nga Prodhuesi 2, gjatë fazës së testimit është matur saktë nga pika matëse 110 kV që është meritore për faturim në kufirin komercial sipas Marrëveshjes së Kyçjes. Gjatë fazës së testimit, Operatori i Tregut (OT) i ka paguar prodhuesit energjinë e saktë të matur nga Operatori i Sistemit të Transmetimit (OST) përmes pikës matëse zyrtare, e që është pika matëse e instaluar në pikën e kyçjes në anën 110 kV, në përputhje të plotë me kërkesat e përcaktuara në Marrëveshjen e Kyçjes dhe Kodin e Matjes.. Prova 2: Marrëveshja e Blerjes së Energjisë dhe Marrëveshja e Kyçjes e përcaktojnë saktë kufirin komercial të pikës matëse meritore për faturim). Prova 3: Evidenca mbi sasinë e energjisë sipas matjes në kufirin komercial si dhe dëshmitë mbi faturimin). Matjet e dorëzuara nga Operatori i Sistemit (<i>Historiku për matjet në prodhuesi.msg</i>, kalkulimi i matjeve në kufiri komercial (<i>Matjet prodhuesi 1 2 3.xlsx</i>) dhe <i>Vërtetim për disbursim të mjeteve – prodhuesi 2 Faza Testuese.pdf</i>). Prova 4: Procesverbali për regjistrimin e grupit matës nga OS datë 22.10.2021, Forma e regjistrimit të sistemit matës nga OT datë 22.10.2021, Programi i Testeve të Komisionimit të	qëndron sepse, pasi kemi pranuar dëshmitë shtesë më datë 15 gusht 2025 nga KOSTT është korrigjuar gjetja në raport lidhur me këtë prodhues, sipas dëshmisë së re të prezantuar nga KOSTT. Kështu është e reflektuar gjendja edhe në raportin e auditimit. Pra pas dëshmisë së prezantuar Raporti i auditimit nuk e konteston saktësinë e matjes për këtë gjenerator vetëm e shpjegon shkurt metodologjinë e matjeve që KOSTT e ka përdorur. Gjithë ajo që konstaton raporti i auditimit për prodhuesin 2 është se njëhori nuk ka qenë funksional për 10 ditët e para të testimit dhe asgjë më shumë.
--	--	---

	gjeneratorit datë 13.10.2021, Deklarata e disponueshmërisë datë 21.10.2021, Deklarata për kryerjen me sukses të komisionimit të gjeneratorit datë 12.11.2021, Certifikata për përfundim të Suksesshëm të Komisionimit të Gjeneratorit e lëshuar nga OST-ja datë 17.11.2021, Shtojca 5 e MBE-së e nënshkruar dhe korrespondencat e e-mailave në mes të Prodhuesit 2, OST dhe OT lidhur me fazën testuese, me datë 13.10.2021 njoftimi për programin e testeve të komisionimit të gjeneratorit dhe me datë 21.10.2021 njoftimi për Deklaratën e Disponueshmërisë, ku njoftohet OS dhe Matjet e OS (Drejtori i OS, 2 menaxherët e OS dhe Matjet e OS) për fillimin e fazës testuese të Prodhuesit 2. Këto dëshmojnë se OS dhe Matjet e OS (Drejtori i OS, 2 menaxherët e OS dhe Matjet e OS) janë njoftuar me kohë për fillimin e fazës testuese të Prodhuesit 2 dhe se komunikimi ndërmjet OT, OS përfshirë Matjet e OS dhe Prodhuesit 2 kanë qenë në nivelin e duhur lidhur me fillimin e fazës testuese të këtij prodhuesi. Çdo matje (sistem matës) tjetër e njësive gjeneruese brenda rrjetit të aseteve të prodhuesit ka vetëm rol kontrollues dhe krahasues. Përveç kësaj, këto sisteme matëse brenda rrjetit të aseteve të prodhuesit kanë rol edhe në ndarjen/pjesëmarrjen në % të sasisë së energjisë elektrike të prodhuar sipas licencave për gjeneratorët: Prodhuesin 2 dhe Prodhuesin respektiv nga totali i sasisë së energjisë elektrike të matur përmes pikës matëse zyrtare 110 kV. Instalimi apo edhe mirëmbajtja e sistemeve tjera matëse brenda rrjetit të aseteve që i përkasin Prodhuesit nuk janë përgjegjësi e KOSTT. Në bazë të Kodit të Matjes, Operatori i Sistemit është përgjegjës vetëm për sistemin matës 110 kV që është i instaluar në pikën e kyçjes në mes Prodhuesit dhe rrjetit të KOSTT. Në bazë të regjistrimit të energjisë që realizohet nga ky sistem matës, leximet e tij, Operatori i Sistemit në baza orare çdo ditë ia përcjell Operatorit të Tregut, bazuar në të cilat më pas në fund të muajit bëhet edhe faturimi dhe pagesa e sasisë së energjisë e prodhuar nga Prodhuesi nga Fondi i BRE-ve. Çdo pagesë tjetër e sasisë së energjisë elektrike e prodhuar nga Prodhuesi e bazuar vetëm në leximet e matjeve nga sistemet matëse brenda aseteve të Prodhuesit nuk do të ishte në harmoni me Marrëveshjen e Kyçjes. Prandaj, konstatimi si në raport nuk qëndron, pasi që matja dhe pagesat janë kryer sipas procedurave të parapara në kornizën kontraktuale dhe rregullative. Provat për prodhuesin 3 Gjetja në raport për Prodhuesin 3 <i>“Testimi kishte zgjatur më shumë se 30 ditë, ndërsa për pagesë ishte zgjedhur periudha e ditëve të fundit të testimit duke i kushtuar kështu më shumë KOSTT-it pagesa të energjisë testuese”</i> është e pa saktë dhe e pa bazuar.	Arsyetimi nga KOST i për Prodhuesin 3 nuk i përgjigjet gjetjes që trajtohet në raportin e auditimit. Kjo sepse marrëveshja për blerje (MBE), analizuar edhe gjatë procesit të auditimit, nuk specifikon nëse
--	---	--

	Periodha e pagesës së për energjinë testuese për Prodhuesin 3 nuk është zgjedhur por është realizuar në përputhje me dispozitën 4.2 të MBE-së dhe Shtojcën 5, të konfirmuar nga ZRrE, ku specifikohet: Prova 5: MBE për Prodhuesin 3 dhe Neni 4 Paragrafi 4.2 i MBE-së në Shtojcën 5 të konfirmuar nga ZRrE: Palët janë pajtuar se Neto Energjia Elektrike e liferuar para Datës së Operimeve Komerciale sipas Nenit 4 paragrafi 4.2 të kësaj Marrëveshje do të trajtohet si energji testuese dhe çmimi për energjinë testuese do të jetë i barabartë me 60% të çmimit të energjisë sipas Tarifës Nxitesë dhe Energjia Testuese do të paguhet në vlerë maksimale prej (30) ditësh. Pra, pagesa e energjisë testuese për Prodhuesin 3 por edhe për të gjithë Prodhuesit e tjerë në Skemën Mbështetëse është bërë në përputhje me Marrëveshjen për Blerje të Energjisë, përkatësisht Shtojcën 5 të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, e cila është konfirmuar nga ZRRE para nënshkrimit, dhe e cila e përcakton ditën e operimit komercial, përfundimin e fazës testuese dhe kohëzgjatjen e ditëve për të cilën bëhet pagesa e energjisë testuese. Shtojca 5 për Kufizimet teknike, Programin dhe Komisionimin përcakton ditën e operimit komercial (që është 11.10.2018), duke implikuar kështu përfundimin e fazës testuese një ditë para ditës së operimit komercial (që është 10.10.2018). Operatori i Sistemit (KOSTT - si e vetmja kompani e licencuar për instalimin dhe leximin e matjeve të njehsorëve në rrjetin e Transmisionit), për periudhën testuese të Prodhuesit 3 ka dorëzuar matje në kufirin komercial, rrjedhimisht Operatori i Tregut ka bërë kalkulimin bazuar në energjinë e dorëzuar nga Operatori i sistemit duke kalkuluar përpjesshëm energjinë për secilin Prodhues veç e veç, përfshirë Prodhuesin 3. Provat për Prodhuesin 4 Gjetja në raport për Prodhuesin 4 “Energjia Testuese ka filluar më 18.10.2018 ndërsa ka përfunduar më 05.11.2018. Kurse pagesa ishte bërë nga data 11.10.2018, pra KOSTT ka paguar 7 ditë më shumë”. Argumentimi Ky prodhues është i kyçur në rrjetin e OSSH. Pagesa e energjinë testuese për Prodhuesin 4 është bërë për më pak se 30 ditë dhe në përputhje me dispozitën 4.3 të Marrëveshjen për Blerje të Energjisë ku specifikohet “Energjia Testuese do të paguhet në vlerë maksimale prej (30) Ditësh” dhe Shtojcën 5 të Marrëveshjes për Blerje të Energjisë, e cila përcakton ditën e	pagesa bëhet në ditën e parë të fillimit të testimeve (ditën pas deklaratës së disponueshmërisë) apo në 30 ditëshin e fundit të testimeve. Sikurse shihet në nenin marrëveshjes te shkëputur nga KOSTT theksohet se paguhet vetëm energjia neto e liferuar para datës së operimeve komerciale në maksimum prej 30 ditësh, por në marrëveshje dhe as në këtë nen nuk shkruan se merren për pagesë 30 ditët e fundit të testimeve. Shpjegimi i KOSTT për Prodhuesin 4, nuk lidhet me atë që konstaton raporti i Auditimit. Raporti nuk konstaton se është tejkaluar pagesa në afat prej 30 ditësh, por konstaton se KOSTT e ka pranuar si pjesë të energjisë testuese edhe atë sasi të energjisë që është dhënë në rrjet para se prodhuesi të lëshojë deklaratën e
--	---	---

		operimit komercial (që është 06.11.2018), duke implikuar kështu përfundimin e fazës testuese një ditë para ditës së operimit komercial (që është 05.11.2018). Prova 6: MBE për Prodhuesin 4 dhe Neni 4.3 i MBE-së i konfirmuar nga ZRrE: 4.3 Energjia Testuese do të paguhet në vlerë maksimale prej (30) Ditësh. Rrjedhimisht, kjo fakton se për të gjithë prodhuesit është ndjekur parimi i njëjtë, në përputhje të plotë me dispozitat përkatëse në MBE. Përfundimisht kriteret për fazën testuese në të gjitha rastet janë zbatuar në përputhje të plotë me dispozitat e MBE-së dhe njëjtë për të gjithë Gjeneratorët BRE, pa përjashtim. Energjia për fazën testuese është paguar në përputhje me dispozitat e MBE-së, nuk është kaluar periudha maksimale prej 30 ditëve dhe nuk ka çuar në humbje të Fondit BRE.	disponueshmërisë, gjë e cila nuk është në përputhje me nenin 11.2 të MBE. Gjetja në raportin e auditimit thekson se: prodhuesi në fjalë kishte prodhuar 60 MWh gjashtë ditë para se të dorëzojë deklaratën e disponueshmërisë në KOSTT. Pra, prodhimi prej 60 MWh nuk i takon energjisë testuese sepse ishte bërë para se të fillonte formalisht testimi, përkatësisht para se të njoftojë KOSTT-in se është gati të fillojë testimin, ndërsa KOSTT-i e kishte pranuar si shpenzim. Pra neni 11.2 i MBE thekson si në vijim: <i>"Pas lëshimi të Deklaratës së Disponueshmërisë,</i> <i>por në çdo rast jo më vonë se Ditën në vijim, Prodhuesi duhet të kërkojë nga Operatori i Sistemit të jap energji dhe të mbaj me energji Stabilimentet Kyçëse për Pranim të Neto Energjisë Elektrike të Liferuar"</i>
-Mungesa e Garancive financiare për prodhuesit dhe furnizuesit	Pjesërisht	Me ndryshimin dhe miratimin e procedurës për garancion financiarin në muajin Gusht të vitit 2024, menjëherë nga muaji shtator i vitit 2024 Operatori i Tregut ka filluar me zbatimin e Procedurës për Garancion financiar për Prodhuesit dhe Furnizuesit në Kosovë, duke kalkuluar vlerat dhe duke dorëzuar modelet siç janë llogaritur vlerat e garancionit financiar. Për Palët që nuk kanë dorëzuar fare ose kanë dorëzuar garancion financiar jo-adekuat, Operatori i Tregut, ashtu siç parashihet në Rregullat e Tregut, i ka referuar në Zyrën për Rregullatorin e Energjisë. (Procedura paraprake e garancionit financiar në kuptim të kushteve të parapara, ka rezultuar e pa zbatueshme në praktikë. Gjatë periudhës së krizës energjetike, u paraqit nevoja e domosdoshme për ndryshim plotësim të saj, siç është specifikuar më sipër).	

-KOSTT nuk ka garanci financiare as nga Prodhuesit për Burime të Ripërtërishme të energjisë	Jo	Operatori i Tregut bazuar në Rregullat e Tregut ka vlerësuar dhe vlerëson që zbatimi i garancionit financiar për Prodhuesit BRE, e rritë koston shtesë administrative dhe si rrjedhojë është i panevojshëm në situatën dhe trendin aktual të çmimeve. Paragrafi 8.2.1.b, i Rregullave të Tregut i jep të drejtë Operatorit të Tregut që të bëjë vlerësimin e vetë të arsyeshëm për nevojën e sigurimit të garancionit financiar nga Prodhuesit BRE. Zbatimi i garancionit financiar për Prodhuesit BRE nuk e ekspozon në mënyrë materiale KOSTT-in ndaj rrezikut për mos-pagesë për shkak se trendi aktual i çmimeve rezulton që borxhi ndaj Prodhuesve gjithmonë është më i madh se borxhi i Prodhuesve ndaj Operatorit të Tregut.	Shpjegimi që KOSTT ka paraqitur lidhur me garancinë financiare për prodhuesit veçse është i reflektuar në raportin e auditimit përkatësisht në Gjetjen me titull "KOSTT nuk ka Garanci Financiare as nga Prodhuesit për Burime Të ripërtërishme të Energjisë". Megjithatë, bazuar në legjislacionin aktual në fuqi KOSTT-it i kërkohet të sigurojë garanci edhe nga Prodhuesit (gjeneratorët).
-Prodhuesit e energjisë së ripërtërishme nuk ishin pajisur me certifikatat e komisionit	Jo	Lëshimi i Certifikatës së Komisionimit ose Raporti Teknik është në diskrecion të Operatorit të Sistemit relevant. Sidoqoftë, konfirmojmë se Operatori i Sistemit të Transmetimit (KOSTT), në çdo rast, lëshon Certifikatë të Komisionimit. Ndërsa, Operatori i Sistemit të Shpërndarjes (KEDS) lëshon vetëm Raport Teknik. Të dy dokumentet respektive, për nga qëllimi janë të njëjta kurse për nga përmbajtja janë të ngjashme.	Raporti teknik nga KEDS lëshohet disa ditë para se gjeneratori të fillojë testimet dhe para se të lëshojë deklaratën e disponueshmërisë, që nënkupton se raporti teknik nuk është dokument valid për të konstatuar se është bërë certifikimi i komisionimit, sepse lëshohet në një pikë kur testi nuk ka filluar ende.
3.1.2. KOSTT nuk kishte organizuar në mënyrë efikase procesin e shitblerjes së energjisë së ripërtërishme	Jo	Nuk pajtohem me këtë konstatim. Më poshtë mund të gjeni komentet tona për secilën pikë të paraqitur në Raport.	
KOSTT-i nuk kishte menaxhuar jo balancat në mënyrë efikase	Jo	KOSTT ka menaxhuar jobalancet sipas Kodit të Rrjetit dhe Rregullave të Tregut. Prodhuesit BRE bazuar në legjislacionin në fuqi paguhen për të gjithë energjinë e matur të tyre (kjo si formë nxitëse për prodhimin nga BRE) dhe ato janë përgjegjës për 25 % të jobalanceve të tyre që janë një incentive që të parashikojnë sa më saktë si për mungesa ashtu edhe taprica.	Gjitha të dhënat kemi të reflektuara në raportin e auditimit në gjetjen 3.1.2 . Duke përfshirë të hyrat nga jo balancat e mekanizmit balancues dhe nga prodhuesit, shpenzimet e KOSTT për jo balancat për 5% për prodhuesit BRE, shpenzimet shtesë për blerjen e

		Jobalancet e Prodhuesve BRE historikisht e kanë ndihmuar Sistemin Elektronergjetik të Kosovës duke i zvogëluar Shkëmbimet e Paqëllimshme të Zonë Rregulluese të Kosovës ndaj Zonës së Evropës Kontinentale e rrjedhimisht ekspozimin ndaj vërejtjeve dhe dënimeve nga ENTSOE. Më poshtë shihet se si Shkëmbimet e Paqëllimshme të Kosovës për vitet 2022, 2023 e 2024 ishin në mungesë prej -231 GWh ndërsa tepricat e BRE për këto vite ishin në tepricë prej 142 GWh. <table><tr><td>Vitet</td><td>Shkëmbimet e Paqëllimshme të Kosovës (mungesat e Kosovës) [GWh]</td><td>Tepricat e BRE-ve [GWh]</td></tr><tr><td>2022 deri 2024</td><td>-231</td><td></td></tr></table> Jobalancat e larta të Prodhuesve kanë shkaktuar të hyra në Fondin BRE. Këto të hyra janë trajtuar në shqyrtimin tarifar dhe janë përcjell te shqyrtimi i ardhshëm tarifar duke iu kthyer përmes tarifave konsumatorëve Për vitet 2022, 2023 dhe 2024 benefiti nga jobalancet e BRE-ve ishte gjithsej 21.2 milionë EUR, Prova 7: Faturat për të Hyrat nga pagesat e jobalanceve nga Gjeneratorët BRE (<i>Faturat nga jobalancet e BRE 2022_2024.rar</i>), Prova 8: Faturat mujore për Jobalancet e Fondit BRE nga Llogaria Balancuese e OST-së (<i>MOF_2022-2024.rar</i>)	Vitet	Shkëmbimet e Paqëllimshme të Kosovës (mungesat e Kosovës) [GWh]	Tepricat e BRE-ve [GWh]	2022 deri 2024	-231		energjisë së jo balancës së prodhuesëve, të hyrat nga shitja , shpenzimet e blerjes, pra gjitha pozicionet e Fondit i kemi të reflektuara në raport. Gjetja në raportin e auditimit trajton jo balancat e larta të energjisë nga prodhuesit.
Vitet	Shkëmbimet e Paqëllimshme të Kosovës (mungesat e Kosovës) [GWh]	Tepricat e BRE-ve [GWh]							
2022 deri 2024	-231								
Rregulla për sasisitë e lejuara të blerjes dhe shitjes	Jo	Blerja e sasisë së energjisë elektrike nga BRE dhe shitja e sasisë së energjisë se BRE-ve tek furnizuesit janë procese të ndara. KOSTT ka realizuar këto procese në përputhje me marrëveshjet përkatëse për blerje dhe shitje të energjisë, rregullat e tregut si dhe skemën mbështetëse të miratuar nga ZRrE. Procedura është ndjekur konform dispozitave përkatëse, ku KOSTT blenë të gjithë sasinë e energjisë së prodhuar nga prodhuesit, siç parashihet në Marrëveshjet për Blerje. Ndërkohë, në përputhje me obligimet e përcaktuara në marrëveshjet e shitjes, KOSTT shet vetëm sasinë e energjisë së nominuar të BRE-ve tek furnizuesit, pasi që në rastin e furnizuesve shitblerjet e energjisë bëhen me tregtime komerciale (nominuara) e jo me tregtime të matura (prodhuara). Ky model pasqyron ndarjen e qartë të përgjegjësisive në përputhje të plotë me skemën mbështetëse të miratuar nga ZRrE.	Të njëjtën gjë të përshkruar në këtë pjesë nga KOSTT e paraqet edhe gjetja në raportin e auditimit. Për më tepër në raport janë edhe të dhënat e sasisë së bërë dhe asaj						

		Prova 9: Çmimi i tarifës nxitëse (nga MBE) Çmimi referent (nga MBE)	
Blerja me çmim nxitës, shitja me çmim referent	Jo	Çmimet e zbatuara në procesin e blerjes dhe shitjes së energjisë janë përcaktuar nga rregullatori (ZRRë) dhe janë në përputhje të plotë me Rregullën për Skemën Mbështetëse. Më konkretisht, çmimi i blerjes nga BRE-të është çmimi nxitës (feed-in tariff), i përcaktuar sipas skemës mbështetëse në fuqi, ndërsa çmimi i shitjes është çmimi referent i përcaktuar nga ZRRë në baza vjetore për shitjen e energjisë tek furnizuesit. <i>KOSTT nuk ka diskrecion për të ndryshuar këto çmime, por ka për obligim të zbatoj çmimet e miratuara nga ZRRë.</i>	Në raportin e auditimit në gjetjen me këtë titull paragrafi i parë është si vijon: KOSTT e blen energjinë e prodhuar nga prodhuesit me çmim më të lartë (çmimi nxitës), ndërsa e shet atë energji me çmimin më të ulët (çmimi referent), të dy çmimet të përcaktuara nga ZRRë. Pra KOSTT me këtë koment deklarojnë atë që veçse është e theksuar në raportin e auditimit.
Procesi i parashikimit të energjisë ndërmjet prodhuesve dhe furnizuesve ndryshon	Jo	Afatet kohore për dorëzimin e nominimeve dhe ri-nominimeve, si për prodhuesit nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE), ashtu edhe për furnizuesit, janë të përcaktuara qartë në Rregullat e Tregut të energjisë të miratuara nga ZRRë dhe janë zbatuar plotësisht. Mundësia për ri-nominim në tregun brenda-ditor (D) për prodhuesit nga BRE synon uljen e jobalancave për shkak të natyrës së paparashikueshme të prodhimit. Për më shumë, përshkrimet në këtë gjetje janë të paqarta. Nuk ka kuptim që jobalancet të raportohen si vlera vjetore. Konstatimi në faqen 25 se: <i>“jobalancet pozitive kanë vendosur KOSTT-in në pozitë të pafavorshme financiare ...”</i> nuk qëndron, pasi që të hyrat nga jobalancet e BRE-ve dhe Fondit BRE i rrisin të hyrat në Fondin BRE duke përmirësuar gjendjet e Fondit.	Të gjitha të hyrat dhe shpenzimet për jo balanca janë të reflektuara brenda gjetjes në raportin e auditimit.
-Prodhuesit e burimeve të energjisë së ripërtërishme nuk janë trajtuar në mënyrë të barabartë për	Jo	Gjetja 3.1.2.5 është e pasaktë, KOSTT i ka trajtuar mënyrë të barabartë Prodhuesit e burimeve të energjisë së ripërtërishme për sa i përket nënshkrimit të amendamentimit të MBE-së ku përfshihet, “Përgjegjësia e Prodhuesit për koston maksimale vjetore të jobalancit = energjia elektrike neto e prodhuar në vit x çmimi i energjisë x 0.05”. Kjo për faktin se KOSTT ka dërguar për konfirmim në ZRRë të gjitha kërkesat e Prodhuesve BRE për amendamentim të MBE-vë dhe ka nënshkruar me të gjithë gjeneratorët BRE për të cilët ka pranuar konfirmim të këtij amendamenti nga ZRRë, në përputhje me Rregullën ZRRë/Nr. 10/2017.	Gjatë fazës së auditimit nga KOSTT kemi pranuar dëshminë për 13 Prodhues dhe këtë e kemi paraqitur në raportin e auditimit, Ndërsa gjatë komentimit të draft raportit kemi pranuar dëshmi edhe

sa i përket jo balancave		Për më tepër, asnjë nga Gjeneratorë BRE në Shtojca V të raportit të auditimit (përveç dy prej tyre, për të cilët KOSTT e ka dërguar amendamentin për konfirmim në ZRrE por nuk kemi pranuar konfirmim nga ZRrE) nuk kanë shprehur interesim tek KOSTT për amendamentimin e MBE-së. Disa prej tyre (gjeneratorët BRE me kapacitet të instaluar nën 500 kW) janë të përjashtuar nga përgjegjësia për jobalance sipas Rregullës ZRrE/Nr. 10/2017. Në anën tjetër, Amendamenti i MBE-së pa pranuar konfirmim nga ZRrE nuk do të ishte në përputhje me Rregullën ZRrE/Nr. 10/2017 dhe do të mund të shkaktonte kosto shtesë në Fondin BRE të cilat do të mund të mos njiheshin nga ZRrE. Prova 10: Njoftimet e-maili për dy gjeneratorët BRE	Për dy prodhues tjerë "prova 10" të cilën po ashtu e kemi paraqitur në Raportin e auditimit, ndërsa për 13 prodhuesit e mbetur nuk kemi pranuar dëshmi se KOSTT ka Kërkuar konfirmim në ZRRE
3.1.3. Mangësi Financiare në Menaxhimin e Fondit	Jo	Më poshtë mund të gjeni komentet tona për secilën pikë të paraqitur në Raport.	
- Borxhi ndaj Llogarisë së Fondit - Në një raport përfundimtar të ZRRE-së për të Hyrat e lejuara maksimale të energjisë elektrike për operatorët e rregulluar, (viti 2022), ishte cekur se mbi shtatë 7 milion euro ishin përdorur nga KOSTT me qëllim të "mbulimit të	Jo	Pagesat në kuadër të Llogarisë Balancuese janë realizuar gjithmonë mbi bazën e vlerësimeve teknike dhe kontraktuale, duke marrë parasysh peshën e penalizimeve dhe ndikimin në përfitimin e konsumatorit. Aktualisht, në këtë llogari shuma e pambuluar është rreth 10.9 milionë euro, e cila ka rezultuar nga kostot për devijimet e energjisë. Kjo shumë nuk është paguar ende nga Qeveria e Republikës së Kosovës. Pas realizimit të pagesës nga Qeveria, do të bëhet pagesa e detyrimeve të mbetura ndaj palëve. Auditorët ju kane referuar draft raportit të ZRRE-se, i cili pas komenteve dhe dëshmive në versionin final thekson: Prova 11:	Ajo që KOSTT ka dërguar në "Prova 11" është raporti përfundimtar i MAR dhe të hyrat maksimale të lejuara për OT/OST për vitin 2024, të dyja këto dokumente janë publike në WEB e ZRRE. Konstatimi ynë është bërë pas analizimit të llogarive kontabël të Fondit BRE ku kemi identifikuar se shuma prej 5.6 milion euro nuk kishte kaluar nga KOSTT në llogarinë kontabël të Fondit, kjo sipas regjistrave deri në muajin mars 2025 kur ka ndodhur auditimit. Prandaj KOSTT duhet të sjellë dëshmi për të kundërtën e asaj që reflektohet në raportin e auditimit.

humbjeve nga katër komunitat e veriut të Kosovës”.		Përgjigje e ZRRE-së Sa i përket të gjeturave 1 dhe 2, ZRRE konsideron se sqarimet e dhëna nga KOSTT janë të qarta dhe mjaft mirë të argumentuara edhe me tabela financiare, ku mes tjerash KOSTT me përgjegjësi deklaron se asnjëherë nuk ka përdorur mjetet e Fondit të BRE-ve për mbulimin e humbjeve në katër komunitat veriore të Kosovës dhe se që nga 1 dhjetori 2017, konsumatorët e Kosovës asnjëherë nuk kanë paguar për humbjet në komunitat veriore të Kosovës përmes tarifave të KOSTT. Prandaj ZRRE plotësisht pajtohet me përgjigjet e KOSTT. Prandaj, referimi në draft raport nuk është referim i duhur dhe i sakte, rrjedhimisht e gjetura është e pabazuar.	
- Fondi ka operuar me humbje në vitin 2023	Jo	Sqarim lidhur me ngritjen e çështjes nga Auditori i ZKA-së për mbetjen negative të fondit për vitin 2023; Në vitin 2022, gjendja neto e fondit ka qenë në plus prej 1.2 milion euro (kjo vlerë figuron edhe në pasqyrat financiare të audituara). Megjithatë, gjatë shqyrtimit tarifor për vitin 2023, ZRrE ka marrë për bazë një vlerë neto prej plus 4.46 milion euro, duke mos e konsideruar shumën minus 2.8 milion euro, e cila përfaqëson shpenzimet e fondit mbi kufirin prej 5% (shpenzime jashtë balancave për BRE), të cilat i kemi raportuar në ZRrE. KOSTT e ka ngritur këtë çështje në ZRrE, duke theksuar se këto shpenzime mbi 5%, në vlerë minus 2.8 milion euro, nuk janë përfshirë në shqyrtimin tarifor për vitin 2023. Në vitin 2024, fondi është kompensuar në vlerën prej 5.64 milion euro. Prova numër 12 Këto sqarime janë paraqitur në dokumentin “Raporti Përfundimtar për të Hyrat e Lejuara Maksimale të OST/OT-së” (faqe 14), si dhe në Vendimin nr. V_1922_2024, ku pasqyrohen përshtatjet e fondit për vitin 2023. Në përputhje me dispozitat rregullative ZRrE, në çdo shqyrtim tarifor kryen procesin e rregullt tarifor të përshtatjes së Fondit. Ky mekanizëm siguron reflektimin korrekt të bilancit	Në raportin e auditimit janë të reflektuar shkaktarët për bilancin financiar të Fondit për vitin 2023. Pra edhe në pasqyrat financiare të KOSTT për vitin 2023 Fondi është raportuar me humbje në vlerë prej 5 milion euro, prandaj nëse KOSTT nuk pajtohen me gjetjen duhet të ofrojnë dëshmi që mbështesin komentin e tyre.


		financiar të fondit, duke bërë që çdo suficit i evidentuar në fund të vitit të zbritet proporcionalisht nga kërkesa tarifore e vitit pasues, ndërsa çdo deficit të inkorporohet në llogaritjen e vitit vijues, për t'u kompensuar në llogaritjen tarifore të vitit vijues. Ky parim garanton transparencë, neutralitet financiar dhe trajtim të drejtë të të gjitha palëve të përfshira.	
-KOSTT nuk ishte efikas në inkasimin e të hyrave në Fond	Jo	Sqarim lidhur me vështirësitë e inkasimit të mjeteve; Kriza energjetike globale gjatë viteve 2021–2022, ka ndikuar në mënyrë të konsiderueshme sektorin e energjisë në vend, në veçanti KOSTT-in, si operator përgjegjës për balancimin e sistemit elektro-energjetik të Kosovës. Gjatë kësaj periudhe, niveli i devijimeve në sistem ka qenë dukshëm i lartë, duke e bërë edhe më të vështirë realizimin e pagesave të detyruara nga palë përkatëse. Sektori i energjisë funksionon si një zinxhir i ndërlidhur, ku secila hallkë ndikon drejtpërdrejtë në stabilitetin financiar dhe operacional të hallkave tjera. Andaj, vështirësitë financiare në një pjesë të sistemit reflektohen menjëherë në pjesët e tjera, duke e ndërlikuar procesin e inkasimit të mjeteve në tërësi. Pavarësisht këtyre sfidave, KOSTT ka siguruar kryerjen e pagesave ndaj prodhuesve të BRE-ve, duke respektuar plotësisht obligimet kontraktuale dhe rregullative ndaj tyre. Ndërlidhur me mos pagesat e borxheve nga ana e KESCO-s, KOSTT ka ndërmarrë veprime ligjore përmes procedurës përmbarimore, e cila ka rezultuar me inkasimin e shumave të detyruara, përfshirë edhe kamatat ligjore për vonesat në pagesë. KOSTT ka shfrytëzuar të gjitha instrumentet dhe mjetet e parashikuara sipas legjislacionit në fuqi për të realizuar procesin e inkasimit në mënyrë efektive.	Nëse KOSTT nuk pajtohet me gjetjen duhet të ofrojë dëshmi se ka inkasuar në kohë pagesat për Fondin sepse shpjegimet që KOSTT ka dhënë në këtë dokument veç se janë reflektuar në raportin e auditimit por arsyetime për vonesave nuk e ndryshojnë gjendjen, për më tepër në raport paraqitet që vonesat janë edhe për vitet tjera.

- Vështirësi në gjurmimin e të hyrave të Fondit	Jo	Sqarim lidhur me vështirësitë në gjurmimin e të hyrave të Fondit; Gjetja në raport lidhur me vështirësitë e gjurmimit të pagesave të Fondit është e pasaktë sepse procesi i kryerjes dhe raportimit të pagesave është i strukturuar në mënyrë tërësisht transparente dhe të verifikueshme. Të gjitha faturat si të hyra nga fondi dhe ato si shpenzime të fondit procedohen në kontabilitetin financiar me kode(konto) të veçanta dhe evidentohen të specifikuara sipas faturave dhe numrit të faturave të cilat janë në dispozicion të palëve të interesit dhe prezantohen në raporte tremujore, raportin vjetor si dhe në pasqyrat financiare vjetore të cilat auditohen nga kompani auditues të jashtme si dhe nga Zyra Kombëtare e Auditimit. Sa i përket çështjes së pagesave, në çdo pagesë palët prezantojnë numrin e faturës për të cilën bëhet pagesa (shih dokumentin e bankës bashkangjitur) në bazë të cilës identifikohet baza e pagesës dhe kjo është gjithashtu në dispozicion të palëve të interesit. Me fillimin e tregtimit të energjisë së prodhuar nga BRE-të përmes Bursës Shqiptare të Energjisë- ALPEX, është bërë hapja e llogarisë së veçantë të klerimit nga e cila pagesat bëhen nga llogaria sipas të dhënave nga ALPEX . Përmes ALPEX, KOSTT kryen gjithashtu tregtimin e energjisë për mbulimin e humbjeve në transmetim, dhe banka përgjegjëse për procesin e klerimit i mbledh dhe ekzekuton të dyja transaksionet së bashku brenda ditës. Pagesat janë të argumentueshme dhe transparente për të dy transaksionet. Prova numër 13: Raporti i bankës ku shihen numrat e faturave të paguara	Dëshmia/prova që kemi pranuar veçse e konfirmon atë që është e paraqitur në raportin e auditimit lidhur me këtë çështje. Pra në Raportin e bankës shihet se e hyra (inkasimi) në vlerë prej 3 milion euro lidhet me 4 fatura të cilat në total kapin vlerën 6,8 milion euro, ndërsa vetëm 2 nga këto fatura i takojnë Fondit dhe janë në vlerë 5,1 milion euro. Dy faturat tjera janë kërkesa tjera të KOSTT që nuk lidhen me Fond. Ky është edhe konstatimi që kemi bërë në raportin e auditimit.
---	----	---	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës **"Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë"**, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: 12.08.2025 Prishtinë

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- Kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit **"Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtëritshme të Energjisë"** (në tekstin e mëtejshëm **"Raporti"**);
- Nuk pajohemi me të gjeturat e prezantuara në raport me ZRRE-në, dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit të cilat i gjeni të bashkangjitura.
- ZRRE e refuzon si të pabazuar pretendimin se tarifa e Fondit BRE është rritur për shkak të kostove nga jo-balancat pa i përmendur edhe komponentët tjerë të cilët sqarohen në "Gjetja 2" është i pabazuar. Të hyrat nga jo-balancat përbëjnë një komponent pozitiv për Fondin, dhe jo shkak për rritje të çmimeve. Rritja e tarifës ka pasuar nga faktorë të tjerë financiarë të identifikueshëm dhe të dokumentuar. Andaj, çdo pretendim i Auditorit që nuk pasqyron këtë fakt është i pabazuar dhe i pasaktë.
- ZRRE e refuzon si të pabazuar vlerësimin e ZAP, se ZRRE nuk ka bërë monitorim të Fondit BRE apo se ka aprovuar të dhënat pa analizë kritike. Monitorimi energjetik dhe financiar realizohet rregullisht dhe në mënyrë sistematike, ndërsa çdo gabim i identifikuar në të dhënat e paraqitura nga operatorët është trajtuar përmes mekanizmave të paraparë rregullatorë. Gabimet e identifikuara në raportin e auditorit lidhen me procese të veçanta të KOSTT dhe se nuk janë pasojë e mos monitorimit të ZRRE, pasi siç potencuam më lartë ZRRE në mënyrë sistematike bënë monitorimin energjetik dhe financiar të Fondit të BRE-ve. Korrigjimet e bëra më vonë janë arsyetuar nga ndryshimet e parametrave tjerë bërë nga KOSTT gjatë aplikimit të vitit 2022, dhe kjo nuk mund t'i atribuohet mosveprimi institucional, pasi që siç kemi potencuar ZRRE ka identifikuar devijimin gjatë shqyrtimit të aplikacionit për vitin 2024 dhe ka aplikuar korrigjimin përkatës pa pasur efekt negativ në transparencën e procesit apo në koston totale për konsumatorët. Për më tepër, rritja e tarifës së BRE-së në vitin 2023 u bazua në nevojat e vërtetuara të fondeve dhe u shpjegua në dokumentet përkatëse, ndërsa humbjet e vitit 2023 janë rezultat i faktorëve të jashtëm që nuk lidhen me administrimin e ZRRE-së.

Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati:2, 10000 Prishtinë, Kosovë
 Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org



Republika e Kosovës
Republika Kosova - Republic of Kosovo

ZYRA E RREGULLATORIT PËR ENERGJI
REGULATORNI URED ZA ENERGIJU
ENERGY REGULATORY OFFICE



- ZRRE e refuzon si të pabazuar opinionin e ZAP se ka pasur mungesë të kontrollit apo monitorimit në raport me realizimin e të hyrave të Fondit BRE për vitin 2023. Veprimet e ZRRE-së janë në përputhje të plotë me kornizën rregullative dhe financiare në fuqi, dhe çdo devijim i identifikuar është trajtuar në mënyrë të dokumentuar dhe transparente përmes mekanizmave zyrtarë tariforë.
- ZRRE e refuzon konstatimin e ZAP që tarifat nxitëse nuk janë përditësuar në përputhje me inflacionin. Ndryshimi në mënyrën e kalkulimit ka qenë teknik, i arsyetuar dhe i bazuar në zbatim të drejtë të kuadrit rregullator. Çdo përditësim tarifor është bërë në linjë me metodologjinë përkatëse dhe nuk ka pasur ndikim negativ të paarsyeshëm mbi Fondin për BRE.
- ZRRE hedh poshtë konstatimin e ZAP-së se aplikimi i kufirit 5% për përgjegjësinë e jo-balancave ka pasur efekt negativ për Fondin apo ka favorizuar padrejtësisht prodhuesit. Ky kufi është zbatuar me mbështetje të partnerëve zhvillimorë ndërkombëtarë, përmes procesit të rregullit të vendimmarrjes, dhe për qëllim ka pasur garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të BRE në Kosovë, pa kompromentuar funksionalitetin e Fondit apo detyrimet e konsumatorëve.
- ZRRE nuk ka mohuar detyrimin ligjor për lëshimin e Certifikatave të Origjinës, por ka vlerësuar se pa anëtarësim në AIB dhe pa infrastrukturë të përshtatshme kombëtare dhe ndërkombëtare, lëshimi i tyre aktualisht nuk do të kishte asnjë efekt funksional apo tregtar për prodhuesit apo konsumatorët. Në këtë drejtim, ZRRE mbetet e angazhuar për ndërtimin e sistemit të certifikatave, por kjo kërkon kohë, resurse dhe bashkëpunim ndërinstitucional.
- Sa i përket rekomandimit për ZRRE-në që: Të monitoroj Fondin dhe të dokumentojë rezultatet e nxjerra nga monitorimi, në mënyrë që vendimet që i merr të jenë vendime të bazuara në informata (të dhëna të sakta). Të vendosë prag për jo balancat dhe tejkalimi mbi prahun e vendosur të trajtohet me mekanizma shtesë ndëshkues/stimulues në mënyrë që të ulin jo-balancat e gjeneratorëve. Lidhur me këtë ZRRE thekson se kjo do të bëhet në pajtim me detyrimet ligjore të Ligjit për BRE dhe kornizën tjetër të aplikueshme për projektet e BRE-ve.
- ZRRE brenda përgjegjësiave ligjore të dhëna me Ligjin për BRE dhe kornizën rregullative në fuqi për as sa e lejojnë mundësit ligjore dhe procedurale do të vazhdoj me zbatimin e obligimeve ligjore.

Zyra e Rregullatorit për Energji

Ymer Fejzullahu
Ymer Fejzullahu, Kryesues i Bordit të ZRRE-së



Adresa: Rr. Bekim Fehmiu (Ish Ndërtesa e Fazitës), kati-2, 10000 Prishtinë, Kosovë
Tel: 038 247 615 lok. 101, Fax: 038 247 620, E-mail: info@ero-ks.org, web: www.ero-ks.org

Dokumenti: Komentet nga (Zyra e Rregullatortit për Energji e Republikës së Kosovës) në draft raportin e auditimit

Gjetjet	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
Gjetja 2		ZRRE nuk ka monitoruar se si është menaxhuar Fondi i burimeve të ripërtërishme të energjisë ZRRE nuk pajtohet me vlerësimin e ZAP, sipas të cilit nuk është bërë monitorim efektiv i Fondit të Burimeve të Ripërtërishme të Energjisë (Fondi BRE), si dhe nuk janë shqyrtuar në mënyrë kritike aplikacionet tarifore të KOSTT dhe të dhënat e raportuara lidhur me mbetjet financiare dhe tarifën e Fondit. 1. ZRRE kryen monitorim të vazhdueshëm dhe sistematik në përputhje me kornizën rregullative ZRRE, në përputhje me funksionet dhe përgjegjësitë e përcaktuara në legjislacionin sektorial, kryen monitorim të rregullt dhe të vazhdueshëm të të dhënave energjetike dhe financiare, përmes: • Raporteve mujore dhe tremujore që KOSTT dorëzon për operimin e Fondit BRE; • Verifikimit të të dhënave financiare dhe energjetike në procesin e shqyrtimit tarifor; • Krahasimit të performancës së planifikuar dhe asaj të realizuar për të hyrat dhe daljet në Fond; • Zbatimit të mekanizmave korrigjues, të cilët adresojnë çdo devijim që ndodh ndër vite. Ky monitorim përfshin analizën e çdo komponenti të Fondit BRE, përfshirë: tarifën nxitëse, çmimin referent, kostot e jo-balancës, shpenzimet e menaxhimit dhe të gjitha elementet që ndikojnë në përcaktimin dhe rregullimin e tarifës së Fondit. 2. ZRRE ka shqyrtuar dhe trajtuar devijimin në mbetjet financiare të raportuara nga KOSTT për vitin 2022	Raporti i auditimit trajton çështjen që ka të bëjë me lëshimin në aplikacionin e KOSTT për lejm të të hyrave maksimale për Fondin e cila nuk ishte identifikuar nga ZRRE ndërsa korrigjimi ishte bërë me kërkesë të KOSTT dhe atë në vitin tarifor vijues. Për më tepër ZRRE nuk ka ofruar asnjë dëshmi se kryen monitorim të pikave që i ka listuar në këtë dokument. Siç edhe e kemi cekuar në raport, të vetmin mekanizëm monitorimi të Fondit, ZRRE e ka shqyrtimin tarifor vjetor.

		ZRRE, gjatë shqyrtimit tarifor për vitin 2024, ka analizuar kërkesën e KOSTT për korrigjimin e mbetjes së raportuar nga viti 2022, ku vlera fillestare prej 4.3 milion euro ishte deklaruar gabimisht dhe vlera e saktë ishte 1.2 milion euro. ZRRE ka shqyrtuar këtë kërkesë në përputhje me Rregullën për të Hyrat Maksimale të Lejuara, dhe korrigjimi është bërë përmes mekanizmit të faktorëve korrigjues, i cili është një praktikë standarde dhe transparente në rregullimin tarifor. Ky korrigjim është reflektuar në dokumentacionin e të hyrave për vitin 2024 dhe është bërë pa ndikuar në integritetin e procesit të përcaktimit të tarifës. 3. Tarifat dhe çmimet nuk janë aprovuar automatikisht – janë shqyrtuar dhe analizuar nga ZRRE Pretendimi se tarifa e Fondit BRE dhe çmimi referent janë aprovuar në të njëjtën formë siç janë propozuar nga KOSTT nuk qëndron. ZRRE, në secilin cikël tarifor, analizon aplikacionet dhe të dhënat energjetike e financiare të paraqitura nga KOSTT, të cilat duhet të jenë të përgatitura dhe të bazuara në përputhje me: • Rregullën për të Hyrat e OST/OT, • Metodologjinë për Llogaritjen e Çmimit Referent për Energjinë nga Burimet e Ripërtëritshme, si dhe • Metodologjitë për Tarifat e Rrjetit për Operatorin e Shpërndarjes (OS) dhe Operatorin e Transmetimit (OT). Procesi i shqyrtimit tarifor përfshin: • Analizën e të dhënave historike dhe krahasimin me periudhat e mëparshme; • Vlerësimin e treguesve aktualë të tregut dhe inflacionit; • Konsultimin me aktorët përkatës të tregut dhe shqyrtimin e komenteve të palëve të interesit gjatë publikimit të dokumenteve për koment publik.	
--	--	--	--

		Të gjitha këto përfshihen në raportet përfundimtare për të hyrat maksimale të lejuara për OST/OT, të cilat përmbajnë arsyetimet për çdo ndryshim të propozuar ose të aprovuar, përfshirë ndikimin e mbetjeve financiare apo devijimeve nga planifikimet e mëparshme. 4. Rritja e tarifës BRE për vitin 2023 është e justifikuar dhe e dokumentuar Rritja e tarifës së Fondit BRE nga 0.73 €/MWh në vitin 2022 në 3.14 €/MWh në vitin 2023 ka qenë rezultat i: • Rritjes së ndjeshme të kostove për tarifat nxitëse; • Rritjes së volumit të energjisë nga burimet e ripërtëritshme të përfshira në Skemën Mbështetëse; • Shpenzimeve shtesë të krijuara nga jo- balancat dhe nga korrigjimet e inflacionit; • Rregullimit të mbetjeve të bartura nga vitet paraprake. Të gjitha këto janë të pasqyruara në dokumentacionin tarifor të vitit 2023 dhe janë pjesë e raporteve të publikuara zyrtarisht. 5. ZRRE ka marrë masa korrigjuese për të adresuar çdo devijim në kohë Pavarësisht deklaramit të gabuar të mbetjes nga KOSTT për vitin 2022, ZRRE ka identifikuar devijimin gjatë shqyrtimit të aplikacionit për vitin 2024 dhe ka aplikuar korrigjimin përkatës pa pasur efekt negativ në transparencën e procesit apo në koston totale për konsumatorët. Kjo tregon se ZRRE ka një proces funksional dhe efektiv të monitorimit dhe korrigjimit të të dhënave, që siguron mbrojtjen e interesit të konsumatorëve dhe integritetin e sistemit tarifor Përfundim: ZRRE e refuzon si të pabazuar vlerësimin e ZAP se nuk ka bërë monitorim të Fondit BRE apo se ka aprovuar të dhënat pa analizë kritike. Monitorimi energjetik dhe financiar realizohet rregullisht dhe në mënyrë sistematike, ndërsa çdo gabim i identifikuar në të dhënat e paraqitura nga operatorët është trajtuar përmes mekanizmave të paraparë rregullatorë. Gabimet e identifikuaa ne raportin e auditorit lidhen me procese te veçanta të KOSTT dhe se nuk janë pasojë e mos monitorimit te ZRRE, pasi siç potencuam më lartë ZRRE në mënyrë sistematike	Nga dëshmitë që kemi marrë identifikimi i gabimit lidhur me mbetjen në Fond është identifikuar në fund të vitit 2023 dhe është raportuar nga KOSTT në aplikacionin për shqyrtim të tarifave vjetore. Para pranimit të informacionit nga KOSTT, ZRRE nuk e kishte identifikuar gabimin. Prandaj kemi konstatuar se monitorimi i ZRRE-së nuk ishte efektiv.
--	--	---	--

		bënë monitorimin energjetik dhe financiar të Fondit të BRE-ve. Korrigjimet e bëra më vonë janë arsyetuar nga ndryshimet e parametrave tjerë bërë nga KOSTT gjatë aplikimit të vitit 2022, dhe kjo nuk mund t'iu atribuohet mosveprimt institucional, pasi që siç kemi potencuar ZRRE ka identifikuar devijimin gjatë shqyrtimit të aplikacionit për vitin 2024 dhe ka aplikuar korrigjimin përkatës pa pasur efekt negativ në transparencën e procesit apo në koston totale për konsumatorët. Për më tepër, rritja e tarifës së BRE- së në vitin 2023 u bazua në nevojat e vërtetuara të fondeve dhe u shpjegua në dokumentet përkatëse, ndërsa humbjet e vitit 2023 janë rezultat i faktorëve të jashtëm që nuk lidhen me administrimin e ZRRE- së.	
Gjetja 3		Të hyrat maksimale të lejuara ZRRE nuk pajtohet me opinionin e ZAP, sipas të cilit ka munguar monitorimi dhe kontrolli efektiv mbi realizimin e të hyrave nga Tarifa për BRE për vitin 2023, si dhe me pohimin se ZRRE nuk ka kërkuar sqarime nga KOSTT për devijimet ndërmjet planifikimit dhe realizimit faktik të të hyrave në Fondin BRE. 1. ZRRE ka kërkuar dhe ka shqyrtuar sqarime të detajuara nga KOSTT për të hyrat dhe devijimet në Fondin BRE Gjatë procesit të përshtatjes së të hyrave maksimale të lejuara për vitin 2024, ZRRE ka kërkuar në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të dokumentuar nga KOSTT që të dorëzojë: • Pasqyrat financiare të detajuara për Fondin BRE; • Të dhënat mbi të hyrat faktike nga Tarifa BRE dhe nga jobalancat; • Daljet dhe shpenzimet e realizuara nga Fondi për tarifatat nxitëse, jo-balancat dhe menaxhimin; • Si dhe çdo devijim ndërmjet planifikimeve dhe realizimeve për vitin 2023. Në përputhje me kërkesat e ZRRE-së, KOSTT ka dorëzuar dokumentacion të plotë, përfshirë analizën e flukseve hyrëse dhe dalëse, nga ku është evidentuar se Fondi BRE ka operuar me një mungesë në fund të vitit në vlerë prej 5.6 milion euro. 2. ZRRE ka trajtuar devijimin përmes mekanizmit rregullator të faktorëve korrigjues të të hyrave	Gjetja nuk e mohon se ZRRE ka kërkuar/pranuar dokumentet nga KOSTT mirëpo nuk kemi gjetur asnjë dëshmi se të njëjtat janë analizuar dhe se nuk kemi gjetur që ka rezultate nga analiza e as çfarëdo efekti ose veprimi për të adresuar devijimet që kishin ndodhur, për të cilat flitet në raportin e auditimit.

		ZRRE, në përputhje me Rregulloren për të Hyrat Maksimale të Lejuara (Rregulla për Rregullimin e të Hyrave), ka zbatuar mekanizmin e faktorit korigjues, për të adresuar devijimet ndërmjet të hyrave të planifikuara dhe atyre të realizuara. Konkretisht, mbetja negative në Fondin BRE për vitin 2023 është bartur si pjesë e faktorëve korigjues në përcaktimin e të hyrave për vitin 2024, dhe është e reflektuar qartë në dokumentacionin tarifor të dorëzuar dhe të publikuar nga ZRRE. 3. Procesi i shqyrtimit tarifor përfshin analizë të plotë të performancës së Fondit BRE Çdo vit, përfshirë edhe për vitin 2023, ZRRE realizon shqyrtim të detajuar të performancës financiare të KOSTT në menaxhimin e Fondit BRE, përmes: • Auditimit dhe verifikimit të të dhënave financiare të dorëzuara nga KOSTT; • Krahimit të të hyrave të planifikuara me ato të realizuara; • Identifikimit të arsyeve për çdo devijim të ndjeshëm; • Zbatimit të faktorëve korigjues në linjë me metodologjinë rregullative. Prandaj, konstatimi se ZRRE “nuk kishte kërkuar asnjë shpjegim” apo “nuk kishte identifikuar mangësitë” nuk qëndron dhe nuk mbështetet në dokumentacionin real të shkëmbyer ndërmjet ZRRE-së dhe KOSTT-it. ZRRE ka vepruar në mënyrë proaktive, të bazuar në ligj dhe metodologji të miratuara, duke siguruar që çdo ndryshim financiar në Fond të trajtohet në mënyrë transparente dhe korrekte. Përfundim: ZRRE e refuzon si të pabazuar opinionin e ZAP se ka pasur mungesë të kontrollit apo monitorimit në raport me realizimin e të hyrave të Fondit BRE për vitin 2023. Veprimet e ZRRE-së janë në përputhje të plotë me kornizën rregullative dhe financiare në fuqi, dhe çdo devijim i identifikuar është trajtuar në mënyrë të dokumentuar dhe transparente përmes mekanizmave zyrtarë tariforë.	Të gjitha pikave në këtë listë, të cilat ZRRE pretendon se i kryen, nuk i kemi gjetur në asnjë prej dokumenteve që i ka hartuar ZRRE, prandaj edhe kemi konstatuar se monitorimi nuk ka qenë efektiv.
Gjetja 4		Inflacioni lidhur me gjeneratorët BRE nuk ishte korigjuar si duhet	

		ZRRE nuk pajtohet me konstatimin e Zyrës Kombëtare të Auditimit (ZAP) lidhur me mospërshtatjen e duhur të tarifave nxitëse me inflacionin për prodhuesit e energjisë nga burimet e ripërtërishme të energjisë (BRE) që janë pjesë e Skemës Mbështetëse. Në vijim ofrojmë sqarime të detajuara për arsyet e kundërshtimit të këtij konstatimi: 1. ZRRE ka zbatuar vazhdimisht dhe në mënyrë të përputhshme me kornizën ligjore përshtatjet vjetore të tarifave për inflacion. Sipas nenit 13 të Rregullës për Skemën Mbështetëse, tarifat nxitëse duhet të përshtaten çdo vit sipas indekseve të inflacionit të publikuara nga një burim zyrtar, siç është Eurostat. ZRRE ka përdorur indeksin e harmonizuar të çmimeve të konsumit (HICP) të Eurostat për të bërë përshtatjen e tarifave çdo vit për të gjithë gjeneratorët që janë pjesë e Skemës Mbështetëse. 2. Kalimi nga metoda kumulative në metodën vjetore është bërë për të përmirësuar saktësinë dhe reflektuar më mire ndikimin real të inflacionit dhe jo si korrigjim i gabimeve. Fillimisht është përdorur metoda kumulative me vit bazë 2015, por për shkak të kufizimeve praktike dhe për të reflektuar më drejt ndikimin real të inflacionit mbi të hyrat e operatorëve, ZRRE ka kaluar në metodën e përlllogaritjes vjetore, ku për çdo vit merret ndryshimi i indeksit nga viti paraprak. Kjo metodë është më e përshtatshme për qëllime tarifore, duke reflektuar ndryshimet reale të vitit fiskal përkatës. 3. Nuk ka pasur vendim të veçantë të Bordit për këtë ndryshim, pasi veprimi bazohet në kuadër ekzistues rregullator. ZRRE nuk ka nxjerrë vendim të veçantë, pasi metoda e përdorur për përlllogaritjen e inflacionit është pjesë e zbatimit teknik të dispozitave të Rregullës për Skemë Mbështetëse dhe Vendimit për Tarifën Nxitëse. Çdo rregullim teknik i këtij lloji është bërë në funksion të zbatimit të drejtë dhe në kohë të dispozitave rregullative dhe nuk ka ndryshuar parimet bazë apo strukturën e tarifës. 4. Korrigjimet retroaktive janë veprime korrekte administrative për të siguruar trajtim të barabartë. ZRRE, përmes komunikimeve të dokumentuara me KOSTT, ka kërkuar që për periudhën 2017-2022 të bëhen korrigjimet e inflacionit, në mënyrë që të sigurohet	Ky konstatim nuk përkon me konstatimin tonë dhe nuk mund t'i atribuohet raportit të auditimit. Në raport kemi konstatuar se ka pasur ndryshim në metodologjinë e llogaritjes së inflacionit dhe ky ndryshim ka pasur efekt financiar në Fond, sepse në mënyrë retroaktive prodhuesve u janë paguar mbi gjysmë milion euro nga mjetet e Fondit. Pika 3 as që ceket në raport. Sa i përket pikës 4, raporti nuk e konteston të drejtën e ZRRE për të bërë korrigjime, raporti i auditimit e nxjerr në pah ndikimin financiar që korrigjimi ka pasur në Fond dhe nuk e kemi quajtur “shpenzim të panevojshëm” siç po pretendon ZRRE në pikën 5 të këtij dokumenti.
--	--	--	---

		trajtimi i barabartë i të gjithë gjeneratorëve BRE dhe përputhja e tarifave me rritjen reale të çmimeve në treg. Kjo nuk paraqet vendim të jashtëligjshëm, por zbatim të drejtë të dispozitave tarifore në përputhje me nenin 13 të Rregullës. 5. Shuma prej 520 mijë euro e “Kritikuar” nuk është “shpenzim i panevojshëm”, por rregullim i arsyeshëm financiar. Shuma që ka rezultuar si pagesë për korrigjim të inflacionit është rrjedhojë direkte e zbatimit të metodologjisë së përmirësuar dhe nuk paraqet as favorizim, as shpenzim të panevojshëm, pasi është kryer mbi baza të qarta përlllogaritëse, në pajtim me të dhënat zyrtare nga Eurostat. Përfundim: ZRRE e refuzon konstatimin e ZAP që tarifat nxitëse nuk janë përditësuar në përputhje me inflacionin. Ndryshimi në mënyrën e kalkulimit ka qenë teknik, i arsyetuar dhe i bazuar në zbatim të drejtë të kuadrit rregullator. Çdo përditësim tarifor është bërë në linjë me metodologjinë përkatëse dhe nuk ka pasur ndikim negativ të paarsyeshëm mbi Fondin për BRE	
Gjetja 5		Kufiri prej 5% i përgjegjësisë së jo balancave për gjeneratorët ka pas efekt të negative ZRRE nuk pajtohet me vlerësimin e ZAP-së që ndryshimi i aplikimit të përgjegjësisë për jobalancat për gjeneratorët e përfshirë në Skemën Mbështetëse ka pasur efekt negativ apo ka krijuar favorizim të padrejtë për prodhuesit e BRE. Sqarimet janë si në vijim: 1. Zbatimi i kufirit 5% për jobalanca është bërë në pajtim me procedurat e Bordit të ZRRE-së, ku drafti i Marrëveshjes së Blerjes së Energjisë (PPA), i cili përfshin edhe klauzolën për kufirin 5%, është miratuar si dokument zyrtar në mbledhje të Bordit. Ky draft është ndarë me të gjitha palët përfituese dhe përfaqëson bazën kontraktuale për zbatimin e kësaj politike. 2. Dokumenti i përdorur si referencë nga ZAP, përkatësisht procesverbali i mbledhjes së Bordit më 5 qershor 2019, nuk përfaqëson vendim të vetëm dhe të plotë për ndryshimin, por një dokument mbështetës, ndërkohë që vendimi përfundimtar është reflektuar brenda draftit të miratuar të PPA, siç është dërguar edhe te ZAP në versionin zyrtar në gjuhën angleze dhe është ofruar në shqip. 3. Kufiri 5% i aplikuar nuk përjashton prodhuesit nga përgjegjësia për jobalanca, por përfaqëson një mekanizëm kufizimi të rrezikut financiar, bazuar në rekomandime të BERZH dhe Bankës Botërore, në mënyrë që prodhuesit të mos	Ndryshimi i përgjegjësisë në kufirin 5% të jo-balancave ka pasur ndikim financiar te Fondi në vlerë prej 4,6 milion euro të kthyera tek prodhuesit gjatë viteve 2022-2024 si rezultat i këtij vendimi. Arsyetimi pse ZRRE ka marrë këtë vendim është paraqitur në raport të auditimit sipas dëshmive që i ka ofruar ZRRE gjatë auditimit.

		penalizohen në mënyrë joproporcionale për jobalanca që ndodhin si rezultat i faktorëve jashtë kontrollit të tyre (siç janë kufizimet teknike të tregut dhe mungesa e mjeteve të avancuara të parashikimit). 4. Sipas strukturës së tarifës, mbulimi i pjesës së mbetur të kostove të jobalancës përmes Fondit nuk përbën shpenzim shtesë të pajustificuar, por zbatim të rregullt të funksionit të Fondit për mbështetje të energjisë së ripërtëritshme, siç është e paraparë me Ligjin për promovimin e BRE dhe aktet nënligjore përkatëse. 5. Në vend të ndikimit negativ të pretenduar, ky mekanizëm i kufirit 5% ka kontribuar në stabilitet të financimit dhe tërheqje të investimeve në sektorin e BRE, për shkak të qartësisht të ekspozimit financiar të investitorëve. Kjo është dëshmuar nga rritja e numrit të aplikimeve në Skemën Mbështetëse dhe rritja e prodhimit të energjisë së gjelbër në vend. Përfundim: ZRRE hedh poshtë konstatimin e ZAP-së se aplikimi i kufirit 5% për përgjegjësinë e jobalancave ka pasur efekt negativ për Fondin apo ka favorizuar padrejtësisht prodhuesit. Ky kufi është zbatuar me mbështetje të partnerëve zhvillimorë ndërkombëtarë, përmes procesit të rregullt të vendimmarrjes, dhe për qëllim ka pasur garantimin e zhvillimit të qëndrueshëm të sektorit të BRE në Kosovë, pa kompromentuar funksionalitetin e Fondit apo detyrimet e konsumatorëve.	
		Nuk janë lëshuar certifikatat e origjinës për Prodhuesit ZRRE nuk ka refuzuar detyrimin ligjor për të lëshuar Certifikata të Origjinës për energjinë e prodhuar nga burimet e ripërtëritshme, por ka vepruar në përputhje me kornizën ekzistuese ligjore dhe teknike, si dhe kapacitetet e tanishme institucionale dhe tregtare në Kosovë. Konkretisht: 1. Ligji për Energjinë Elektrike (neni 8) dhe Ligji për promovimin e BURIMEVE të Ripërtëritshme të Energjisë e përcaktojnë qartë se ZRRE duhet të krijojë dhe administrojë sistemin e Certifikatave të Origjinës, por këto certifikata nuk kanë funksion tregtar praktik në tregun aktual vendor, pasi nuk ekziston infrastrukturë funksionale për tregtimin apo njohjen e tyre nga palët e treta. 2. Anëtarësimi në AIB (Association of Issuing Bodies) është një parakusht teknik dhe administrativ për të siguruar që Certifikatat e Origjinës të jenë të njohura ndërkombëtarisht dhe të përdorshme për tregtim ndërkufitar. Pa këtë	Në raportin e auditimit është cekuar se një nga kërkesat ligjore, për të cilën përgjegjëse është ZRRE-ja, nuk është përmbushur. Përveç kësaj janë paraqitur edhe shpjeguar arsyet dhe rrethanat se pse nuk janë lëshuar certifikatat e origjinës nga ZRRE.

		anëtarësim, certifikatat nuk kanë asnjë funksionalitet tregtar, pra do të ishin vetëm deklarative dhe jo të verifikueshme në platforma të njohura. 3. Prodhuesit në Skemën Mbështetëse tashmë përfitojnë subvencione për energjinë e prodhuar, dhe janë të garantuar me blerje të energjisë me tarifa të përcaktuara, pra nuk kanë nevojë të përdorin certifikata të origjinës për tregtim apo marketing. Për rrjedhojë, lëshimi i tyre nuk do të krijonte vlerë shtesë për tregun, por vetëm barrë administrative. 4. Për më tepër, në mungesë të një sistemi të centralizuar elektronik të certifikimit dhe verifikimit, çdo certifikatë e lëshuar do të ishte e pasigurt dhe e paaksesueshme për aktorët e tregut dhe konsumatorët fundorë. ZRRE nuk ka mohuar nevojën për një sistem të tillë, por ka kërkuar që ai të ndërtohet në mënyrë të integruar me sistemet e BE-së në të ardhmen, kur Kosova të jetë pjesë e rrjeteve përkatëse. 5. Përderisa energjia e prodhuar nga BRE tashmë trajtohet me përparësi në dispeçim dhe tarifim, konsumatori përfiton përmes tranzicionit të gjelbër, dhe jo nëpërmjet posedimit të një certifikate joaktive në treg. Përfundim: ZRRE nuk ka mohuar detyrimin ligjor për lëshimin e Certifikatave të Origjinës, por ka vlerësuar se pa anëtarësim në AIB dhe pa infrastrukturë të përshtatshme kombëtare dhe ndërkombëtare, lëshimi i tyre aktualisht nuk do të kishte asnjë efekt funksional apo tregtar për prodhuesit apo konsumatorët. Në këtë drejtim, ZRRE mbetet e angazhuar për ndërtimin e sistemit të certifikatave, por kjo kërkon kohë, resurse dhe bashkëpunim ndër-institucional	
--	--	---	--



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria-Vlada-Government
Ministria e Ekonomisë
Ministarstvo Ekonomije /Ministry of Economy

LETËR E KONFIRMIMIT

Për pajtueshmërinë me gjetjet e Auditorit të Përgjithshëm për raportin e auditimit të performancës “Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë”, dhe për zbatimin e rekomandimeve.

Për: Zyrën Kombëtare të Auditimit

Vendi dhe data: Prishtinë
27.08.2025

I/e nderuar,

Përmes kësaj shkrese, konfirmoj se:

- kemi pranuar draft raportin e Zyrës Kombëtare të Auditimit “Menaxhimi i Fondit për Burimet e Ripërtërithme të Energjisë” (në tekstin e mëtejshëm “Raporti”);
- pajtohem pjesërisht me gjetjet dhe rekomandimet dhe kemi komente për përmbajtjen e Raportit të cilat i gjeni bashkëlidhur kësaj letre; si dhe
- brenda 30 ditëve nga pranimi i Raportit final, do t’ju dorëzojmë një plan të veprimit për implementimin e rekomandimeve, i cili do të përfshijë afatet kohore dhe stafin përgjegjës për implementimin e tyre.

Artane RIZVANOLLI,
Ministre në detyrë e Ministrisë së Ekonomisë.



Dokumenti: Komentet nga (Ministria e Ekonomisë) në draft raportin e auditimit


Gjetjet	Pajtohem po/ jo	Komentet nga Institucioni i audituar ne raste te mospajtimi	Pikëpamja e ZKA-së
Gjetja 1⁹² Ministria e Ekonomisë nuk ka mbikëqyrur zbatimin e politikave të BRE	jo	Nuk pajtohem sepse nuk reflekton përmbajtjen e raportit.	
Gjetja 2 Ministria e Ekonomisë nuk ka bërë monitorimin e zbatimit të politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë dhe arritjen e caqeve të cilat i kishte vendosur para vitit 2020.	jo	Nuk ka bërë monitorimin të zëvendësohet me ' <i>është bërë përmes raporteve te progresit</i> ' sipas obligimit ligjor. Për informimin tuaj, ky proces në vazhdimësi është realizuar në përputhje me 'Manualin për Planifikimin, Hartimin dhe Monitorimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të tyre të Veprimit (Manuali), i cili është hartuar për të mbështetur zbatimin e Udhëzimit Administrativ 07/2018 për Planifikimin dhe Hartimin e Dokumenteve Strategjike dhe Planeve të Veprimit (Udhëzimi Administrativ)'. Monitorimi i zbatimit të Strategjisë së Energjisë është i rregulluar me Ligjin nr. 05/L-081 për Energjinë, Bazuar në nenin 7 pika 7 të këtij Ligji, Ministria paraqet raportin vjetor para Qeverisë, mbi progresin në realizimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë, si dhe nivelin e zbatimit të Strategjisë. Të gjitha raportet përfshijnë hollësi mbi përparimin përkatës në zbatimin e Programit të Zbatimit të Strategjisë, në periudhën e mbuluar nga raporti, dhe do t'i paraqesin zhvillimet që priten në periudhën e mbetur të Programit. Këto raporte publikohen në Web faqen e Ministrisë së Ekonomisë.	Gjetja në raport ka të bëjë me monitorimin specifik të zhvillimeve në burimet e ripërtërishme të energjisë sipas UA 05/2017 për caqet e vendosura për burimet e energjisë nga dielli, uji dhe era që në total ishin 793 MW. Raportet që janë publike në web faqen e ME janë analizuar gjatë auditimit por ato nuk përmbajnë të dhëna specifike lidhur me caqet në fjalë.
Gjetja 3 Ministria e Ekonomisë është përgjegjëse për të hartuar politika në fushën e energjisë së ripërtërishme dhe vendosjen e caqeve, megjithatë nuk kishte monitoruar në mënyrë të duhur përmbushjen e caqeve të përcaktuara.	jo	Komenti paraprak mbetet i njëjtë. Të përcaktohet metodologjia e rekomanduar që reflekton mënyrën e duhur të monitorimit. Termi 'duhur' është shumë i përgjithshëm dhe vështirë i zbatueshëm përderisa nuk përcaktohet së cila është 'mënyra e duhur' sipas ekipes së auditimit.	Vazhdimi i fjalisë së paraqitur në raport të auditimit e sqaron termin "mënyrë të duhur" si në vijim "para se të vendosë caqet nuk ishte bazuar në analizat e parafisibilitetit që kishin vlerësuar potencialin gjenerues të

⁹² Në raportin final numrat **rendor** të gjetjeve mund të ndryshojnë

			energjisë nga burimet e ripërtërishme të ujit. Edhe pse qëllimi i politikës energjetike ishte që deri në vitin 2020 të instalohen burime të ripërtërishme të energjisë në kapacitet prej 800 MW, deri në vitin 2024 ishin instaluar 310 MW që përfaqëson më pak se 40% të caqeve të përcaktuara.”
Gjetja 4 Ministria e Ekonomisë (ME) duhet të hartojë politika dhe strategji për arritjen e caqeve të energjisë së ripërtërishme dhe të monitorojë zbatimin e atyre politikave ⁵⁴ .	jo	Ministria e Ekonomisë ka hartuar politika dhe strategji sipas mandatit që ka - kjo nuk mund të kontestohet. Nëse insistohet të mbetet e gjetur metodologjia e monitorimit, atëherë kjo pjesë mund të plotësohet në këtë frymë, kjo me qëllim të përmirësimit të procesit të monitorimit. Megjithatë, ky rekomandim vlen për Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit sepse manuali anual është hartuar duke marrë parasysh kërkesat e përcaktuara në Udhëzimin Administrativ, duke përdorur gjerësisht praktikën dhe rekomandimet e dhëna në Dokumentin për përgatitjen, monitorimin, raportimin dhe vlerësimin e RAPsë dhe strategjitë sektoriale të zhvilluara nga SIGMA2, Strategjinë Kombëtare e Zhvillimit të Kosovës (2016-2021 (SKZH) dhe metodologjitë e ReSPA-s për kostimin si dhe praktikën e tjera ndërkombëtare në hartimin e strategjive. Manuali aplikohet për dokumentet strategjike dhe planet e veprimit të hartuara nga ministritë dhe institucionet e tjera publike të autorizuar që të hartojnë dokumente të tilla dhe t’ia paraqesin ato Qeverisë së Republikës së Kosovës (QK) për miratim. Ai po ashtu aplikohet edhe për çdo ndryshim apo rishikim të përgatitur nga këto institucione.	Ky është kriter kundrejt të cilit e kemi vlerësuar performancën e ME-së bazuar në & Udhëzimin Administrativ nr. 01/2013 dhe nr. 05/2017 dhe nr 05/2023;ligji Nr. 08_L_258 për promovimin e burimeve të ripërtërishme të energjisë.
Gjetja 5 Nga ajo që u përshkrua më sipër, sa i përket veprimeve të Ministrisë të ndërmarra nga viti 2017 deri në vitin 2023, shihet se	jo	Ky konkluzion nuk është në përputhje me pjesën paraprake të draft raportit. Andaj, pjesa paraprake duhet të rishikohet sipas rekomandimeve të dhëna. Po ashtu, duhet të potencohet edhe ndryshimi i strukturës organizative të Ministrisë (themelimi i NJIBRE) – strukturë e veçantë është përgjegjëse për zbatimin e	Ky është konkluzion i bazuar në analizën e shtjelluar në raport në tabelat 23-25 së bashku me shpjegimet e tyre në

ka pasur zhvillime pozitive në lidhje me monitorimin e zbatimit të politikave dhe caqeve të përcaktuara për burimet e ripërtërishme të energjisë.		projekteve në fushën e BRE-ve. Kjo është reformë thelbësore institucionale pas hyrjes në fuqi edhe të Ligjit për promovimin e përdorimit të burimeve të ripërtërishme të energjisë.	paragrafët para këtij konkluzioni.
Gjetja 6 Pra në mungesë të ligjit Ministria vetëm ka vendosur caqe por nuk ka qenë mjaftueshëm aktive në monitorimin dhe përshtatjen e tyre karshi zhvillimeve në sektorin e burimeve të ripërtërishme të energjisë.	jo	Komenti i njëjtë sikurse është dhënë në pjesën paraprake të këtij draft raporti. Rekomandojmë që ky konstatim të zëvendësohet me aplikimin joadekuat të metodologjisë së përgatitjes së raportit të progresit. Rekomandimi nuk vlen për Ministrinë e Ekonomisë.	Ky është shkaku që e ka sjellë gjendjen që e kemi përshkruar dhe paraqitur si gjetje në raport.
Gjetja 7 ME nuk ka bërë analiza që të vlerësojë efektin –në ekonomi, sektor të energjisë, në ambient - që kanë prodhuar politikat e ndërmarra nga vet Ministria për sa i përket arritjes së caqeve.	jo	Nuk është kërkesë ligjore. Ndërsa sa i përket fushës së mjedisit, ME nuk ka përgjegjësi të prodhojë analiza të tilla. Në kuadër të grupit punues për hartimin e Raportit të Progresit për zbatimin e Strategjisë së Energjisë, është edhe përfaqësuesi i Ministrisë përgjegjëse për çështje mjedisore.	Ky është auditim i performancës, kërkesat ligjore nuk e kufizojnë ME-në të bëjë analiza dhe të vlerësojë efektin e politikave që i ka hartuar vet.
Gjetja 9 Ministria e Ekonomisë, si përgjegjëse për të hartuar politika për zhvillimin e sektorit të energjisë, nuk kishte bërë monitorim të mjaftueshëm mbi zbatimin e këtyre politikave.	jo	Përgjatë dokumentit terminologjia në vazhdimësi ndryshon nga 'Monitorim i pamjaftueshëm' deri te 'monitorim jo i duhur'. Komenti mbetet i njëjtë për sa i përket monitorimit, sepse konstatimet si të tilla të dhëna në këtë draft në lidhje me monitorimin nuk i shërbejnë përmirësimit të proceseve të monitorimit në lidhje me zbatimin e dokumenteve strategjike	Cilado terminologji që është përdorur ka kuptim në kontekst të shpjegimeve që janë paraqitur në raport të auditimit.
Gjetja 10 Edhe pse qëllimi i politikës energjetike ishte që deri në vitin 2020 të instalohen burime të ripërtërishme të energjisë në kapacitet prej 800 MW, deri në vitin 2024 ishin instaluar 310 MW që përfaqëson më pak se 40% të caqeve të përcaktuara.	jo	Analiza krahasimore nuk është e qëndrueshme sepse caqet deri në 2020 dhe 2031 janë të ndryshme!	Kjo vetëm se e argumenton gjetjen me prova shtesë sepse edhe 4 vite pas afatit të përcaktuar për arritjen e caqeve, caqet nuk ishin arritur.

Gjetja 11 Rekomandojmë Ministrinë e Ekonomisë:9. Të bëjë analiza rreth ndikimit të politikave të burimeve të ripërtërishme të energjisë në sektorin e energjisë dhe të hartojë raporte mbi zbatimin dhe efektin e politikave dhe caqeve të vendosura për burimet e ripërtërishme të energjisë.	jo	Raportet hartohen sipas obligimit ligjor. Rishikimi i metodologjisë së raportimit mund të mbetet rekomandim për Zyrën për Planifikim Strategjik në kuadër të Zyrës së Kryeministrit.	Edhe nëse ME vazhdon me metodologjinë e njëjtë të raportimit, analizat dhe metodologjia për qëllime të matjes së efektit të BRE-ve është në diskrecion të ME dhe nuk ka nevojë të hartohet legjislacion i veçantë për këtë çështje.
Gjetja 12 Ministria e Ekonomisë (ME) duhet të hartojë politika dhe strategji për arritjen e caqeve të energjisë së ripërtërishme dhe të monitorojë zbatimin e atyre politikave78	jo	Ministria ka hartuar dhe vazhdon të hartoj politika dhe strategji. Komentit mbetet i njëjtë për sa i përket monitorimit	Këto nuk janë gjetje por është kriter që buron prej legjislacionit



Zyra Kombëtare e Auditimit
Lagjja Arbëria
Rr. Ahmet Krasniqi, 210
10000 Prishtina
Republika e Kosovës